



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore, Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, Bashkinë Shkodër

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

AUDITIMI TEMATIK “PËR AUDITIMIN E PROCEDURAVE TË DHËNIES SË LEJEVE, LICENSAVE DHE MONITORIMIN E AKTIVITETIT MINERAR ME VENDNDODHJE NË RASEK, SHKODËR”

Tiranë, dhjetor 2025

Nr.	Përmbajtja	Faqe
	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3-5
I.	1.Përshkrim i shkurtër i Raportit të Auditimit.	3-3
	2.Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.	3-5
	3.Konkluzioni i përgjithshëm.	5-5
II.	HYRJE	5-8
	1.Objektivat dhe qëllimi.	6-6
	2. Identifikimi i çështjes.	6-6
	3.Përgjegjësitë e strukturave të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Bashkisë Shkodër.	6-6
	4.Përgjegjësitë e audituesve.	6-6
	5.Kriteret e vlerësimit.	7-8
	6.Standardet e Auditimit.	8-8
	7.Metodat e auditimit.	8-9
	8.Dokumentimi i auditimit.	9-9
	III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT
1.	Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.	9-9
2.	Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit.	10-10
2.1	Mbi procedurën e shpalljes së zonës minerare nr. 2/6 me vendndodhje Rasek, Shkodër.	10-22
2.2	Mbi auditimin e procedurës së dhënies së lejeve, licensave për aktivitetin mineral të shfrytëzimit me vendndodhje Rasek, Shkodër.	23-31
2.3	Mbi auditimin e kryerjes së inspektimeve, monitorimeve për aktivitetin mineral të shfrytëzimit me vendndodhje Rasek, Shkodër.	32-44
2.4	Të tjera gjatë auditimit.	
IV.	REKOMANDIME	44-52

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër i institucionit:

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) luan një rol qendror në shpalljen e zonave minerare, pasi ajo është përgjegjëse për hartimin e Programit të Veprimit për zbatimin e strategjisë minerare dhe Planit Vjetor Minerar. Kjo ministri përcakton zonat që do të jenë objekt lelesh minerare, organizon procesin e konkurrimit dhe konsultohet me ministritë e tjera dhe pushtetin vendor për përgatitjen e planit. Pas miratimit nga ministri ose Këshilli i Ministrave, këto dokumente publikohen dhe pasqyrohen në hartën minerare dixhitale, duke siguruar transparencë dhe orientim strategjik për zhvillimin e sektorit minerar.

- Roli i Ministrisë së Mjedisit dhe Turizmit (MTM) në dhënien e lejes mjedisore është të vlerësojë ndikimin në mjedis të projekteve minerare dhe të japë miratimin ose refuzimin e lejes mjedisore, duke siguruar që aktivitetet minerare të përmbushin standardet ligjore për mbrojtjen e mjedisit, përfshirë masat për parandalimin e ndotjes, menaxhimin e mbetjeve dhe rehabilitimin e zonave të prekura.

- Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) monitoron dhe kontrollon zbatimin e kushteve të dhënies së lejes së mjedisit nga subjektet minerare, kryen inspektime dhe merr masa ligjore ndaj shkelësve, duke siguruar mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetin e njerëzve gjatë zhvillimit të këtyre aktiviteteve.

- Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) është përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe kontrollin e aktiviteteve minerare, duke siguruar që kompanitë të veprojnë sipas kushteve të lejes dhe legjislacionit në fuqi. Ajo shqyrton planet e punës dhe kontrollon përdorimin e qëndrueshëm e të sigurt të burimeve natyrore, për të garantuar që veprimtaria minerare zhvillohet pa dëmtuar mjedisin dhe pasuritë natyrore.

- Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) ka për detyrë të kontrollojë që aktivitetet minerare, sidomos guroret, të zhvillohen në përputhje me ligjin dhe pa dëmtuar territorin apo mjedisin. Ai ka një rol kyç në mbikëqyrjen e lejeve, ndalimin e veprimtarive të paligjshme dhe marrjen e masave ndaj shkelësve. Përmes inspektimeve dhe bashkëpunimit me institucione të tjera, IKMT siguron që shfrytëzimi i burimeve natyrore të bëhet në mënyrë të kontrolluar dhe të qëndrueshme, duke mbrojtur interesin publik dhe të komuniteteve të zonës.

- Bashkia Shkodër jep mendime për aktivitetet minerare që zhvillohen në territorin e saj, duke vlerësuar ndikimin në mjedis dhe interesin e komunitetit. Ky mendim është pjesë e procesit të vlerësimit mjedisor dhe ndihmon në vendimmarrjen për miratimin ose jo të projektit.

b. Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij:

Fokusi i auditimit të këtyre institucioneve është veprimtaria minerare që zhvillohet në zonën minerare nr.2/6 me Vendndodhje “Rasek”, Qarku Shkodër, me qëllim vlerësimin e zbatimit të detyrimeve ligjore nga subjektet dhe autoritetet përgjegjëse, si dhe evidentimin e ndikimit që kjo veprimtaria ka në mjedis, territor dhe komunitetin lokal.

c. Qëllimi i auditimit:

Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime me synim ndërmarrjen e masave nga subjektet e audituara.

Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- Mbi procedurën e shpalljes së zonës minerare nr. 2/6 me vendndodhje Rasek, Shkodër.

- Mbi auditimin e procedurës së dhënies së lejeve, licensave për aktivitetin minerar të shfrytëzimit me vendndodhje Rasek, Shkodër.

- Mbi auditimin e kryerjes së inspektimeve, monitorimeve për aktivitetin minerar të shfrytëzimit me vendndodhje “Rasek”, Shkodër.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes së të dhënave:

Realizimi i këtij auditimi u bazua në metodologjinë e auditimit të përcaktuar në Rregulloren e Procedurave të Auditimit në KLSH, miratuar me Vendimin e Kryetarit nr. 7, datë 17.01.2024.

Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme: verifikimi i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në sistem dhe terren.

e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve:

Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucionet për periudhën nën auditim paraqesin të meta dhe mangësi në disa drejtime të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 10 gjetje dhe ka dhënë 14 rekomandime të karakterit organizativ.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore:

-Gjatë vlerësimit të dokumentacionit aplikues për leje minerare, është konstatuar mungesë e standardizimit në kriteret tekniko-profesionale, ku nuk përcaktohet numër minimalë për fuqinë punëtore apo specifikime për mjetet e nevojshme, e cila ka sjellë paqartësi dhe trajtim të pabarabartë ndërmjet konkurrentëve. Kjo situatë nuk është në përputhje me kërkesat e pikës 7.9 të VKM nr. 320, datë 21.04.2011, të ndryshuar me VKM nr. 301, datë 20.04.2016 “*Për miratimin e procedurave konkurruese, kriterëve dhe afateve për marrjen e lejeve minerare në zonat konkurruese të Republikës së Shqipërisë*”, e cila kërkon që dokumentet e konkurrimit të përmbajnë kriteret e qarta, objektive dhe të njëjta për të gjithë pjesëmarrësit, në funksion të një procesi transparent dhe konkurrues.

-Referuar Akt-Miratimit nr. 1835, datë 30.06.2017, koordinatat e miratuara për shfrytëzimin mineral nga subjekti “B. C.” sh.p.k, në zonën 2/6 (Rasek, Shkodër), nuk përputhen me vendndodhjen faktike të veprimtarisë në terren.

-Nga auditimi i procedurës së shpalljes së zonës minerare është evidentuar mungesë rregullash të qarta dhe standardesh teknike mbi distancat mbrojtëse ndërmjet aktiviteteve minerare dhe zonave të banuara, si pasojë e paqartësive normative në zbatimin e Ligjit nr. 10304/2010 “*Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar me Ligjin nr. 65/2021.

-Nga auditimi i dokumentacionit dhe verifikimi në terren më datë 01.04.2025, në prani të përfaqësuesve të AKBN-së dhe Bashkisë Shkodër, u konstatua se subjekti “NGA G” sh.p.k po ushtron aktivitet mineral në një sipërfaqe prej 1.8 ha jashtë kufijve të lejes minerare, në një zonë me status fond pyjor/kullor. Kjo sipërfaqe është vënë në dispozicion në mënyrë të paligjshme nga Bashkia Shkodër, nëpërmjet aktit “Procesverbal nr. 33, datë 10.02.2022”, hartuar nga Përgjegjësi i Drejtorisë së Shërbimeve Bujqësore dhe Pyjore.

-Nga auditimi i vlerësimit të dokumentacionit për pajisjen me leje mjedisi të shoqërisë “B. C.” sh.p.k., u konstatuan mangësi në përmbushjen e kërkesave ligjore dhe procedurale, të cilat kanë ndikuar negativisht në transparencën, përfshirjen e plotë të palëve të interesuara dhe pasqyrimin e drejtë të procesit të miratimit, duke bërë që ai të mos jetë plotësisht në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi.

- Nga auditimi i procesit për pajisjen me Leje Mjedisore Tipi B për subjektin “NGA G” sh.p.k. u konstatuan mangësi serioze si në dokumentacion ashtu edhe në zbatimin e procedurave, përfshirë mungesën e instalimit të impiantit të fraksionimit, fakt i konfirmuar nga verifikimi në terren në prani të përfaqësuesve të institucioneve (AKBN, Bashki Shkodër) dhe përfaqësuesit të subjektit.

-Nga auditimi i programeve dhe monitorimeve nga AKBN rezultoi se, aktiviteti mineral i subjekteve “B. C.” sh.p.k dhe “NGA G” sh.p.k nuk është monitoruar për një periudhë 6-mujore të viteve 2019, 2020, 2024, ndërsa nuk është monitoruar për asnjë periudhë 6-mujore për vitin 2023, pavarësisht se ishte parashikuar në programin vjetor.

h. Paraqitja e rekomandimeve kryesore: Me qëllim zgjidhjen e problematikave, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, për të garantuar transparencë, barazi dhe objektivitet në procedurat konkurruese në vijim, për lejet minerare, të standardizojnë kriteret tekniko-profesionale në dokumentet e garës. Kjo mund të realizohet përmes hartimit të një udhëzuesi teknik që parashikon kufij minimalë të pranueshëm për fuqinë punëtore, tipologjinë dhe disponimin e mjeteve, të përshtatur sipas llojit të aktivitetit mineral.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore dhe me asistencën teknike të Autoritetit Shtetëror të Informacionit Gjeohapësinor, të kryejë konfigurimin e saktë të koordinatave dhe verifikimin e përputhshmërisë gjeohapësinore të lejes minerare të subjektit “B. C.” sh.p.k.

Duke qenë se pozicionimi aktual përbën rrezik të drejtpërdrejtë për shëndetin, sigurinë dhe mirëqënien e banorëve, si dhe cënon interesin publik, të merren masat përkatëse administrative përfshirë pezullimin deri në revokimin e lejes minerare, në funksion të mbrojtjes së interesave të komunitetit dhe garantimin e zbatimit të ligjit.

-Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në bashkëpunim me institucionet mjedisore, urbanistike dhe njësitë vendore, duhet të ndërmarrin masa për përcaktimin e kriterëve teknike mbi distancat mbrojtëse sipas tipologjisë së aktivitetit minerar, të integrojë këto kriterë në proceset e miratimit dhe vlerësimit të ndikimit në mjedis, si dhe të garantojë funksionimin e mekanizmave të kontrollit dhe penalizimit në rast shkeljesh. Këto veprime do të mundësojnë një praktikë të njëtrajtshme dhe të parashikueshme në mbrojtje të komuniteteve lokale dhe mjedisit.

-Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Pyjeve, të mbështesin veprimet ligjore dhe procedurale të Bashkisë Shkodër, për bllokimin e menjëhershëm të punimeve në fondin pyjor dhe kullor në pronësi dhe administrim të saj, dhe sipas rastit të bëhet sekuestrimi, konfiskimi i mjeteve të përdorura, për zënien gërryerjen, gërmimin dhe tjetërsimin e fondit pyjor/kullor.

- Bashkia Shkodër, të anulojë Procesverbalin nr. 33, datë 10.02.2022, për dhënien në përdorim të sipërfaqes pyjore 1.8 ha subjektit “NGA G” sh.p.k, për shkak të paligjshmërisë. Gjithashtu, të vlerësojë dëmin e shkaktuar dhe të marrë masat ligjore ndaj përgjegjësve, duke ndaluar çdo përdorim të mëtejshëm të paligjshëm, të kërkojë pranë organeve ligjzbatuese ndëshkimin e shkaktarëve dhe rikuperimin e sipërfaqes së dëmtuar, të pronës publike, fond pyjor/kullor.

- Agjencia Kombëtare e Mjedisit në cilësinë e organit kompetent për dhënien dhe menaxhimin e Lejeve Mjedisore të Tipi B, të ndërmarrë revokimin e Lejes Mjedisore me nr. PN-5249-06-2017 lëshuar subjektit “B. C.” sh.p.k, për shkak të mangësive të konstatuara, të mospërfshirjes së komunitetit në procesin e vendimmarrjes (përmes dëgjësive publike), problematikat në Raportin e Thelluar të VNM-së, si dhe shkelje të tjera të identifikuara në terren.

- Agjencia Kombëtare e Mjedisit, si organi kompetent për dhënien dhe menaxhimin e Lejeve Mjedisore Tipi B, të ushtrojë menjëherë të drejtën për revokimin e Lejes Mjedisore me PN-1089-03.2022, datë 23.03.2022 të subjektit “NGA G” sh.p.k., për shkak të mosrespektimit të kushteve të përcaktuara në leje dhe mungesës së impiantit të fraksionimit në vend, duke zbatuar dispozitat ligjore që parashikojnë shfuqizimin e lejes në rast mosplotësimi të kushteve të saj.

- Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore të përgatisin dhe zbatojnë programe të rregullta kontrolli për subjektet minerare që ushtrojnë aktivitet në zonën minerare 2/6, vendburimi “Rasek”. Këto programe duhet të përfshijnë inspektime periodike, çdo 6 muaj dhe vjetore, për të garantuar që problemet e konstatuara të ndiqen dhe zgjidhen në kohë.

I. Konkluzioni i përgjithshëm:

Nga auditimi i kryer pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, Bashkisë Shkodër, “Për auditimin e procedurave të dhënies së lejeve, licensave dhe monitorimin e aktivitetit minerar me vendndodhje në Rasek, Shkodër”, konstatohet se aktiviteti minerar i shoqërisë “B. C.” sh.p.k. dhe nënkontraktorit “NGA G” në zonën minerare Nr. 2/6, “Rasek”, Qarku Shkodër, është zhvilluar pa përmbushur plotësisht kërkesat ligjore, mjedisore dhe institucionale që rregullojnë këtë sektor. Më konkretisht, janë konstatuar mangësi në të gjitha hallkat kryesore të procesit, që nga shpallja e zonës minerare, procedurat e dhënies së lejeve dhe licensave përkatëse (minerare dhe mjedisore), deri te menaxhimi dhe monitorimi i zhvillimit të aktivitetit minerar në terren.

- Koordinatat e miratuara për shfrytëzimin minerar në zonën 2/6 “Rasek”, Qarku Shkodër, nuk përputhen me vendndodhjen faktike të veprimtarisë në terren. Aktiviteti ndodhet 200 metra në

vijë ajrore nga banesat më të afërta, duke rritur rrezikun për komunitetin lokal dhe për zonat me vlera të veçanta kulturore dhe natyrore.

-Nga auditimi i procedurës së shpalljes së zonës minerare është evidentuar mungesë rregullash të qarta dhe standardesh teknike mbi distancat mbrojtëse ndërmjet aktiviteteve minerare dhe zonave të banuara.

- Subjekti “B. C.” sh.p.k ka ushtruar aktivitetin minerar në një sipërfaqe që vazhdon të jetë pjesë e fondit pyjor, pa marrë miratimin e detyrueshëm sipas legjislacionit përkatës gjatë periudhës 2017-2025, duke përbërë shkelje të rregullave për administrimin e këtij fondi dhe të kuadrit ligjor për pyjet dhe mjedisin.

- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Pyjeve edhe pse janë vënë në dijeni nga ana e Bashkisë Shkodër, për ushtrimin e aktivitetit të paligjshëm në fondin pyjor/kullosor, nuk kanë ushtruar kompetencat e tyre ligjore. Bashkia Shkodër nuk ka mbajtur asnjë dokumentacion ligjor tekniko-vlerësues, që kanë të bëjnë me ndërhyrjen e paligjshme në fondin pyjor/kullosor dhe impakte të tjera në ekosistem dhe në basenin ujëmbledhës të përroit “Rasek”, që të dëshmojë veprime konkrete për zbatimin e legjislacionit në fuqi për pyjet dhe mjedisin.

- Procedura për pajisjen me leje mjedisi për subjektin “NGA Group” sh.p.k. ka pasur mangësi që nga dokumentimi, procedura e ndjekur për përfitimin e lejes mjedisore e deri në zbatimin në terren. Kjo e mbështetur edhe nga fakti i mungesës së instalimit të impiantit të fraksionimit, vërtetuar nga verifikimi i kryer nga grupi i auditimit në prani të përfaqësuesve të institucioneve dhe të vet subjektit.

-Verifikimi në terren pranë zonës minerare “Rasek”, konstatoi shkelje të rënda të kushteve të lejes mjedisore dhe veprimtari të tjera të paligjshme, përfshirë depozitimin e materialeve sterile dhe inerteve në shtratin e lumit, ndryshimin e trasesë së rrugës së kantierit në kundërshtim me projektin e mratuar; ndërtimin e veprave teknike jo të parashikuara(tombinat, urë provizore); gërryerje dhe ndërhyrje të pakontrolluara në terren shkarkim të punimeve përgatitore mbi përrua, si dhe rrezikim të infrastrukturës së ujit të pijshëm.

- Gjatë periudhave të caktuara është evidentuar mungesë e monitorimit dhe inspektimeve nga institucionet përgjegjëse (AKM, AKBN), duke rezultuar në ushtrimin e aktivitetit minerar pa mbikëqyrjen e nevojshme për respektimin e kuadrit ligjor dhe vlerësimin e ndikimeve mjedisore.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Programit të Auditimit nr.510/6 prot., datë 05.05.2025, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 12.05.2025 deri në datën 13.06.2025 u krye Auditimi Tematik “Për auditimin e procedurave të dhënies së lejeve, licencave dhe monitorimin e aktivitetit minerar me vendndodhje në Rasek, Shkodër”, nga:

Grupi i auditimit me përbërje:

1. Xh. K., përgjegjës grupi;
2. P. I., auditues;
3. E. G., auditues.

Objektivat dhe qëllimi i auditimit:

Në objektivat dhe qëllimet e auditimit përfshihet vlerësimi objektiv i evidencave, dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, për të përcaktuar nëse të dhënat e raportuara për periudhën objekt auditimi përputhen me kriteret përkatëse të kuadrit rregullator.

Identifikimi i çështjes:

Auditimi synoi të vlerësonte nëse aktiviteti minerar me vendndodhje në zonën “Rasek”, Qarku Shkodër, ishte zhvilluar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me kushtet e përcaktuara në lejet përkatëse. Gjithashtu, u analizua efektiviteti i inspektimeve, kontrollit dhe masave të ndërmarra nga institucionet përgjegjëse (MIE, MTM, AKM, AKBN, IKMT dhe Bashkia Shkodër). Auditimi kishte për qëllim edhe evidentimin e mangësive apo shkeljeve që mund të kenë cënuar mbrojtjen e mjedisit dhe interesin publik të komunitetit lokal.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:

Strukturat përgjegjëse të këtyre institucioneve luajnë një rol të veçantë në menaxhimin dhe kontrollin e aktivitetit minerar, pasi secila prej tyre ka funksione të përcaktuara:

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) është përgjegjëse për hartimin e politikave sektoriale, përcaktimin dhe autorizimin e zonave minerare për shfrytëzim, si dhe dhënien e lejeve në përputhje me legjislacionin dhe strategjitë kombëtare të zhvillimit.
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) është përgjegjëse për vlerësimin mjedisor të projekteve minerare dhe dhënien e lejeve mjedisore për aktivitetet që kanë ndikim në mjedis.
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) kryen procesin teknik të vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM), monitoron cilësinë e mjedisit dhe raporton për ndikimet mjedisore të aktiviteteve minerare.
- Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) mbikëqyr zbatimin teknik të projekteve minerare, vlerëson burimet natyrore dhe ofron mbështetje teknike për qeverinë në vendimmarrje.
- Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) kryen kontrole dhe ndërhyrje në rastet e shfrytëzimit të paligjshëm të burimeve minerare, në zbatim të ligjit për mbrojtjen e territorit.
- Bashkia Shkodër jep mendime në procesin e miratimit të projekteve minerare dhe mbikëqyr ndikimin mjedisor e social të tyre në territorin vendor, në funksion të interesit të komunitetit lokal.

Përgjegjësitë e audituesve:

Audituesit e KLSH-së janë përgjegjës për dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen apo jo, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuar si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kriterëve: standarde, ligje, Vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet, etj; duke respektuar Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, si dhe Kodin e Etikës.

Kriteret e vlerësimit:

Në të gjitha fazat e auditimit, sipas programit të detajuar, në përshtatje me Standardet e Auditimit dhe në referencë me problematikat e trajtuara, janë marrë në konsideratë si kriter vlerësues:

Ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

Rregullore e Brendshme e Organizimit dhe Funksionimit të KLSH-së, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr.58, datë 08.04.2022;

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI), “Udhëzuesit e INTOSAI-t”; Udhëzues të përgjithshëm dhe specifik për auditimin, si dhe në praktikat më të mira ndërkombëtare të fushës së auditimit publik.

Gjithashtu, janë marrë parasysh edhe përcaktimet ligjore dhe rregullat e funksionimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, Inspektoratit Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, Bashkisë Shkodër, e konkretisht disa prej tyre si;

Ligji nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, i përditësuar;

Ligji nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” i ndryshuar;

Ligji nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i përditësuar;

Ligji nr. 10431 "Për Mbrojtjen e Mjedisit", datë 09.06.2011, i ndryshuar;

Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar;

Ligji nr. 10304, datë 15.07.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;

Ligji nr. 9385, datë 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", i përditësuar;

Ligji nr. 57/2020 "Për pyjet" i ndryshuar;

Vendimi nr.686, datë 29.07.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të VNM";

Vendim nr.912, datë 11.11.2015 "Për miratimin e metodologjisë kombëtare të procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis";

Vendim nr.247, datë 30.04.2014 "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore";

VKM nr. 1353, datë 10.10.2008 "Për përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik dhe procedurat për zvogëlimin e sipërfaqes dhe vëllimit të fondit pyjor";

VKM nr.888, datë 27.12.2022 "Për rastet e dhënies në përdorim dhe ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimin e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre";

Vendim nr.538, datë 26.05.2009 "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta".

Vendimi nr.942, datë 17.11.2010 "Për miratimin e procedurave dhe dokumentacionit për marrjen e lejeve minerare në zonat e hapura"

Vendim nr.320, datë 21.04.2011, i ndryshuar me VKM nr.301, datë 20.4.2016 "Për miratimin e procedurave e të kriterëve të konkurrimit dhe të afateve të shqyrtimit të kërkesave për marrjen e lejeve minerare në zonat konkurruese", etj.

Urdhri nr.382, datë 20.05.2011 "Për miratimin e formës, përmbajtjes dhe procedurave të lënies së aktit të konstatimit për kundërvajtjet administrative në zbatim të lejeve minerare".

Udhëzimi nr. 17, datë 28.01.2014 i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë "Për përcaktimin e kriterëve për miratimin e nënkontraktimit të së drejtës minerare për kërkimzbulim-shfrytëzim dhe shpërndarje", etj.

Standardet e auditimit:

Auditimi bazohet në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, Rregulloren e Procedurave të Auditimit nr.07, datë 17.01.2024, Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI si dhe udhëzimeve dhe rregullave të nxjerra në zbatim të tyre, etj.

Metodat e auditimit:

a. Metoda "Testim hap pas hapi": Përfaqëson veprime specifike që ndiqen brenda sistemit nga origjina deri në veprimin e fundit. Në këtë rast një numër i caktuar praktikash janë përzgjedhur për të parë se si njësia publike i është përmbajtur procedurave të caktuara.

b. Metoda e ekzaminimit: Kjo është një procedurë e cila ka shërbyer për të shqyrtuar të dhëna që lidhen me kryerjen e auditimit. Në këtë mënyrë, ajo që është vëzhguar dhe identifikuar të mund të testohet më tej. Vlerësimi ka përfshirë procedura testimi, si dhe gjykimin profesional të audituesve në lidhje me përshtatshmërinë dhe efikasitetin e veprimeve.

c. Metoda e ekzaminimit kryq: Është përdorur kur është marrë informacioni për një ngjarje nga një burim i caktuar. Ky informacion është marrë dhe është krahasuar me një informacion të marrë për të njëjtat ngjarje, por me origjinë nga një burim tjetër. Kjo metodë është përdorur për të arritur nivelin e mjaftueshëm të besueshmërisë së përfundimeve.

d. Metoda e inspektimit fizik: Me anë të kësaj metode audituesit kanë verifikuar gjendjen fizike të dokumenteve të ndryshme dhe të situatës në lidhje me çështjet nën auditim.

e. Metoda e intervistimit: Është konsideruar si një nga metodat më të mira dhe më të përshtatshme të përdorura gjatë procesit të auditimit për të gjetur informacion të menjëhershëm. Duke qenë se kjo metodë kufizohet nga besueshmëria e evidencës së mbledhur gjatë përdorimit të saj, kjo metodë është përdorur për kontrollin dhe verifikimin e informacionit gjatë përdorimit të ekzaminimit kryq, ose forma të tjera si p.sh. caktimi i takimeve, intervistat me punonjësit e tjerë të institucionit, ballafaqimi midis punonjësve që kanë patur përgjegjësi në procesin e punës etj. Është intervistuar stafi menaxherial dhe operacioni gjatë fazës së njohjes së aktiviteteve dhe proceseve të njësive të audituar. Intervistat kanë ofruar një mundësi për parashtrimin e pyetjeve

për sqarim të informacionit shtesë në bazë të përgjigjeve të dhëna. Audituesit kanë qenë të paanshëm dhe janë munduar të jenë sa më efektiv duke iu shmangur anshmërisë së informacioneve, duke bërë pyetje të hapura (që kërkojnë përgjigje dhe shpjegime disi të gjëra). Evidencat e auditimit që përftohet nga takimi janë mbajtur saktë dhe në mënyrë korrekte.

f. Metoda e testimit të detajuar: Audituesit kanë kryer ekzaminimin e dokumenteve të institucionit sipas objektivave të auditimit dhe kanë marrë evidenca më të besueshme se sa intervistimi ose në mbështetje të informacioneve të mbledhura gjatë intervistimit.

Dokumentimi i auditimit:

Mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 “Dokumentimi i Auditimit”, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë.

Dokumentimi i Auditimit është bazuar në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë; Rregulloren “Për Procedurat e Auditimit”, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së Nr. 07, datë 17.01.2024 si dhe në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI). Grupi i auditimit ka dokumentuar punën audituese në të gjitha fazat. Nga grupi i auditimit janë plotësuar të gjitha dokumentet standarde të auditimit, si dhe është dokumentuar gjurma e auditimit për të gjitha procedurat e kryera.

III-PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektet nën auditim.

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) ka për mision hartimin e politikave për zhvillimin e sektorit minerar, autorizimin e zonave minerare dhe sigurimin e shfrytëzimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore, në përputhje me strategjinë shtetërore dhe legjislacionin përkatës.
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) harton dhe zbaton politikat për mbrojtjen e mjedisit, përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe zhvillimin e sektorit të turizmit.
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) është përgjegjëse për vlerësimin e ndikimit në mjedis, monitorimin e cilësisë mjedisore dhe raportimin mbi gjendjen e mjedisit në nivel kombëtar.
- Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) ka për detyrë mbikëqyrjen teknike dhe kontrollin e shfrytëzimit të burimeve natyrore, si dhe ofrimin e asistencës teknike për qeverinë në fushën minerare dhe energjetike.
- Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) zbaton ligjin për mbrojtjen e territorit, duke ndërhyrë ndaj veprimtarive të paligjshme që dëmtojnë mjedisin apo përdorimin e tokës.
- Bashkia Shkodër, si njësi e vetëqeverisjes vendore, ka për mision të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm lokal, të mbrojtë interesat e komunitetit dhe të mbikëqyrë aktivitetet që ndikojnë në territorin dhe mjedisin brenda juridiksionit të saj, në përputhje me ligjin për vetëqeverisjen vendore dhe aktet përkatëse të Këshillit Bashkiak.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.

2.1.Mbi procedurën e shpalljes së zonës minerare nr. 2/6 me vendndodhje Rasek, Shkodër.

Mbi shpalljen e zonës minerare:

Veprimtaria minerare është veprimtari me interes publik. Vendimmarrja në fushën e veprimtarisë minerare bëhet në kushtet e transparencës, paraprihet nga këshillimet me komunitetin e zonës dhe mendimin me shkrim të njëjësive përkatëse të qeverisjes vendore. Veprimtaria në fushën minerare zhvillohet duke respektuar parimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe të mbrojtjes së mjedisit. E drejta minerare është një e drejtë e dallueshme dhe e pavarur nga e drejta e pronësisë mbi sipërfaqen e tokës, ku ato gjenden. Marrëdhëniet e subjektit përfitues të së drejtës minerare

dhe titullarit të së drejtës së pronësisë mbi pronën, ku gjenden minerale, rregullohen me marrëveshje, sipas legjislacionit në fuqi.

Grupi i auditimit shqyrtoi procedurën e shpalljes për zonën minerare konkurruese me nr. 2/6, vendndodhje “Rasek,” Qarku Shkodër dhe të procedurave dhe dokumentacionit për marrjen e lejes minerare, nga subjekti “B. C.” sh.p.k.

Procedura e shpalljes është ndjekur, duke përfshirë njoftimin publik, afatet ligjore dhe kriteret e konkurrimit, sipas Ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”. Grupi i auditimit shqyrtoi procedurën e shpalljes për zonën minerare konkurruese me nr. 2/6, vendndodhje “Rasek,” Qarku Shkodër dhe të procedurave dhe dokumentacionit për marrjen e lejes minerare, nga subjekti “B. C.” sh.p.k.

Procedura e shpalljes është ndjekur, duke përfshirë njoftimin publik, afatet ligjore dhe kriteret e konkurrimit, sipas Ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”.

I. Zona minerare Nr. 2/6, me vendndodhje në “Rasek”, Qarku Shkodër, është përfshirë në Planin Vjetor Minerar të vitit 2016, i miratuar me Urdhrin Nr. 371, datë 09.11.2016 të Ministrit të Energjisë dhe Industrisë “Për miratimin e Planit Vjetor Minerar të vitit 2016”. Kjo zonë është përcaktuar gjithashtu në përputhje me Vendimin Nr. 751, datë 26.10.2015 të Këshillit të Ministrave “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr. 726, datë 2.9.2015 ‘Për miratimin e Programit të Veprimit 3-vjeçar 2016–2018 për zhvillimin e aktivitetit minerar dhe përcaktimin e zonave minerare të rrezikshme”, sipas Ligjit nr. Nr. 10 304, datë 15.07.2010 “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i konsoliduar, neni 8, pika 4 “Programi i veprimit për zbatimin e strategjisë minerare hartohet nga ministria dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave”, pika 5 “Në zbatim të programit të veprimit miratohet plani vjetor minerar, i cili përmban zonat minerare, për të cilat do të jepen të drejtat minerare..”.

Nga auditimi rezultoi se procedura e shpalljes së zonës minerare në Shqipëri ka probleme që janë identifikuar në praktikë. Disa prej tyre përfshijnë:

Mungesa e transparencës: Për zonën minerare konkurruese, me nr.2/6, shpallja e zonës minerare nuk është bërë në mënyrë të qartë dhe të hapur për publikun, sipas Ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, duke krijuar dyshime mbi procesin e përzgjedhjes.

Konkretisht, problematikat për këtë rast janë nga banorët e fshatit Domen, në njësinë administrative Postribë, Qarku Shkodër, prej momentit të shpalljes së zonës minerare, ka pasur shqetësime/ankesa të vazhdueshme prej tyre, duke mos marrë në konsideratë dëgjuesen e tyre.

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) për lejet e shfrytëzimit të mineralit ndërtimor përfshin analizën e ndikimeve mjedisore dhe sociale të aktiviteteve minerare. Ky raport vlerëson faktorë si ndotja e ajrit, ujit dhe tokës, si dhe masat për minimizimin e ndikimeve negative.

Me shkresën nr.812 prot, datë 07.06.2019, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë ka miratuar me Vendimin nr.132, datë 28.05.2019 të Ministrisë së Kulturës, raportin e vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të Projektit të shfrytëzimit të mineralit ndërtimor “Gur gëlqeror i mermerizuar” objekti “Rasek” Shkodër, subjekti “NGA G” sh.p.k, realizuar nga individ i licencuar në arkeologji, z. L. P..

Procesi i shpalljes së zonës minerare, nuk është në përputhje me kërkesat e Ligjit nr.10 304/2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Ligjit nr.27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, në nenin 8, pika 6, përcaktohet shprehimisht: “Plani vjetor minerar hartohet nga struktura përgjegjëse dhe miratohet nga ministri, pas këshillimit me ministrinë përgjegjëse për mjedisin, pyjet, tokën bujqësore, trashëgiminë kulturore, turizmin e mbrojtjen dhe njësitë e qeverisjes vendore përkatëse”., pasi, objekti minerar nuk është pjesë e Vlerësimit Strategjik të Ndikimeve në Mjedis, dhe para miratimit të tij, nuk i është nënshtruar dispozitave të ligjit nr.91/2013, datë 28.02.2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor”.

Sa më sipër, struktura përgjegjëse pranë MIE, nuk ka respektuar kërkesat dhe parimet e veprimtarisë minerare, të përcaktuara në nenin 8/6 të ligjit nr.10 304 datë 15.07.2010 “Për

sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe ligjit nr.27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore Dhe Muzetë”.

Në kundërshtim me VKM nr.1124, datë 30.07.2008, pika 9 dhe VKM nr.538, datë 26.05.2009, raporti i thelluar i VNM-së nuk është shoqëruar me 3 (tre) certifikata të ekspertit të mjedisit, por me 1 (një) dhe pavarësisht mangësive është marrë në konsideratë nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

Nga auditimi i procedurës së shpalljes së zonës minerare është evidentuar mungesë rregullash të qarta dhe standardesh teknike mbi distancat mbrojtëse ndërmjet aktiviteteve minerare dhe zonave të banuara, si pasojë e paqartësive normative në zbatimin e Ligjit nr. 10304/2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 65/2021. Kjo situatë krijon terren për interpretim të ndryshëm nga institucionet zbatuese, cënim të sigurisë publike dhe konflikt potencial me komunitetet lokale.

Mbi procedurën e konkurrimit për dhënien e të drejtës për aplikim për leje minerare në QKB për zonat minerare konkurruese, nr.2/6, me vendndodhje: “Rasek”, Qarku Shkodër, lloji i mineralit gëlqeror i mermerizuar, veprimtaria shfrytëzim.

Të dhëna mbi objektin:

Me Urdhër nr.379, datë 14.11.2016, për fillimin e procedurave të konkurrimit për dhënien e të drejtës për aplikim për leje minerare në QKB për zonat minerare konkurruese, për zonën minerare me nr.2/6, me adresë: Rasek, Qarku Shkodër, janë krijuar njësitë e procedurës së konkurrimit me këtë përbërje:

Njësia për hartimin e dokumenteve të garës, kërkesave për kualifikim:

1. E. S. Anëtar MIE
2. F. M. Kryetar MIE
3. L. K. Anëtar MIE
4. M. Rr. Anëtar AKBN
5. N. A. Anëtar MIE
6. Z. T. Anëtar SHGJSH

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave për shqyrtimin e ofertave dhe miratimin e dokumenteve të garës:

1. K. B. Kryetar MIE
2. M. H. Anëtar MIE
3. A. G. Anëtar MIE
4. S. M. Anëtar MIE
5. E. S. Anëtar AKBN
6. E. G. Anëtar AKBN
7. Gj. S. Anëtar SHGJSH

Për ndjekjen e këtij urdhri ngarkohet, Drejtoria e Politikave dhe Zhvillimit të Minierave, pranë Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë nënshkruar nga titullari i Autoritetit Kontraktor, z. D. Gj..

Mbi përcaktimin e kriterëve të kualifikimit:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion njësia për hartimin e dokumentacionit të kërkesave për kualifikim ka kërkuar:

Pika V. Dokumentet për plotësimin e kërkesave për kapacitetet tekniko-profesionale, kandidati ofertues duhet të dorëzojë:

1. Kualifikimet arsimore dhe profesionale të stafit përgjegjës për drejtimin e punimeve që lidhen me ekzekutimin e punimeve të planit të investimit.
2. Licenca profesionale e drejtuesit teknik dhe kontratën me drejtuesin teknik.
3. Dëshmi mbi fuqinë mesatare punëtorë të ofertuesit dhe stafit drejtues.
4. Lista e mjeteve e shoqëruar me dokumentet që vërtetojnë të drejtat reale që subjekti gëzon

ndaj mjetit (pronësi, qira, përdorim apo çdo lloj tjetër posedimi).

Në këtë rast, nga shqyrtimi i dokumentacionit, në përmbushje të kriterëve të kualifikimit, “mbi fuqinë mesatare punëtorë të ofertuesit dhe stafit drejtues”, si dhe “listës së mjeteve shoqëruar me dokumentet që vërtetojnë të drejtat reale që subjekti gëzon ndaj mjetit (pronësi, qera, përdorim apo çdo lloj tjetër posedimi)” nuk ka një numër konkret minimal apo maksimal të stafit të kërkuar dhe mjeteve, për të vërtetuar disponimin konkret të tyre, për realizimin me sukses të kontratës. Referuar frymës së legjislacionit në fuqi, përcaktimi i një numri të papërcaktuar dhe të paargumentuar ligjërisht mbi kapacitetet tekniko-profesionale përbën mungesë standardizimi. Kjo krijon paqartësi në dokumentacionin aplikues dhe mund të çojë në përcaktim të kriterëve që favorizojnë subjekte të caktuara, duke cenuar parimin e konkurrencës së ndershme. Për rrjedhojë, ky praktikim nuk është në përputhje me kërkesat e pikës 7.9 të VKM-së nr.320, datë 21.04.2011, e ndryshuar me VKM nr.301, datë 20.04.2016, “Për miratimin e procedurave, kriterëve të konkurrimit dhe afateve të shqyrtimit të kërkesave për marrjen e lejeve minerare në zonat konkurruese”.

Mbi vlerësimin e ofertave nga KVO.

Procedura konkurruese për zonën minerare konkurruese nr.2/6, objekti Rasek, Qarku Shkodër, u zhvillua mbi bazën e njoftimit të publikuar në Buletinin e APP nr.46, datë 21.11.2016, për shpalljen e procedurave konkurruese.

Për zonën minerare nr.2/6, objekti Rasek, Qarku Shkodër, në sallën e mbledhjeve, kati i parë, në datën 21.12.2016, ora 10⁰⁰ është paraqitur vetëm një ofertë nga subjekti konkurrues;

o Subjekti “B. C.” sh.p.k:

Komisioni i vlerësimit të ofertave mori në shqyrtim dokumentacionin e paraqitur nga shoqëria “B. C.” sh.p.k nga ku konstatoi se dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria është në përputhje me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet Standarde të Procedurës Konkurruese.

Për këtë procedurë, Kryetari i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, z. K. B. i ka propozuar Ministrin të Energjisë dhe Industrisë z. D. Gj., si Titullar i Autoritetit Kontraktues, shpalljen fitues të shoqërisë “B. C.” sh.p.k të drejtën për aplikim për leje minerare pranë institucionit QKB për zonën minerare konkurruese nr.2/6, për objektin Rasek, Qarku Shkodër, lloji i mineralit gëlqeror i mermerizuar, veprimtaria shfrytëzim.

Me shkresën nr.678/2 prot, datë 21.02.2017, është dërguar njoftimi i fituesit, drejtuar shoqërisë “B. C.” sh.p.k me shkresën nr. 678/4 prot, datë 21.02.2017 është dërguar njoftimi i fituesit Agjencisë së Prokurimit Publik.

Në argumentimin e grupit të auditimit, pas shqyrtimit të dokumentacionit fizik konstatohet se KVO ka kualifikuar ofertën në përputhje me VKM nr.320, datë 21.04.2011, e ndryshuar me VKM nr. 301, datë 20.04.2016.

Me marrjen e njoftim fituesit lind e drejta për të aplikuar për pajisje me leje minerare shfrytëzim, duke aplikuar në QKB. AKBN kryen Akt – Verifikim për të kontrolluar koordinatat e zonës, objektet e banimit në afërsi të zonës, infrastrukturën rrugore dhe energjetike.

Me shkresë nr. 4145 prot, datë 22.05.2017 është miratuar Akt Miratimi Leje Mjedisi Tipi B, për personin juridik “B. C.” sh.p.k. Procedurat e aplikimit për këtë leje janë trajtuar në drejtimin 2.2 të këtij RPA.

Mbi procedurat e aplikimit për pajisjen me leje minerare të shfrytëzimit.

Me Akt-Miratimin nr.1835 për pajisje me Leje Minerare Shfrytëzimi për mineralin “Gëlqeror i mermerizuar”, të subjektit “B. C.” sh.p.k për kërkesën në Qendrën Kombëtare të Biznesit me LC - 9456-03-2017, datë 15.03.2017. Ky akt miratimi shoqërohet me aktin e verifikimit të AKBN-së, oponencën e projektit të zhvillimit të veprimtarive minerare të shfrytëzimit dhe vendimin e Këshillit Teknik të AKBN.

Me vendimin nr.549, datë 05.05.2017 “Për shqyrtimin dhe vlerësimin e projektit të zhvillimit të aktiviteteve minerare dhe përcaktimeve për vlerat e garancive financiare për realizimin e programit të investimit dhe realizimin e planit të rehabilitimit të zonës minerare”, Këshilli

Teknik i AKBN, në mbledhjen e datës 05.05.2017, pasi u njoh me vlerësimin për kushtet e lejit dhe dokumentet vërtetuese për aplikimin në QKB për leje Minerare shfrytëzimi, të subjektit “B. C.” sh.p.k, bazuar në shkresën e MEI nr.678/2, datë 21.02.2017 vendosi të miratojë lejen minerare të shfrytëzimit, duke specifikuar dhe koordinatat në plan të zonës së lejuar minerare.

Nr.	Koordinatat	
	Y	X
1	4667646	4383130
2	4668248	4382965
3	4668275	4383718
4	4669083	4383647
5	4669140	4384121
6	4668257	4384244
7	4668257	4383758
8	4667740	4383693

Referuar Akt-Miratimit nr.1835, datë 30.06.2017, për koordinatat në planin e zonës së lejuar minerare për zhvillimin e veprimtarisë së shfrytëzimit (*sipas praktikës së KVO bashkëlidhur*), nuk përputhen me situatën faktike në terren ku subjekti ushtron aktivitetin. Për këtë rast, subjekti ku ushtron aktivitetin, miratuar sipas koordinatave shtetërore në planin horizontal, dhe të dhënat gjeologo-minerare për objektin “B. C.” sh.p.k, për zonën 2/6, në Rasek Shkodër, referuar hartës topografike në shkallë 1:25000, koordinatat e miratuara janë në vijë ajrore 200 m nga banesat zonës.

Referuar legjislacionit Shqiptar, distanca e shfrytëzimit minerar nga banesat përcaktohet nga Ligji nr.10304, datë 15.07.2010, i ndryshuar me Ligjin nr.65/2021. Ky ligj përfshin masa mbrojtëse për komunitetet pranë zonave minerare, duke kërkuar që lejet minerare të jepen pas konsultimeve me ministritë përgjegjëse për mjedisin, tokën bujqësore dhe zonat e mbrojtura.

Ligji minerar në Shqipëri ka një ndikim të rëndësishëm në jetesën e banorëve të zonave përreth aktiviteteve minerare. Ndër efektet kryesore janë:

Mjedisi dhe shëndeti: Aktivitetet minerare mund të shkaktojnë ndotje të ajrit, ujit dhe tokës, duke ndikuar në shëndetin e banorëve. Ligji përfshin masa për mbrojtjen e mjedisit dhe rehabilitimin e zonave pas shfrytëzimit.

Ekonomia lokale: Lejet e shfrytëzimit minerar mund të krijojnë vende pune dhe të sjellin investime në zonat përreth, por gjithashtu mund të shkaktojnë zhvendosje të popullsisë dhe ndryshime në strukturën pranë këtyre vendeve.

Konsultimi me komunitetin: Ligji kërkon që lejet minerare të jepen pas konsultimeve me ministritë përgjegjëse dhe komunitetet lokale, duke synuar të minimizojë ndikimet negative dhe të sigurojë përfitime për banorët, për të cilën dhe kjo pikë është e paplotë.

Si përfundim, mund të themi se, ligji minerar, ka një ndikim të rëndësishëm në shëndetin e njerëzve, veçanërisht për ata që jetojnë pranë zonave minerare. Disa nga efektet kryesore përfshijnë:

Ndotja e ajrit: Aktivitetet minerare mund të çlirojnë pluhur dhe substanca toksike në ajër, duke rritur rrezikun e sëmundjeve respiratore.

Ndotja e ujit: Mbetje minerare mund të ndotin burimet ujore, duke ndikuar në cilësinë e ujit të pijshëm dhe shëndetin e komuniteteve përreth.

Afërsia pranë banesave: Banorët pranë guroreve ku ushtrohet në lejet e shfrytëzimit minerar përballen me risqe të larta, si, ekspozimi ndaj gazrave toksikë pluhurat në ajër.

Ndikimi psikologjik: Banorët pranë zonave minerare mund të përjetojnë stres dhe shqetësime për sigurinë e tyre dhe të familjeve të tyre.

Mbi nënkontraktimin e subjektit “NGA G” shpk.

Me shkresë nr. 4809/1 prot., datë 24.04.2018 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë është miratuar nënkontraktimi i subjektit “NGA G” sh.p.k me Nipt LP i së drejtës për Lejen minerare

Nr.1835, datë 30.06.2017, për shfrytëzimin e mineralit gëlqeror të mermerizuar në vendburimin “Rasek” Shkodër (kërkesa me Nr.24-18-02 prot., datë 02.02.2018 e shoqërisë “B. C.” sh.p.k. - Marrëveshje Nënkontraktimi Nr.954 rep Nr.546 Kol, datë 22/02/2018 midis “B. C.” sh.p. k me Nipt JB, përfaqësuar nga z. P. B. dhe “NGA G” sh.p. k me Nipt LP, përfaqësuar nga z. A. Sh.. Referuar Ligji nr. 10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 17/1, pika 3: “Zotëruesi i lejes minerare është përgjegjës përpara strukturave përgjegjëse për zbatimin e kushteve e të kërkesave të lejes minerare, si dhe për përmbushjen e detyrimeve të tjera, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Zotëruesi i lejes minerare dhe nënkontraktori janë përgjegjës përpara strukturave përgjegjëse për zbatimin e kushteve dhe rregullave të sigurimit teknik në zonën, në të cilën ushtrohet aktiviteti minerar i nënkontraktuar. Përgjegjësitë për zbatimin dhe respektimin e rregullave të sigurimit teknik përcaktohen në marrëveshjen e nënshkruar midis palëve”; Udhëzimi nr. 17, datë 28.01.2014 i Ministrit të MIE “Për përcaktimin e kriterëve për miratimin e nënkontraktimit të së drejtës minerare për kërkim-zbulim- shfrytëzim dhe shpërndarje”.

Objekti dhe qëllimi i Marrëveshjes së Nënkontraktimit: Gjatë punimeve në karrierë kanë lindur mosmarrëveshje dhe pretendime pronësie në një pjesë të sipërfaqes, mbi përroin e fshatit Rasek, në pjesën e fshatit Domen, në zonën sipas koordinatave të përcaktuara në këtë marrëveshje. Për këtë arsye, për zgjidhjen e konflikteve me pretenduesit joligjor “B. C.” sh.p.k lidh këtë marrëveshje me “NGA G” sh.p.k.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për pajisjen me leje minerare të subjekteve “B. C.” sh.p.k. dhe “NGA G” sh.p.k., si dhe nga analiza e shkresave zyrtare dhe e korrespondencës institucionale midis palëve, nuk është evidentuar ndonjë dokument, provë apo akt zyrtar që të vërtetojë ekzistencën e një konflikti apo pretendimi të ligjshëm pronësor në zonën në fjalë.

Pretendimi për “konflikt pronësie” nuk mbështetet në vendime gjyqësore, certifikata pronësie apo dokumente të tjera ligjore, dhe si i tillë nuk përbën një bazë të mjaftueshme juridike për kalimin e të drejtave të shfrytëzimit minerar tek një palë e tretë. Në këtë kontekst, marrëveshja nuk mbështetet në dokumentacion zyrtar siç përcaktohet në Ligjin nr. 10304/2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimi nr. 17, datë 28.01.2014 i Ministrit të MIE “Për përcaktimin e kriterëve për miratimin e nënkontraktimit të së drejtës minerare për kërkim-zbulim- shfrytëzim dhe shpërndarje”.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. N. A. dhe Zv.Ministri z. I. B..

Mbi shpronësimin e fondit kullor

-Përsa i përket shpronësimit të fondit kullor për lejet minerare në Shqipëri, ajo përfshin disa faza kryesore, të cilat janë të përcaktuara në Ligjin Nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullor”. Disa nga hapat kryesorë janë:

Identifikimi i zonës – Përcaktohet zona e kullotës që do të shpronësohet për aktivitet minerar, duke marrë në konsideratë ndikimin në mjedis dhe komunitetin lokal.

Vlerësimi i pronës – Kryhet një vlerësim i fondit kullor për të përcaktuar vlerën e kompensimit për pronarët ose njësitë vendore.

Miratimi nga autoritetet – Këshilli i Ministrave dhe institucionet përkatëse miratojnë shpronësimin, duke u bazuar në studime të ndikimit mjedisor dhe ekonomik.

Zbatimi i projektit minerar – Pas përfundimit të procesit të shpronësimit, subjektet minerare mund të fillojnë aktivitetin e tyre në zonën e përcaktuar.

Shpronësimi i fondit kullor në Shqipëri kalon në administrim të ministrisë përkatëse pas përfundimit të disa fazave ligjore dhe procedurale, sipas kërkesave të Ligjit nr.9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullor”, fondi kullor mund të administrohet nga ministria përgjegjëse për mjedisin dhe burimet natyrore pas miratimit nga Këshilli i Ministrave.

Pas pajisjes me Lejes minerare subjekti “B. C.” sh.p.k, zotërues i lejes minerare nr.1835, datë

30.06.2017, ka bërë kërkesën në MIE për heqjen e fondit pyjor të sipërfaqes së miratuar për aktivitet minerar, sipas Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010 me ndryshime, neni 24 pika 10; Ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, neni 17 pika 1.

Përmbledhje e komunikimeve dhe shkresave zyrtare ndërmjet subjektit “B. C.” sh.p.k., zotërues i lejes minerare, dhe autoriteteve shtetërore kompetente, në funksion të kalimit të sipërfaqes së licencuar minerare në zonën nr. 2/6 “Rasek”, Shkodër, nga fondi pyjor/kullosor në pronë shtetërore me destinacion pasuri minerare.

- Me shkresë nr.261-17-11, datë 2.11.2017 drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë është kërkuar nga subjekti kalimi i zonës së lejuar të shfrytëzimit nga fondi pyjor kullosor në pronë shtetërore si pasuri minerare në varësi të MIE, për të cilën është administruar vetëm kërkesa zyrtare e subjektit.

- Me shkresë nr 1410/1 datë 7.12.2017 MIE i propozon Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit heqjen e fondit pyjor të sipërfaqes së miratuar për aktivitet minerar, sipas Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, me ndryshime, neni 24, pika 10 dhe VKM-së nr. 1353, datë 10.10.2008.

Sipërfaqja e fondit pyjor/kullosor Rrosek- Drisht.

- Drejtoria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave në Bashkinë Shkodër me shkresë nr. 179 prot., datë 07.01.2019 drejtuar Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN) dhe MTM-së dhe me shkresë nr.16516 prot., datë 03.11.2022 drejtuar AKBN-së dhe Agjencisë Kombëtare të Pyjeve (AKP), ku ka kërkuar nga AKBN që: të mos lejohet subjekti të kryejë aktivitet shfrytëzues deri në heqjen e sipërfaqes së lejuar për aktivitet minerar prej 78.5 ha nga fondi pyjor/kullosor, pronë e Bashkisë Shkodër, në zbatim të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010 me ndryshime, neni 24 pika 10; Ligjit nr. 9385 datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, neni 17 pika 1.

- Drejtoria e Monitorimit të Hidrocentraleve në AKBN, me shkresë nr. 4635/1 prot., datë 05.12.2022, ka kthyer përgjigje Bashkisë Shkodër, duke shpjeguar se subjekti “B. C.” sh.p.k është zotërues i lejes minerare nr. 1835, datë 30.06.2017, për objektin "Rasek"; ka miratim nga MIE për nënkontraktorin "NGA G" sh.p.k dhe vepron në përputhje me Ligjin nr.10304, datë 15.07.2010. AKBN sqaron gjithashtu se, nuk ka kompetencë për pezullimin e aktivitetit minerar për shkak të mos heqjes së sipërfaqes nga fondi pyjor/kullosor.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (Drejtoria e Natyrës dhe Pyjeve, Sektori i Pyjeve dhe Kullotave) dhe Agjencia Kombëtare e Pyjeve (AKP): znj. K. M. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Natyrës dhe Pyjeve; z. Y. H. me detyrë ish Drejtor i Drejtorisë së Mbrojtjes dhe Trajtimit të Pyjeve; z. P. A. me detyrë ish Drejtor i Përgjithshëm i Politikave Mjedisore dhe Jetësimit të Prioriteteve (larguar).

Në lidhje me Projekt Raportin e Auditimit në zbatim të programit të auditimit "Për auditimin e procedurave të dhënies së lejeve, licensave dhe monitorimin e aktivitetit minerar me vendodhje në Rasek, Shkodër", është paraqitur observacioni me nr. 5976/2 prot., datë 18.09.2025, administruar nga Drejtoria e Natyrës dhe Pyjeve në MTM si më poshtë:

Pretendimi i MTM: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (Drejtoria e Natyrës dhe Pyjeve, Sektori i Pyjeve dhe Kullotave), kryen procedurat e heqjes nga fondi pyjor të sipërfaqeve pyjore për aktivitete të cilat disponojnë leje shfrytëzimi minerar, miratuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Në rastin konkret, subjekti “B. C.” sh.p.k ka paraqitur kërkesë për heqje nga fondi pyjor në MIE, nëpërmjet shkresës nr. 1410/1 prot., datë 7.12.2017, bazuar në referencën e VKM nr. 1353/2008, pika 5, shkronja a), duke vënë në dijeni edhe subjektin, i cili nuk ka vijuar me procesin.

Bazuar në sa më sipër si dhe në bazën ligjore për pyjet, subjekti ka detyrimin e plotësimit të dokumentacionit sipas referencave të cituara më lart. Kjo gjë nuk ka ndodhur, ky subjekt nuk ka paraqitur asnjëherë, si kërkesë ashtu edhe dokumentacionin e duhur për të kryer procedurat e heqjes nga fondi pyjor. Citojmë se në asnjë rast, as në bazën ligjore të vjetër dhe as në bazën

ligjore të re, nuk citohet se Ministria e Turizmit dhe Mjedisit duhet të njoftojë subjektin për të bërë kërkesën për heqjen nga fondi pyjor. Sa i takon Rekomandimit nr. 5.1. ju informojmë se: MTM (Drejtoria e Natyrës dhe Pyjeve) sipas legjislacionit në fuqi, nuk ka funksion inspektimi por është politikë bërëse dhe nuk është institucioni që kryen pezullimin e punimeve. Gjithsesi, në çdo rast, do të bashkëpunojë me Bashkinë Shkodër dhe strukturat kontrolluese për zgjidhjen e problematikës së krijuar.

Qëndrimi i grupit të auditimit: MTM dhe AKP si institucione qendrore përgjegjëse për mirë administrimin e fondit pyjor kombëtar kanë detyrimin që të mbështesin, këshillojnë dhe të marrin masa në rast të shkeljes së ligjit për pyjet dhe gjithashtu janë kontrolluese të veprimtarisë menaxhuese të strukturave përgjegjëse për pyjet në nivel vendor. Në rastin konkret, MTM është vënë në dijeni nga Bashkia Shkodër, për zhvillimin e aktivitetit të paligjshëm në fondin pyjor/kullosor, objekt i shfrytëzimit minerar në ekonominë pyjore Rasek, Shkodër, çka bëhet përgjegjëse për këtë paligjshmëri. Gjithsesi, nga ana e saj, MTM konfirmon se në çdo rast do të bashkëpunojë me Bashkinë Shkodër dhe strukturat kontrolluese për zgjidhjen e problematikës së krijuar.

Theksojmë se, Sektori i pyjeve në Republikën e Shqipërisë është i organizuar në dy nivele qeverisjeje *me funksione dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë në Ligjin nr. 57/2020 “Për Pyjet”*. -Në nivel qendror ku përfshihet ministria përgjegjëse si organ politikëbërës dhe rregullator, si dhe Agjencia Shtetërore për Pyjet, në varësi të ministrit, e cila ka si funksion sigurimin e mirëqeverisjes dhe kontrollit të veprimtarive në fondin pyjor kombëtar.

Sipas nenit 15, pika 1, gërma “c”, Agjencia “harton dhe përmirëson kuadrin ligjor rregullator në fushën e pyjeve, monitoron zbatimin dhe efektivitetin e tij, si dhe përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga marrëveshjet ndërkombëtare për pyjet”;

nenit 15, pika 2, gërma “ë”, Agjencia është përgjegjëse për “garantimin e funksionalitetit të sistemit të kontrollit dhe të inspektimit të veprimtarive që zhvillohen në fondin pyjor kombëtar, duke ndërhyrë sipas përcaktimeve në këtë ligj”.

Po ashtu, sipas nenit 35, pika 3, gërma “a” dhe “b”, strukturat e specializuara pranë ministrisë përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit kanë rolin e parandalimit, zbulimit dhe procedimit të veprave penale kundër pyjeve, si dhe detyrimin për të bashkëpunuar me strukturat vendore sipas nevojës: *a) të garantojnë mbrojtjen dhe sigurinë e pyjeve përmes parandalimit, zbulimit dhe hetimit të veprave penale kundër pyjeve dhe procedimit penal të autorëve të tyre në përputhje me parashikimet e legjislacionit penal; b) të bashkëpunojnë me strukturat përgjegjëse për kontrollin në pyje sipas këtij ligji dhe i mbështesin ato sipas kërkesës dhe nevojës”.*

-Në nivel vendor, Bashkia, në bazë të nenit 16, pika 1 të të njëjtit ligj, është struktura e specializuar për administrimin e fondit pyjor në pronësi të saj, me kompetenca menaxhuese, kontrolluese dhe këshillimore.

Për më tepër në nenin 35, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”, “ç”, Bashkia ka detyrimin ligjor të ndërhyjë në rastet e konstatimit të shkeljeve, ku janë të përcaktuar qartë për çdo rast masa që duhet të merret, duke garantuar ekzekutimin e veprimtarive në përputhje me dokumentet planifikuese, normat teknike dhe kuadrin ligjor në fuqi.

Bashkia Shkodër ka në pronësi dhe në administrim fondin pyjor dhe kullosor brenda territorit të saj administrativ dhe nëpërmjet strukturave për pyjet është përgjegjëse për mbrojtjen e fondit pyjor të bashkisë. Detyrim ky që buron nga Ligji nr. 152/2015, neni 49, pika ç; Ligji nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 27; Ligji nr. 57/2020 “Për Pyjet” neni 30, pika 1, gërma “ç”, pika 2 konkretisht: *“Çdo veprimtari që cënon ekuilibrin e sistemeve ekologjike, natyrore ose dëmton të mirat materiale dhe vlerat kulturore e historike, e realizuar nga cilido institucion shtetëror, qendror apo vendor, personat fizikë a juridikë, vendas a të huaj” dhe pika 2, 2. “Mbrojtja e fondit pyjor kombëtar, pavarësisht nga forma e pronësisë, është detyrë e përhershme e strukturave përgjegjëse për pyjet në nivel qendror dhe vendor, e pronarëve privatë, e subjekteve që kryejnë veprimtari në këtë fond dhe sipas rastit, edhe e strukturave të tjera shtetërore të ngarkuara nga ligje të tjera”.*

Sipas nenit 24, pika 10 të Ligjit nr. 10304/2010 “Për sektorin minerar”, nenit 17, pika 1 të Ligjit nr. 9385/2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, nenit 34 pika 3 të Ligjit nr. 57/2020 “Për Pyjet”, procedura e heqjes nga fondi pyjor është kompetencë ekskluzive e organeve qendrore konkretisht, e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe institucioneve të varësisë së saj. Bashkia në këtë proces ka rol konsultativ dhe dhënien e mendimit teknik, por nuk mban përgjegjësi vendimmarrëse për aktivitetet minerare që kërkojnë ndryshimin e destinacionit të këtyre sipërfaqeve.

Në përputhje me nenin 34, pika 3, gërma “b” dhe pikën 5, gërmat “b, c, d, ç” të Ligjit nr. 57/2020 “Për Pyjet”, Bashkia Shkodër ka detyrimin ligjor për të ushtruar kontroll mbi veprimtaritë në fondin pyjor kombëtar, në përputhje me dokumentet planifikuese për pyjet, normat dhe standardet e miratuara dhe kushteve të lejeve apo kontratave të nënshkuara midis strukturave përgjegjëse për pyjet dhe subjekteve përkatëse.

Në këtë kontekst, konstatohet se Bashkia Shkodër, në cilësinë e strukturës përgjegjëse për inspektimin dhe mbikëqyrjen e përdorimit të fondit pyjor, nuk ka ndërmarrë masat e nevojshme administrative për bllokimin dhe procedimin e subjekteve “B. C.” sh.p.k. dhe “NGA G” sh.p.k, dhe konstatohet se:

- Nuk rezulton të ketë ndjekur apo iniciuar vetë procedurën e plotë për ndryshimin e kategorisë së përdorimit të fondit pyjor/kullor.
- Edhe pse ka ngritur shqetësimin dhe ka bërë kërkesë për ndalimin e aktivitetit, nga Bashkia nuk rezultoi të ketë përgatitur ose dërguar dokumentacionin ligjor të nevojshëm për heqjen nga fondi pyjor në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.
- Në komunikimin e fundit (Maj 2024) theksohet se aktiviteti vijon normalisht, pavarësisht se nuk është realizuar ndryshimi i destinacionit të zërit kadastral, ç’ka tregon se nuk ka ushtruar kontroll efektiv për ndalimin e aktivitetit të paligjshëm dhe nuk ka ndërmarrë masa konkrete ndaluese në terren.
- Nuk ka ofruar dokumentacion nga ana e strukturave përgjegjëse (akte, vendime, inspektime të kryera), që të dëshmojnë ndjekje më të thelluar të rastit, sipas kërkesave dhe sanksione të parashikuara në aktet ligjore në fuqi.
- Me shkresë nr. 9401 prot., datë 03.05.2024, Bashkia Shkodër ka kërkuar nga subjekti “B. C.” sh.p.k dhe Agjencia Kombëtare e Pyjeve (AKP) që të ndjekin procedurat për heqjen nga fondi pyjor/kullor të sipërfaqes që shfrytëzohet nga Leja Minerare me kod: PN-IV.I B.2, datë 05.06.2017, në përputhje me Ligjin nr. 57/2020 “Për pyjet” dhe VKM nr. 888, datë 27.12.2022 “Për rastet e dhënies në përdorim dhe ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimin e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre” pika I dhe II, ku saktësohet dokumentacioni i nevojshëm për heqjen e sipërfaqeve nga fondi pyjor/kullor të sipërfaqeve në të cilat ushtrohet aktiviteti minerar.
- Subjekti “B. C.” sh.p.k nuk ka plotësuar dokumentat në aplikim për vijimin e proceduarave për heqjen nga fondi pyjor.
- Përgjigja e shoqërisë “B. C.” sh.p.k, me shkresë nr. 11 prot., datë 10.05.2024, se është në pritje të Vendimit të Këshillit të Ministrave për heqjen nga Fondi Pyjor dhe ka bashkëlidhur kërkesën dhe shkresat e sipërpërmendura nga ministritë përkatëse, ndërsa në fakt zhvillon aktivitetin që nga momenti i marrjes së lejes minerare.

Ky dokumentim reflekton një proces të gjatë procedural dhe në kohë, kërkesash të ndryshme nga autoritetet përgjegjëse përkatëse: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Pyjeve, konfirmuar zyrtarisht, që janë në dijeni të zhvillimit të aktivitetit minerar të subjektit “B. C.” sh.p. k dhe nënkontraktorit “NGA G” sh.p.k pa kryer procedurën e heqjes nga fondi pyjor dhe se nuk rezulton të jenë marrë masa në zbatim të legjislacionit për pyjet dhe shërbimin pyjor. Ndërkohë, sipas AKBN-së, AKM-së dhe Bashkisë Shkodër vërtetohet se subjektet vazhdojnë aktivitetin minerar shfrytëzues normalisht.

Kësaj problematike është shtuar edhe shqetësimi ndër vite i banorëve të zonës, prej fillimit të ushtrimit të aktivitetit minerar në këtë zonë (viti 2018), me pretendimin e tyre të ripërsëritur për dëmtim të ujit të pijshëm dhe Ujësjellësit të zonës Postrisë-Shkodër; të shkatërrimit të mjedisit dhe të zonës arkeologjike.

Për nevoja të auditimit, nga grupi i auditimit, u kërkua informacion dhe dokumenta mbështetëse, vërtetuese në lidhje me ecurinë e procedurave të ndjekura nga MTM dhe problematikat, ku na u vunë në dispozicion: shkresat e sipërcituara me nr. 261/17-11 datë 12.11.2017; me nr. 1410/1 prot., datës 07.12.2017; Akti i miratimit të Lejes minerare nr.1835, datë 30.6.2017; Akti i miratimit të Lejes mjedisore me Nr.4145 prot., datë 22.05.2022 (LC-1014); shkresë nr. 179 prot., datë 07.01.2019, si dhe shkresat e mëposhtme:

➤ Shkresa pa nr. prot., pa datë, e Sekretarit të Përgjithshëm të MTM-së (P.N.), drejtuar shoqërisë “B. C.” sh.p.k për dijeni Sekretarit të Përgjithshëm të MIE ku, kërkohet plotësim dokumentacioni për heqjen e sipërfaqes së miratuar për aktivitet minerar nga fondi pyjor: harta dixhitale me ngastrat pyjore/kullosore që preken, dakortësia me shkrim nga kryetari i bashkisë, pagesat e procedurës që kryen ministra. Shkresa përmban personat që kanë punuar në formulimin e saj, miratoi: P. A., K. M., Y. H.; punoi: A.T..

Shkresa nuk përmban elementët përbërës të saj si: nr. prot., datë, nënshkrimin e dërguesit që është Sekretari i Përgjithshëm i MTM-së. Për këtë arsye grupi i auditimit iu drejtua serish ministrisë, ku rikërkon shkresën e plotë dhe të saktë, ndërsa përgjigja ishte se nuk disponohej nga Sektori i Pyjeve.

➤ Shkresa nr. 2834 prot., datë 11.04.2025 e Sekretarit të Përgjithshëm të MTM-së (L.B.A), drejtuar bashkive (pa adresuar konkretisht), për dijeni Agjencisë Kombëtare të Pyjeve ku kërkohet: “Në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së për lidhjen e kontratave të pyllëzimit kompesues apo pagesat për detyrimin e pyllëzimit kompesues sipas aktit të miratimit të heqjes nga fondi pyjor. Gjithashtu, struktura e menaxhimit të pyjeve, që nuk kanë bërë kërkesë për heqje nga fondi pyjor, t’u kërkojë subjekteve që nuk kanë bërë kërkesë për heqje nga fondi pyjor të kryejnë aplikimin online dhe të njoftojë Agjencinë Kombëtare të Pyjeve, e cila kryen monitorimin e këtij procesi, duke njoftuar ministrinë”.

Shkresa nuk specifikon se cilës bashki i është adresuar dhe nuk i referohet rastit konkret, pasi kërkesa nga subjekti për heqje nga fondi pyjor është bërë që në momentin e marrjes së lejes, në nëntor 2017. Kjo kërkesë është përsëritur nga Drejtoria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave në Bashkinë Shkodër me shkresat nr. 179 prot., datë 07.01.2019 dhe nr. 16516 prot., datë 03.11.2022, drejtuar AKBN-së dhe AKP-së, por deri më tani nuk ka pasur vijim të procesit nga këto institucione. Nga Agjencia Kombëtare e Pyjeve nuk ka përgjigje, e konfirmuar edhe nga MTM¹.

• **Nga verifikimi në terren nga grupi i auditimit të KLSH-së, më datë 01.04.2025**, në prani të përfaqësuesve të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore dhe Bashkisë Shkodër, u konstatua se objekti minerar ndodhet në një distancë afërsisht 150 metra nga zona ku nënkontraktori “NGA G” sh.p.k. ushtron aktivitetin minerar.

Në këtë zonë u evidentua prania e mbetjeve të aktivitetit minerar shfrytëzues (mbetje sterile), të përbëra nga gurë me përmasa të ndryshme, dhe dhera të depozituara në mënyrë të pakontrolluar. Sipas deklaramentit të përfaqësuesit të AKBN-së gjatë inspektimit, këto mbetje janë hedhur në një sipërfaqe që ndodhet jashtë perimetrit të lejes minerare së miratuar për subjektin.

Kjo sipërfaqe rezulton t’i jetë dhënë subjektit në kujdestari për gjithë periudhën e lejes minerare, nga Bashkia Shkodër, bazuar në procesverbalin nr. 33 prot., datë 10.02.2022, me objekt “*Marrja në kujdestari e një sipërfaqeje pyjore deri në përfundimin e lejes minerare*”, për një sipërfaqe kullosore prej 1.8 ha, e cila në masën 80% është e mbuluar me gurë të lëvizshëm e pjesë shkëmbore, që kërkohet për sistemim materialesh të mermerta gjatë periudhës së kryerjes së punimeve. Sipërfaqja e dorëzuar përfshihet në ekonominë kullosore “Rasek-Rrjoll”, në Parcelën

¹ E-mail nga Aida Tafili specialist në Sektorin e Pyjeve dhe Kullotave, në Drejtorinë e Natyrës dhe Pyjeve në MTM, datë 10.06.2025.

nr.7 dhe është nënshkruar ndërmjet z. A. L., në cilësinë e Përgjegjës të Drejtorisë së Shërbimeve Bujqësore dhe Pyjore në Bashkinë Shkodër, dhe z. A. Sh., administrator i subjektit “NGA G” sh.p.k. Ky veprim përbën shkelje të Ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010, “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, konkretisht nenit 36 pika 18 - Detyrimet e përgjithshme gjatë ushtrimit të veprimtarisë minerare. Përveç sa parashikohet në këtë ligj, për çdo tip lejeje minerare, zotëruesi i saj, gjatë periudhës së vlefshmërisë, ka edhe këto detyrime: “*Të respektojë të gjitha kërkesat për depozitim, trajtim dhe menaxhimin e mbetjeve minerare dhe trajtimin e ujërave që dalin nga objektet minerare dhe ato të depozitimit të mbetjeve*”; pika 19 “*Të përgjigjet për dëmet që u ka shkaktuar shtetit dhe palëve të treta, sipas legjislacionit në fuqi*”; si dhe të Ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; Ligji nr. 9385 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar; Ligji nr. 57/2020 “Për pyjet”; Ligji nr. 9693, datë 19.3.2007, “Për fondin kullor”, të ndryshuar; VKM nr.1353 datë 10.10.2008; Vendim nr. 888, datë 27.12.2022.

Theksojmë se ligji nr.10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në RSH”, i ndryshuar, neni 15 pika 5. **Me miratimin e lejes minerare të shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet, zona e lejuar e shfrytëzimit hiqet nga fondi pyjor e kullor, pronë shtetërore “Tokë e zënë, tokë me bimësi pyjore” dhe regjistrohet në zërin “Tokë e zënë, objekt shfrytëzimi për ushtrimin e veprimtarisë minerare”, sipas legjislacionit në fuqi për ndryshimin e zërit kadastral të fondit pyjor e kullor. Brenda 10 ditëve nga miratimi i lejes, zotëruesi i saj përgatit dokumentacionin përkatës dhe e dorëzon pranë ministrisë përgjegjëse për veprimtarinë minerare, e cila brenda 10 ditëve përgatit aplikimin dhe e dërgon pranë ministrisë përgjegjëse për mjedisit.**

Në rastin konkret ku sipërfaqja e dhënë për shfrytëzim minerar është 78.5 ha, heqja nga fondi pyjor, sipas Ligjit nr. 9385 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, bëhet me Vendim të Këshillit të Ministrave, ndërsa referuar ligjit 57/2020 bëhet me ligj të veçantë.

Kriteret ligjore si më poshtë:

Ligji nr.10304 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, datë 15.07.2010, i ndryshuar, Neni 24 pika 10. *Me miratimin e lejes minerare të shfrytëzimit me karrierë të grupit të mineraleve ndërtimore zona e lejuar e shfrytëzimit hiqet nga fondi pyjor e kullor, pronë shtetërore, zëri “Tokë e zënë, tokë me bimësi pyjore”, dhe regjistrohet në zërin “Tokë e zënë, objekt shfrytëzimi për ushtrimin e veprimtarisë minerare”, sipas legjislacionit në fuqi për ndryshimin e zërit kadastral të fondit pyjor e kullor. Brenda 10 ditëve nga miratimi i lejes, zotëruesi i saj përgatit dokumentacionin përkatës dhe e dorëzon pranë ministrisë përgjegjëse për veprimtarinë minerare, e cila brenda 10 ditëve përgatit aplikimin dhe e dërgon pranë ministrisë përgjegjëse për mjedisin.*

Ligji nr. 9385 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, datë 04.05.2005 neni 17 pika 1. *Pjesë të fondit pyjor kombëtar, që kërkohen nga subjekte juridike ose fizike apo nga organet e qeverisjes vendore, për t’u kthyer në truall, për zgjerimin e vijës kufizuese të ndërtimit dhe të shtrirjes territoriale të periferisë së qytetit e të qendrave të banuara në zonat rurale, për ndërtimin e strukturave turistike, të qendrave të pushimit apo ato shëndetësore ose për qëllime të tjera publike, për rrugë automobilistike apo hekurudhore, për shpim dhe shfrytëzim të puseve të naftës e të gazit, për veprimtari minerare e gjeologjike, për aeroporte dhe struktura të telekomunikacionit, për qëllime të strukturave ushtarake, qendra industriale, hiqen nga fondi pyjor dhe nga Kadastra Kombëtare e Pyjeve, si më poshtë:*

a) pyjet dhe tokat me bimësi pyjore, me sipërfaqe deri në 1 ha, me miratimin e ministrit;

b) pyjet dhe tokat me bimësi pyjore, me sipërfaqe mbi 1 ha e deri në 100 ha, me vendim të Këshillit të Ministrave c) pyjet dhe tokat me bimësi pyjore, me sipërfaqe mbi 100 ha, me ligj të veçantë.

VKM nr.1353 datë 10.10.2008 “Për përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik dhe procedurat për zvogëlimin e sipërfaqes dhe vëllimit të fondit pyjor” pika 7 *Ministria, pas depozitimit të kërkesës, i kërkon strukturës përgjegjëse për*

pyjet dhe kullotat në bashki identifikimin e ngastrave e të nën ngastrave të kërkuara dhe hartimin e raportit teknik për to, brenda 1 jave nga data e marrjes së kërkesës. Ky raport i përcillet ministrisë brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data që ajo e ka kërkuar. Kur heqja kërkohej nga fondi pyjor bashkiak, drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor e harton raportin teknik, në bashkëpunim me njësinë tekniko-administrative të pyjeve e kullotave, të bashkisë. Pika 8/b ministria përgatit projektvendimin për heqjen nga fondi pyjor, për pyje dhe toka, me bimësi pyjore, me sipërfaqe mbi 1 ha e deri në 100 ha dhe e dërgon atë, për shqyrtim e miratim, në Këshillin e Ministrave.

Vendim Nr. 888, datë 27.12.2022 “Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor” pika 5. Struktura përgjegjëse për pyjet në ministri, nëse vlerëson se dokumentacioni është i plotë, sipas pikës 2, të kreut III, të këtij vendimi, dhe është në përputhje me rastet e përcaktuara në pikën 14, të këtij kreu, përcjell kërkesën për hartimin e raportit tekniko-ekonomik dhe dhënien e dakordësisë, njësisë së vetëqeverisjes vendore, kur sipërfaqja pyjore, objekt i ndryshimit të kategorisë së përdorimit, është në pronësi të saj ose në pronësi private.

Ligjin Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore.

Neni 26 Funksionet e bashkive në fushën e mbrojtjes së mjedisit Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve: 1. Sigurimin, në nivel vendor, të masave për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, tokës dhe ujit nga ndotja. 2. Sigurimin, në nivel vendor, të masave për mbrojtjen nga ndotja akustike. 3. Zhvillimin e aktiviteteve edukuese dhe promovuese, në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e mjedisit. Neni 27 Funksionet e bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve. 5. Administrimin e fondit pyjor dhe kullësor publik, sipas legjislacionit në fuqi. 6. Mbrojtjen e natyrës e të biodiversitetit, sipas legjislacionit në fuqi.

Ligji nr. 57/2020 “Për pyjet”.

Neni 34 Kontrolli i veprimtarive në fondin pyjor kombëtar, pika 2. Kontrolli ushtrohet për veprimtaritë e shfrytëzimit dhe të shërbimeve në pyje, të cilat realizohen nga strukturat përgjegjëse për pyjet, sipas këtij ligji, dhe/ose nga subjektet përkatëse, që iu është dhënë e drejta për veprimtaritë e shfrytëzimit apo të shërbimeve në pyje, duke kontrolluar të gjithë ciklin që nga dhënia e lejeve dhe inputet e përdorura, proceset e ndjekura në kryerjen e këtyre veprimtarive, cilësinë dhe përputhshmërinë me kërkesat (konformitetin) e rezultateve të arritura, si dhe aktivitetet përmblylëse rehabilituese sipas ligjit. 3. Funksioni i kontrollit ushtrohet nga:

a) struktura përgjegjëse në agjenci; b) struktura përgjegjëse kontrolluese/inspektuese në bashki; c) struktura përgjegjëse në zonat e mbrojtura. 4. Funksioni i kontrollit, që ushtrohet nga strukturat sipas pikës 3 të këtij neni, realizohet përmes proceseve të inspektimit, të cilat organizohen mbi bazën e riskut të vlerësuar dhe në përputhje me metodologjitë e programet përkatëse, duke u shtrirë përgjatë të gjithë ciklit të veprimtarive në pyje,

Ligji nr. 9693, datë 19.3.2007, “Për fondin kullësor”, të ndryshuar me (Ligjin Nr. 49/2016 Për Disa Ndryshime Dhe Shtesa Në Ligjin Nr. 9693, Datë 19.3.2007, “Për Fondin Kullësor”),

Neni 1 - emërtimi “drejtori rajonale e shërbimit pyjor” zëvendësohet me emërtimin “struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki”; - termi “komunë” zëvendësohet me termin “bashki”; - termi “kullotë komunale” zëvendësohet me termin “kullotë bashkiake”; - termi “organe të qeverisjes vendore” zëvendësohet me termin “bashki”. Neni 6 “Kompetencat e bashkive dhe të pronarëve privatë Bashkitë janë pronarë të kullotave shtetërore që gjenden brenda territorit administrativ të tyre. Bashkitë dhe pronarët privatë, që zotërojnë kullota dhe livadhe, kanë këto kompetenca: a) ruajnë, administrojnë dhe i përdorin kullotat dhe livadhet, në përputhje me kërkesat e këtij ligji e të akteve nënligjore, të dala në zbatim të tij; b) hartojnë, me shpenzimet e veta, planet e mbarështimit të kullotës apo livadhit, të cilat miratohen nga ministri përgjegjës për kullotat dhe livadhet; c) marrin masa për parandalimin e zjarreve dhe për shuarjen e tyre; ç) raportojnë në ministrinë përgjegjëse për kullotat dhe livadhet të dhënat, që u kërkohej për inventarizimin dhe regjistrimin në regjistrin e fondit kullësor të kullotave dhe livadheve, në përputhje me formularët tip”.

Konkluzion: Nga auditimi konstatohet se, edhe pse subjekti “B. C.” sh.p.k ka paraqitur kërkesën për heqjen nga fondi pyjor/kullor të sipërfaqes së propozuar për zhvillimin e aktivitetit mineral, në përputhje me nenin 24, pika 10 të Ligjit nr. 10 304, datë 15.07.2010 “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”, procedurat pasuese ligjore nuk janë ndjekur nga autoritetet përgjegjëse, konkretisht:

- Nuk është marrë akti për heqjen nga fondi pyjor/kullor nga autoritetet kompetente (Agjencia Kombëtare e Pyjeve).
- Nuk dokumentohet ndonjë vendim apo miratim për ndryshimin e statusit të përdorimit të tokës për qëllime minerare.
- Nuk rezulton të jetë bërë rivlerësimi i ndikimit mjedisor për këtë ndryshim, siç parashikohet nga legjislacioni për mjedisin dhe pyjet.
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Pyjeve, edhe pse janë vënë në dijeni nëpërmjet Bashkisë Shkodër dhe kërkesave të përsëritura nga subjekti “B. C.” sh.p.k, se aktiviteti i shfrytëzimit mineral zhvillohet nga viti 2018 e në vijim, nuk kanë marrë asnjë masë vepruese ose mosvepruese në cilësinë e autoritetit ligjor dhe politikbërës.

Si përfundim, procedura për kalimin e sipërfaqes së zonës minerare të shfrytëzuar së subjektit “B. C.” sh.p.k. nga fondi pyjor në pronë shtetërore me destinacion pasuri minerare, nuk rezulton të jetë ndjekur në përputhje të plotë me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Mungesa e zbatimit të hapave proceduralë të parashikuar në kuadrin ligjor pyjor dhe mineral tregon për një proces të paplotë, ndërkohë që aktiviteti mineral vijon të zhvillohet pa përfunduar ligjërisht dhe teknikisht procedurën e heqjes nga fondi pyjor.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: znj. V. A. në cilësinë ish Kryetar i Bashkisë Shkodër; z. B. S. në cilësinë ish Kryetar i Bashkisë Shkodër; z. B. B. në cilësinë Drejtor i Drejtorisë së Monitorimit, në vitin 2023; z. A. Gj. në cilësinë ish N/Kryetar i Bashkisë Shkodër; znj. A. Sh. në cilësinë Drejtor i Mjedisit dhe Energjisë Rinovueshme; znj. A. T. në cilësinë K/Inspektore e Administrimit dhe Inspektoratit të Pyjeve; z. A. Sh. në cilësinë ish Administrator i Njësisë Administrative Postribë, në Bashkinë Shkodër.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga Bashkia Shkodër është paraqitur observacioni me shkresën nr. 9219/6 prot., datë 09.09.2025 “Mbi Projekt Raportin e Auditimit” nga z. R. H., z. G. H., z. A. M., z. E. D., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit (Bashkia Shkodër): Bashkia Shkodër nuk është përgjegjëse për ndjekjen e procedurave për heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqes së zonës minerare nr. 2/6, për objektin “Rasek”, në Qarkun Shkodër. Në qëndrimin e saj zyrtar, Bashkia i referohet Ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010, “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshime, dhe Ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, duke argumentuar se procedurat për dhënie me qira dhe administrimin e fondit pyjor-kullor janë kompetencë e Ministrisë përgjegjëse për pyjet (Ministria e Turizmit dhe Mjedisit). Subjekti, zotërues i lejes minerare ka dërguar vetëm kërkesë në MIE për heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqes së licensuar, bazuar në VKM nr.1353/20228, pika5/a dhe nuk ka vijuar më tej procedurat. Gjithashtu, Bashkia ka informuar në mënyrë zyrtare institucionet përgjegjëse për rastin në fjalë dhe ka kërkuar respektimin e procedurave ligjore, por nuk ka ndërmarrë veprime administrative konkrete, duke vlerësuar se nuk ka përgjegjësi të drejtpërdrejtë për pasojat apo shkeljet e konstatuara në fondin pyjor. Si rrjedhojë, hedhim poshtë çdo përgjegjësi të plotë për dëmet apo devijimet ligjore të evidentuara në Projekt Raportin e Auditimit.

-Në vijim të Rekomandimit 5.1, Bashkia Shkodër shpreh gatishmërinë për të bashkëpunuar ngushtësisht me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, si dhe me Agjencinë Kombëtare të Pyjeve, me qëllim zbatimin e plotë dhe në përputhje me kuadrin ligjor të këtij rekomandimi. Bashkia

mbetet e angazhuar për të kontribuar në përmirësimin e administrimit të fondit pyjor dhe në respektimin e procedurave përkatëse, sipas përgjegjësi të saj institucionale.

-Në zbatim të Rekomandimit 6.1 të Projekt-Raportit të KLSH-së, Bashkia Shkodër ka ndërmarrë veprime konkrete, duke rishikuar procesverbalin nr. 33, datë 10.02.2022, lidhur me vënien në dispozicion të sipërfaqes prej 1.8 ha për subjektin “NGA G” sh.p.k.

Pas verifikimeve në terren nga grupi i punës dhe strukturat pyjore të bashkisë, janë kryer matjet përkatëse dhe është hartuar një akt konstatimi i detajuar, bashkëngjitur me raportin e dëmit të shkaktuar. Në vijim të këtij procesi, është hartuar shkresa nr. 17467 prot., datë 02.09.2025, përmes së cilës është shfuqizuar procesverbali nr.33, si masë korrigjuese për parregullsitë e konstatuara.

Gjithashtu, Bashkia sqaron se struktura e re “Administrimi dhe Inspektorati i Pyjeve” është në fazë organizimi, dhe aktualisht përbëhet vetëm nga një kryeinspektor dhe një inspektor, çka kufizon kapacitetin për kryerjen e inspektimeve të plota. Sipas nenit 38, pika 1 të Ligjit nr. 99/2024 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, një inspektim i plotë kërkon pjesëmarrjen e të paktën tre inspektorëve të autorizuar, gjë që aktualisht nuk është e mundur për shkak të mungesës së personelit.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me pretendimet e bashkisë se ka përmbushur detyrimet ligjore dhe ka ndjekur procedurat përkatëse, nga auditimi është konstatuar se nuk janë respektuar kërkesat e Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit nr.9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, si dhe Ligjit nr. 57/2020 “Për pyjet”. Konkretisht, bashkia nuk ka garantuar funksionimin, kontrollin dhe ekzekutimin e duhur të veprimtarive në fondin pyjor kombëtar, në përputhje me dokumentet planifikuese në fushën e pyjeve, standardet teknike dhe kuadrin ligjor në fuqi. Theksojmë detyrimet sipas Ligjit nr. 57/2020 “Për Pyjet”:

Neni 16, Strukturat vendore përgjegjëse për pyjet, pika 1 dhe 5. Pika 1. *Struktura përgjegjëse për qeverisjen e pyjeve në bashki është strukturë e specializuar në nivel vendor, me attribute menaxhuese, kontrolluese/inspektuese, teknike dhe këshillimore, që administron fondin pyjor kombëtar në pronësi, si dhe lëshon/pezullon/shfuqizon lejet për ushtrimin e aktivitetit për shfrytëzimin e fondit pyjor kombëtar për subjektet e interesuara.*

5. *Inspektorët e strukturave kontrolluese/inspektuese të pyjeve në bashki, bazuar në natyrën e veçantë të funksionit që realizojnë dhe përgjegjësinë e përbashkët për përmbushjen e tij, bashkëpunojnë me strukturat përgjegjëse për kontrollin dhe monitorimin pranë agjencisë shtetërore përgjegjëse për pyjet.*

Neni 40, Dispozita kalimtare, pika 1, 2, 3 dhe 4:

1. *Në funksion të ngritjes në rang kombëtar të një sistemi të integruar të planifikim-zhvillimit të fondit pyjor kombëtar, ngarkohet agjencia të kryejë analizën e dokumenteve ekzistuese, vlerësimin e dokumenteve të planifikimit, që janë të nevojshme për të gjithë fondin pyjor kombëtar, dhe përllogaritjen e kostove dhe afateve të nevojshme për hartimin e tyre.*

2. *Strukturat, organet dhe institucionet ekzistuese në sektorin e pyjeve vazhdojnë funksionimin e tyre deri në ngritjen/riorganizimin e strukturave, të organeve dhe institucioneve të reja, sipas përcaktimeve dhe afateve të këtij ligji.*

3. *Ngarkohen organet e bashkive që, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të përcaktojnë dhe të miratojnë ngritjen/riorganizimin e strukturave përgjegjëse për pyjet, ku përfshihen edhe ato kontrolluese, sipas përcaktimeve në këtë ligj dhe në aktet nënligjore në zbatim.*

4. *Agjencia, në bashkëpunim me Inspektoratin Qendror, unifikon praktikat për kontrollin dhe procesin e inspektimit në fondin pyjor kombëtar nga strukturat përgjegjëse në ushtrimin e kompetencave të tyre.*

Pavarësisht kërkesave të përsëritura të grupit të auditimit për vënien në dispozicion të dokumentacionit mbështetës dhe akteve procedurale, Bashkia nuk ka paraqitur prova për marrjen e masave konkrete për parandalimin, ndalimin apo ndëshkimin e subjekteve dhe individëve që kanë ushtruar aktivitet të paligjshëm në fondin pyjor, pa përmbushur kërkesat për heqjen e

sipërfaqes nga fondi pyjor, siç kërkohet për veprimtaritë minerare “tokë e zënë, objekt shfrytëzimi”.

Gjithashtu, nuk rezulton që Bashkia të ketë reaguuar në kohë ndaj ankesave dhe kërkesave të banorëve lidhur me shqetësimet për aktivitetin minerar në zonën përkatëse, duke mos garantuar të drejtën për informacion dhe pjesëmarrje të publikut, si dhe mosrespektuar detyrimet e saj ligjore për mbrojtjen e interesit publik.

2.2.Mbi auditimin e procedurës së dhënies së lejeve, licensave për aktivitetin minerar të shfrytëzimit me vendndodhje Rasek, Shkodër.

Mbi procedurat për pajisjen me Deklaratë Mjedisore dhe leje Mjedisi Tipi B të subjektit “B. C” sh.p.k

Pas shpalljes së Njoftim Fituesit nga MIE për zonën konkruuese 2.6 subjekti “B. C” sh.p.k ka filluar procedurat për pajisjen me Deklaratë Mjedisore dhe më pas me Leje Mjedisi Tipi B.

Në zbatim të Ligjit Nr.10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e Mjedisit”, Ligjit nr.10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe pas shqyrtimit të kërkesës për leje mjedisi, Agjencia Kombëtare e Mjedisit jep mendimin e argumentuar ministrisë përgjegjëse për miratimin e lejes së mjedisit.

Bazuar në Ligjin nr.10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e Mjedisit”, i përditësuar, Neni 4, pika 2. Autoritetet kompetente për lejet e mjedisit të tipave A dhe B janë si më poshtë:

a) Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) është autoriteti ku bëhet kërkesa dhe ku lëshohet leja e mjedisit të tipit A dhe B;

b) Ministri është autoriteti që firmos aktin e miratimit të lejeve të mjedisit të tipit A dhe B, pasi ato të shqyrtohen dhe përgatiten nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit;

c) Agjencia Kombëtare e Mjedisit është autoriteti që verifikon saktësinë e informacionit të dhënë nga operatori në kërkesën e tij për leje mjedisi të tipit A dhe B dhe që i jep mendimin e argumentuar ministrit për dhënien ose jo të kësaj lejeje, me kushte të detajuara, të shkruara, të cilat lëshohen nga QKB-ja.

Veprimet për pajisjen me leje mjedisi për subjektin “B. C.” sh.p.k dhe “NGA G” sh.p.k janë realizuar nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKL), në përputhje me Ligjin nr. 10081, datë 23.02.2009 "Për Licensat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe me VKM nr. 538, datë 26.02.2009 "Për Licensat dhe Lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet QKB-së dhe disa rregullime tjera nënligjore të përbashkëta", të ndryshuar.

Projekti që do të zhvillohet nga subjekti “B. C.” sh.p.k i nënshtrohet procedurës së Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, sipas kërkesave të nenit 9 të ligjit nr. 10 440, datë 7.7.2011, i përditësuar, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, Shtojca I, pika 19 “*Gurore dhe miniera sipërfaqësore, ku sipërfaqja e vendit është mbi 0,5 hektarë, ose vende për nxjerrjen e torfës, ku sipërfaqja e vendit është mbi 1 hektar*”;

Referuar Kreut II të VKM-së nr.686, datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësave e të afateve për zhvillimin e procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e Deklaratës Mjedisore”, i përditësuar - Zhvillimi i Procedurës së Thelluar të VNM-së, zhvilluesi nëpërmjet sistemit elektronik, njofton ministrinë që në fazat fillestare të zhvillimit të shoqëruar me informacionin e mëposhtëm:

1. Raportin teknik të projektit të propozuar;

2. Informacion për ndërveprimin me mjedisin të projektit;

Ministria nëpërmjet sistemit elektronik, brenda 10 ditë kalendarike nga marrja e aplikimit vlerëson dokumentacionin nëse është në përputhje me kërkesat e këtij vendimi dhe ia përcjell AKM-së të shoqëruar dhe me mendimin sugjerues të drejtorive teknike për çështjet që do të trajtohen në raportin e thelluar të VNM-së. AKM-ja:

a) I kërkon zhvilluesit, nëpërmjet sistemit elektronik, plotësimin e informacionit në rastet kur mungon, kur nuk është i plotë apo i qartë me arsyetimin përkatës, duke vënë në dijeni edhe Ministrinë.

b) Dërgon për mendim/konsultim aplikimin, institucioneve të mëposhtme, të cilat shprehën brenda 10 ditë kalendarike:

i) Ministrive të linjës, në varësi të projektit;

ii) Institucioneve të tjera, që në varësi të llojit të projektit, janë përgjegjëse për lejimin/autorizimin/liçencimin e tij, apo përgjegjëse për emergjencat natyrore dhe civile;

iii) Agjencisë Rajonale të Mjedisit (ARM), në qarkun ku propozohet të zbatohet projekti, së cilës i jepen edhe udhëzimet përkatëse për marrjen e mendimit nga njësitë e qeverisjes vendore.

ARM-ja, u dërgon, për t'u shprehur, një kopje të tij njësisë/ve së qeverisjes vendore (NJQV) që administron territorin ku propozohet projekti dhe asaj/atyre që preken nga projekti i propozuar, AKM-ja, pas marrjes së mendimeve nga institucionet njofton, me shkrim, zhvilluesin për çështje që duhet të trajtojë në raportin e thelluar të VNM-së, duke vënë në dijeni ministrinë. Zhvilluesi, pas marrjes së njoftimit nga AKM-ja, harton projekt raportin e thelluar të VNM-së dhe organizon dëgjueshën me publikun, sipas procedurave të legjislacionit në fuqi për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrje. Në përfundim të dëgjuesës zhvilluesi harton Raportin e Thelluar të VNM-së, sipas kritereve të Shtojcës II, të këtij vendimi.

I. Auditimi i dokumentacionit shoqërues për procedurën e VNM-së së Thelluar evidentoi përmbajtjen e mëposhtme:

- Kërkesën e subjektit me nr. 2211 prot., datë 15.03.2017 drejtuar AKM-së në lidhje me njoftimin e fillimit të procedurës për VNM e Thelluar. Kjo kërkesë përfaqëson hapin fillestar në procesin administrativ për vlerësimin e ndikimit në mjedis, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

- Me shkresën nr. 726 prot., datë 29.03.2017, Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM), z. J. B., ka njoftuar subjektin zhvillues "B. C." sh.p.k për domosdoshmërinë e përgatitjes së Raportit të Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM), duke përcaktuar kërkesat përkatëse lidhur me përmbajtjen dhe afatet e këtij dokumenti:

- Marrjen në konsideratë të Mendimit të Drejtorisë Teknike të Ministrisë së Mjedisit që rekomandon: Zbatimin e legjislacionit minerar dhe të menaxhimit të mbetjeve, etj;

- Hartimin e raportit të VNM-së sipas strukturës dhe renditjes në Shtojcën II të VKM-së nr.686, datë 29.07.2015;

- Kryerjen e Konsultimit me Publikun sipas VKM nr. 247, datë 30.04.2014, duke njoftuar më parë AKM;

- Të detajohet: planimetria për instalimet përbërëse; plani i rehabilitimit gjatë kryerjes së aktivitetit, masat për menaxhimin e mbetjeve të ambalazheve dhe inerteve;

- Përfshirjen në raport të të gjitha lejeve dhe licencave të nevojshme për aktivitetin, etj.

• Me shkresën nr. 36 prot., datë 11.04.2017, *ARM Shkodër* (drejtor K. K.), drejtuar Agjencisë AKM-së ka dhënë mendim pozitiv për fillimin e procedurave të Vlerësimit të Thelluar të Ndikimit në Mjedis (VNM). Në këtë shkresë vlerësohet se informacioni i paraqitur nga subjekti është i qartë dhe i konsiderueshëm. Gjithashtu, në vlerësimin mjedisor theksohet se zona në fjalë është e papjellëzuar, përveç disa shkurreve të ulëta dhe kullotave të parëndësishme, me shpat kryesisht të zhveshur dhe me bimësi të kufizuar.

Në vijim, ARM Shkodër ka rekomanduar që në Raportin e Thelluar të VNM-së të përfshihen elementë të rëndësishëm si: plani i detajuar i lidhjes së burimit me rrjetin ujëmbledhës, masat për parandalimin e erozionit, rehabilitimi me lloje vendase fidanësh, si dhe marrja e miratimit nga organet e pushtetit vendor për menaxhimin e mbetjeve inerte dhe aspekte të tjera teknike mjedisore.

Gjatë auditimit të dokumentacionit të procedurës për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM) të thelluar u evidentua se, AKM nuk ka dërguar për mendim/konsultim institucioneve të tjera, të cilat sipas Ligjit nr. 10440, datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", neni 17, pika 5, si dhe në VKM nr. 247, datë 30.04.2014, duhet të përfshihen në proces, në varësi të llojit të aktivitetit (Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, Ministrisë së Kulturës dhe institucionet e saj të varësisë, etj), të cilat sipas legjislacionit në fuqi duhet të përfshihen në proces, në varësi të llojit të aktivitetit, në mosrespektim të pikës 6 të VKM-së nr.686, datë 29.07.2015. Sipas shkresës nr. 1012/1 prot., datë 26.02.2019, Drejtorja e Përgjithshme e

Politikave dhe Programeve të Zhvillimit të Kulturës (bazuar në ankesën e banorëve datë 25.01.2019) i dërgon AKBN-së informacionin mbi objektin në fjalë ku: *“Pas inspektimeve nga Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Shkodër, u konstatua se nuk ishte marrë leja përkatëse nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë, sipas ligjit nr. 27/2018. Zona ka potencial të lartë arkeologjik dhe është përfshirë në projektin kërkimor shkencor "Vëzhgime për njohje në zonën kodrinore të Shqipërisë, veriperëndimore". Për pasojë, duhet të ndërpriten punimet dhe të ndiqen procedurat përkatëse pranë Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik. Ligji 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” Neni 38 b) Këshilli i Trashëgimisë Kulturore Materiale, i përbërë nga 15 anëtarë, vepron si organ vendimmarrës në lidhje me kërkesat për ndërhyrje mbi pasuritë kulturore të luajtshme e të paluajtshme; pasuritë arkeologjike dhe çdo kërkesë të lidhur të fushës, sipas parashikimeve të këtij ligji.*

Mosrespektimi i këtij detyrimi përbën shkelje procedurale që cënon transparencën dhe gjithëpërfshirjen në procesin e vlerësimit të ndikimit mjedisor.

- Zhvilluesi që i nënshtrohet procedurës së VNM-së së thelluar ka detyrimin të informojë dhe të konsultohet me publikun e interesuar lidhur me ndikimet mjedisore të aktivitetit të propozuar, duke paraqitur këtë proces si pjesë të dokumentacionit të nevojshëm për aplikimin për deklaratë mjedisore pranë ministrisë përkatëse. Seancat dëgjimore dhe pjesëmarrja e publikut janë të detyrueshme dhe të përcaktuara qartë në Ligjin nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, Ligjin nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, neni 17, pika 5, si dhe në VKM nr. 247, datë 30.04.2014, i cili përshkruan rregullat dhe fazat e përfshirjes së publikut gjatë procedurës së thelluar të VNM-së, të cilat janë:

a) Informimin e publikut për projektin e propozuar dhe marrjen e mendimit të tij në fazën e përcaktimit të çështjeve që do të trajtohen në raportin e thelluar të VNM-së, shoqëruar me sqarimet për procedurën në zbatim;

b) Informimin e publikut për komunikimin që AKM-ja bën me zhvilluesin për çështjet që duhet të trajtohen në raportin e thelluar të VNM;

c) Informimin, ndërgjegjësimin dhe konsultimin e publikut nga ana e zhvilluesit gjatë hartimit të raportit të thelluar të VNM-së;

ç) Informimin dhe përfshirjen e publikut për organizimin dhe realizimin e dëgjësës publike;

d) Informimin e publikut dhe marrjen e mendimit të tij nga AKM-ja në fazën e shqyrtimit dhe miratimit të Deklaratës Mjedisore;

dh) Informimin e publikut gjatë monitorimit të ndikimeve në mjedis të projektit.

Bazuar në kriteret e përcaktuara më lart, u verifikua dhe shqyrtua dokumentacioni i dorëzuar nga AKM dhe ARM Shkodër lidhur me informimin, konsultimin dhe seancën dëgjimore të organizuar nga shoqëria "B. C." sh.p.k. më 14.04.2017, për aktivitetin e karrierës së gurit gëlqerorë në Rasek, Bashkia Shkodër, ku u sigurua formulari i konsultimit me publikun që dokumenton pjesëmarrjen dhe komentet gjatë procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, nga i cili rezultoi se:

- Nuk ka asnjë gjurmë dokumentimi lidhur me mënyrën se si është realizuar procesi i informimit dhe konsultimit me publikun gjatë hartimit të raportit të thelluar të VNM-së. Megjithëse në formular rezulton se kanë marrë pjesë 12 persona, mungon çdo provë se ky proces është kryer sipas procedurave ligjore, përfshirë njoftimet zyrtare, publikimet, dokumentimin e thirrjes së publikut dhe përfaqësuesve të interesit, si dhe mënyrën e organizimit të takimit.

- Formulari i konsultimit me publikun në procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis, nuk përcakton datën, vendin dhe orën e takimit.

- Sipas këtij formulari rezulton të kenë marrë pjesë 12 persona, nga të cilët 7 banorë ku një prej tyre ka nënshkruar si banor i fshatit Rasek (emër-ID), ndërsa përfaqësues të ARM-së (2), NJA Postribë (1), të shoqërisë (1) dhe një inxhinjer pa cilësi përfaqësimi.

- Nuk rezulton të kenë marrë pjesë përfaqësues të OJF-ve, të shoqërisë civile, bizneseve përreth zonës, përfaqësues të mediave vizive dhe të shkruara lokale apo përfaqësues të grupeve të interesit informale etj, siç parashikohet në këtë formular si dhe në mosrespektim të Vendimit

nr.247, datë 30.04.2014 Kreu II, pika 7.2. gërma “ç” “Ditën e zhvillimit të seancës dëgjimore janë të pranishëm: ç) përfaqësues dhe palë të tjera të interesuara”.

- Procesverbali mbi realizimin e konsultimit me publikun shpreh se, u prezantua projekti, ndikimet e mundshme negative/pozitive në mjedis dhe në përfundim të diskutimeve nga të pranishmët u dha miratimi për zhvillimin e projektit, duke u quajtur me rëndësi punësimi për banorët e zonës, por nuk pasqyrohen diskutimet, pretendimet e pjesëmarrësve, mendimet, problematikat etj, në mosrespektim me Vendimin Nr.247, datë 30.04.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave gërma “e”: *të procedurave për Informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore) Publikon në faqen e saj të internetit informacionin që disponon për pjesëmarrjen e publikut gjatë procesit të VNM-së për projektin.*

- Nuk rezulton të ketë marrë pjesë hartuesi i raportit të VNM-së së Thelluar (i cili është eksperti Arjan Bala), në mosrespektim me pikën 7.2. të Vendimit Nr.247, datë 30.04.2014 “Ditën e zhvillimit të seancës dëgjimore janë të pranishëm: a) zhvilluesi i projektit me ekspertin/ekspertët që kanë hartuar raportin e thelluar të VNM-së”.

- Nuk është paraqitur asnjë dokument tjetër në formë shkresore apo elektronike që të vërtetojë dokumentimin e organizimit dhe zhvillimit të aktivitetit (njoftime, shpallje, publikime, përmbledhje jo teknike e hartimit të thelluar të VNM mbajtje e dokumentimin e dëgjësës me publikun nga zhvilluesi, AKM, ARM Shkodër, në mosrespektim me pikën 6 të Vendimit Nr.247, datë 30.04.2014.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mbajtjes së dëgjësës me publikun, rezultoi se, ARM Shkodër nuk ka të dokumentuar komunikimin me NJVA Postribë.

- Raporti i Thelluar i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM), i hartuar nga Studio Mjedisore “Studime Projektme Minerare”, është përgatitur dhe miratuar vetëm nga një ekspert, z. A. B., pa përfshirjen dhe nënshkrimin e administratorit dhe specialistëve të tjerë, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 10440, datë 07.07.2014 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, Kreu VII, Ekspertët e VNM-së, Neni 24, pika 3, i cili citon: “Raporti i VNM-së nënshkruhet nga personi fizik/juridik dhe specialistët e përfshirë në hartimin e raportit të VNM-së”.

- Nga verifikimi i ekstraktit historik në QKB, rezulton se administrator i Studios Mjedisore “Studime Projektme Minerare” për periudhën 25.03.2016 deri 25.03.2021, periudhë gjatë së cilës është hartuar Raporti i Thelluar i VNM (maj 2017), ka qenë z. H. B. Kështu, z. A. B. nuk rezulton si Administrator i studios mjedisore.

- Në Raportin e Thelluar të VNM-së janë përfshirë vetëm lejet mjedisore të Ministrisë së Mjedisit dhe lejet minerare të MIE-së, pa një pasqyrim të plotë të lejeve dhe licencave të subjektit, ashtu siç është kërkuar nga AKM në shkresën nr. 726 prot., datë 29.03.2017, ku në pikën 2/k kërkohet përfshirja në raport e të gjitha lejeve dhe licencave të marra për këtë aktivitet.

- Agjencia Rajonale e Mjedisit Shkodër jep mendim pozitiv Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për zhvillimin e aktivitetit, por nuk ka marrë në konsideratë mendimin e dhënë nga Bashkia Shkodër, gjatë procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM të Thelluar). Sipas së cilës: “Në dosjen e aplikimit të subjektit “B. C.” sh.p.k nuk janë paraqitur ndikimet negative në mjedis; nuk janë parashikuar konkretisht masat dhe veprimet përshkallëzuese sipas ndikimit të mundshëm; dëgjesa nuk ka qenë gjithëpërfshirëse; sipas njoftimeve në rrugë operative, banorët nuk janë informuar dhe nuk janë dakord për zhvillimin e aktivitetit”, konkretisht shkresa:

- Me shkresën nr. 6494 prot., datë 04.05.2017, Bashkia Shkodër i është përgjigjur kërkesës së ARM Shkodër duke shprehur opinion mbi raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis për aktivitetin e shfrytëzimit të gëlqerorit të mermerizuar në Rasek, Mes, Shkodër. Në këtë opinion janë evidentuar disa mangësi të rëndësishme, duke theksuar se masat e parashikuara janë në nivel teorik dhe ndikojnë në shëndetin e banorëve. Këto konstatime përfshijnë:

1. Nuk janë paraqitur ndikimet negative në mjedis dhe tek banorët e zonës.
2. Nuk janë paraqitur ndikimet negative në emetimin e pluhurave dhe të zhurmave.
3. Nuk janë paraqitur konkretisht masat dhe veprimet përshkallëzuese sipas ndikimit të mundshëm.
4. Nuk është paraqitur distanca e banesave më të afërta nga sheshi i shfrytëzimit.

Konkluzion: a) Mungesa e konsultimit nga ana e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM) me institucionet përgjegjëse, përfshirë Ministrinë e Kulturës dhe strukturat e saj vartëse, përbën një mosrespektim të detyrimeve ligjore të përcaktuara në VKM nr. 686, datë 29.07.2015, Kreu II. Kjo situatë përbën një shkelje procedurale që çënon integritetin, transparencën dhe gjithëpërfshirjen e procesit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM), duke rrezikuar marrjen e vendimeve të paplota ose të bazuara në vlerësime të pamjaftueshme institucionale.

b) Procesi i hartimit dhe miratimit të Raportit të Thelluar të VNM-së për aktivitetin e shoqërisë “B. C.” sh.p.k. ka evidentuar mangësi të konsiderueshme procedurale dhe ligjore, përfshirë mungesën e transparencës, mosdokumentimin e konsultimeve publike dhe përjashtimin e palëve të interesuara nga seancat dëgjimore. Nuk është siguruar pjesëmarrja e ekspertëve hartues, ndërsa njoftimet dhe komunikimet institucionale nuk janë dokumentuar në mënyrë të plotë. Për më tepër, raporti i VNM-së është nënshkruar vetëm nga një individ, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, neni 17, pika 5, dhe VKM nr. 247, datë 30.04.2014, Kapitulli II.

Raporti i Thelluar i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis përbën dokumentin bazë në procesin e vendimmarrjes dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm pa u shoqëruar me një proces të rregullt konsultimi publik. Ky konsultim është i detyrueshëm dhe përfshin marrjen në shqyrtim të komenteve e rekomandimeve nga publiku dhe organizatat mjedisore, të cilat janë thelbësore për marrjen e vendimit përfundimtar nga autoritetet kompetente. Mosrespektimi i këtij procesi përbën shkelje të procedurës ligjore:

Kreu II, neni 7, Procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis, pika 3 e Ligjit nr.10440, datë 7.7.2014, ndryshuar ku citohet: “Dokumenti bazë ku mbështetet procesi i VNM-së, është raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis, i cili, në varësi të ndikimeve të mundshme të projektit, mund të jetë: b) raporti i thelluar i VNM-së për projektet e shtojcës I”.

II. Në përfundim të procedurës së thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, ministri lëshon deklaratën mjedisore, mbi bazën e së cilës miraton ose refuzon lejen për zhvillimin e projektit. Deklarata përmban kushtet që zhvilluesi duhet të përmbushë me qëllim parandalimin, minimizimin dhe menaxhimin e ndikimeve mjedisore të aktivitetit të propozuar.

Ministria, e mbështetur në mendimet sugjeruese të drejtorive teknike përkatëse, përcjell në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit qëndrimin e saj lidhur me sugjerimin që i jepet autoritetit planifikues, në përputhje me nenin 12 të Ligjit nr. 10440, datë 07.07.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”. Në këtë kuadër, deklarata mjedisore që lëshohet në përfundim të procedurës së VNM-së së thelluar përmban:

Afatet dhe përgjegjësitë për zbatimin e masave mjedisore.

- a) qëndrimin e ministrisë dhe, sipas rastit, kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi;
- b) konfirmimin se ministria ka marrë në shqyrtim mendimet e shprehura nga publiku dhe institucionet përkatëse, si dhe shkallën e reflektimit të tyre;
- c) informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun;
- ç) arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi;
- d) përshkrimin, sipas rastit, të masave kryesore që duhen marrë për të shmangur, reduktuar e, nëse është e mundur, për të korrigjuar efektet të rëndësishme.

Sipas VKM-së nr. 686, datë 29.07.2015 Kreu II, pika 10 zhvilluesi për t’u pajisur me **Deklaratën mjedisore** aplikon pranë ministrisë nëpërmjet sistemit elektronik dhe plotëson dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Raportin e thelluar të VNM-së;
- b) Përmbledhjen joteknike të raportit të thelluar të VNM-së;
- c) Raportin teknik përfundimtar, të hartuar sipas kërkesave të pikës 1.1, të këtij kreu;
- ç) Përmbledhje të konsultimeve me publikun dhe palët e tjera të interesuara, realizuar gjatë hartimit të raportit të thelluar të VNM-së;
- d) Një kopje të faturës të pagesës së tarifës së shërbimit, sipas përcaktimeve në legjislacionin përkatës.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur për hartimin dhe miratimin e Deklaratës Mjedisore nr.3810, datë 29.05.2017, miratuar me Vendim nr. 19 nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për aktivitetin e subjektit “B. C.” sh.p.k., u evidentuan mangësi në përputhshmërinë me kërkesat e përcaktuara në VKM nr.686, datë 29.07.2015 dhe Ligjin nr. 10 440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, si më poshtë:

○ Në hartimin e Deklaratës Mjedisore me nr. 3810 prot, datë 29.05.2017, miratuar me Vendim nr. 19 nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për subjektin “B. C.” sh.p.k, është marrë mendimi i Drejtorisë Teknike të MTM-së, i cili përcakton disa kushte që subjekti kërkues duhet të përmbushë, si dhe mendimi i ARM-së Shkodër, që shpreh dakortësi, duke mbajtur parasysh sugjerimet e Ministrisë së Mjedisit.

○ Drejtoria Teknike e MTM-së ka përcaktuar një sërë kushtesh që zhvilluesi duhet të plotësojë, përfshirë: zbatimin e nenit 38 të Ligjit nr. 10304, datë 15.07.2000 “ Për sektorin minerar në RSH”, mbi vendin dhe mënyrën e depozitimit të e mbetjeve; masat për menaxhimin e mbetjeve minerare, menaxhimin të pyjeve dhe mbrojtjen e biodiversitetit; parandalimin e ndotjes së ajrit, ujërave dhe trajtimin e mbetjeve, etj.

○ ARM Shkodër ka dhënë dakordësi për projektin, duke marrë parasysh sugjerimet e Ministrisë së Mjedisit dhe ka kërkuar respektimin e detyrimeve ligjore për menaxhimin e mbetjeve inerte, sipas legjislacionit në fuqi;

○ Deklarata Mjedisore, në lidhje me konsultimin me publikun përmend pjesëmarrjen e përfaqësuesve të pushtetit vendor, komunitetit të zonës, Agjencisë Rajonale të Mjedisit dhe studios mjedisore. Gjithashtu shpreh se: është prezantuar projekti dhe janë dëgjuar sugjerimet e pjesëmarrësve, të cilat do të merren parasysh nga zhvilluesi gjatë fazës së shfrytëzimit dhe se nuk është evidentuar shqetësim apo kundërshtim i drejtpërdrejtë nga komuniteti.

• Nuk është paraqitur Raporti Teknik, sipas përcaktimit në pikën 10/c të Kreut II të VKM-së nr. 686/2015, dokument i detyrueshëm për të vlerësuar ndikimin e projektit dhe për të mbështetur miratimin e Deklaratës Mjedisore.

• Mungon përmbledhja e konsultimeve me publikun dhe palët e tjera të interesuara, ashtu si kërkohet gjatë hartimit të Raportit të Thelluar të VNM-së, i cili është një nga kushtet për të marrë Deklaratën Mjedisore, sipas pikës 10/ç Kreu II të VKM nr. 686, datë 29.07.2015. sipas pikës 10/ç të të njëjtit vendim. Edhe pse është deklaruar se është zhvilluar një takim me pjesëmarrjen e komunitetit dhe përfaqësuesve vendorë, nuk është dokumentuar procesi në formën dhe përmbajtjen e kërkuar ligjërisht.

• Deklarata Mjedisore nuk përmban informacion të mjaftueshëm mbi masat për trajtimin e ndikimeve në komponentët mjedisorë, si biodiversiteti, ajri, uji dhe mbetjet, duke e bërë të pamundur vlerësimin e saktë të kapacitetit mjedisor të projektit.

• ARM Shkodër ka dhënë dakordësi të kushtëzuar, duke kërkuar zbatimin e kërkesave të MTM-së dhe legjislacionit për mbrojtjen e mjedisit, ndërkohë që nuk ka të dhëna që verifikojnë nëse këto kushte janë ndjekur apo monitoruar gjatë zbatimit të projektit.

• MTM nuk ka dokumentuar kërkesë zyrtare për plotësimin e dokumentacionit si harta dixhitale ne CD dhe dhënia e mendimit paraprak nga kryetari i Bashkisë ku do zhvillohet aktiviteti minerar, siç përcaktohet në pikën 11/a të VKM nr. 686, datë 29.07.2015 Kreu II, sipas së cilës, nëse aplikimi nuk përmbush kërkesat, duhet të kthehet për plotësim brenda afatit 10-ditor.

Konkluzion: Procesi i miratimit të Deklaratës Mjedisore për subjektin “B. C.” sh.p.k. nuk është zhvilluar në përputhje të plotë me kërkesat e pikës 10/c/ç, 11/a, 12 të Kreut II të VKM nr. 686, datë 29.07.2015 neni 12/b të Ligjit nr. 10 440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, për shkak të mungesës së dokumenteve të detyrueshme (Raport Teknik, përmbledhje e konsultimeve me publikun) dhe të mospërmbushjes së detyrimeve procedurale nga MTM. Pavarësisht kushteve të vendosura nga MTM dhe ARM Shkodër, mungon evidenca për monitorimin e zbatimit të tyre, duke rritur rrezikun për ndikime mjedisore të konsiderueshme gjatë aktivitetit.

Mbi shqyrtimin e kërkesës për pajisje me leje mjedisi:

Shqyrtimi dhe vlerësimi i kërkesave për pajisje me leje mjedisi kryhet në përputhje me Vendimin nr. 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja”- Kreu III - Procedurat për shqyrtimin e kërkesave dhe përcaktimi i kushteve për leje mjedisi të tipit B.

1. Kërkuesi që aplikon pranë QKL-së për pajisjen me leje mjedisi të tipit B duhet të dorëzojë këto dokumente:

- a) Formularin informues për pajisje me leje mjedisi të tipit B, sipas shtojcës 2, bashkëlidhur këtij vendimi;
- b) Mandatpagesën për tarifën përkatëse për lejen e mjedisit të tipit B, sipas nenit 25 të ligjit nr.10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”;
- c) Çdo informacion tjetër që kërkuesi i lejes kërkon të merret parasysh gjatë shqyrtimit të aplikimit;
- ç) Kopjen e vendimit të AKM-së për VNM-në paraprake ose kopje të deklaratës së ministrit për VNM-në e thelluar, të shoqëruar me raportin paraprak ose të thelluar të VNM-së, në rastet kur për instalimin është kryer procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis, sipas përcaktimit në ligjin nr.10440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”².
- d) Raportin mbi sigurinë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e rreziqeve nga aksidentet madhore, kur kërkohet.
- dh) Relacionin rreth dëgjësës me publikun, sipas përcaktimit në pikën 13 të kreut VI të këtij vendimi³.

2. AKM dërgon një kopje të aplikimit në institucionet e mëposhtme, të cilët brenda 10 (dhjetë) ditëve pune japin mendimin e tyre, me shkrim dhe në formë elektronike:

- a) Drejtorinë teknike në Ministrinë e Mjedisit, sipas specifikave të instalimit;
- b) Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave (ISHMPU)⁴;
- c) Agjencinë Rajonale të Mjedisit (ARM).

2. AKM-ja kur vlerëson se dokumentacioni është i plotë, sipas pikës 1, të këtij kreu, brenda 5 (pesë) ditëve pune, ia përcjell atë institucioneve të mëposhtme, të cilat japin mendimin e tyre brenda 5 (pesë) ditëve pune:

- a) Drejtorive teknike në ministrinë përgjegjëse për mjedisin, sipas specifikave të instalimit;
- b) Agjencisë Rajonale të Mjedisit (ARM);
- c) Ministrive të linjës dhe strukturave të varësisë, sipas fushës së veprimtarisë që lidhen me specifikat e instalimit;
- ç) Njësisive të vetëqeverisjes vendore, sipas juridiksionit territorial ku ndodhet instalimi.

3. Nëse institucionet e përcaktuara në pikën 5, të këtij kreu, nuk shprehen brenda afatit, AKM-ja vijon me procedurën e shqyrtimit të kërkesës për leje të mjedisit të tipit B.

AKM-ja brenda 10 ditëve pune, pas verifikimit të dokumentacionit dhe mbledhjes së mendimeve nga publiku dhe institucionet, harton aktin e miratimit ose refuzimit, të shoqëruar me argumente, dhe ia dërgon ministrit, i cili brenda 5 ditëve pune firmos vendimin për miratim/refuzim të lejes, ose e kthen atë në AKM për shtesa/ndryshime me arsytet përkatëse. AKM-ja, më pas, brenda afateve të përcaktuara, publikon vendimin në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve.

✚ **Subjekti “B. C.” sh.p.k** me Nipt JB, Akt Miratimi Leje Mjedisit Tipi B (**LC-1014**) Nr. 4145 prot., datë 22.05.2017, Nr. Identifikimi i Lejes 2618, me administrator P. B., me **ID 3.7** në zonën minerare nr.2/6, vendburimi “Rasek”, objekt: “Nxjerrja e mineraleve, rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret”, me sipërfaqen 0.785 km².

² Shfuqizuar me Vendim Nr. 97, datë 14.2.2018 Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 419, datë 25.6.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave a, b dhe c, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja”

³ Shfuqizuar me Vendim Nr. 97, datë 14.2.2018

⁴ Shfuqizuar me Vendim Nr. 97, datë 14.2.2018

Nga shqyrtimi i dokumentacionit për pajisjen me leje mjedisi, përfshirë procesverbalin e Komisionit nr.12_mbi miratimin e lejes, rezultoi se:

Memo Nr. 1256 prot., datë 22.05.2017, nga Drejtori i Përgjithshëm i AKM-së, z. J. B., drejtuar Ministrin të Mjedisit, ku njoftohet se: Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka shqyrtuar dhe verifikuar saktësinë e dokumentacionit të dorëzuar nga operatori për kërkesën e tij për pajisje me Leje Mjedisi të Tipit B.

Procesverbal nr. 12 me Nr.1256/2 prot, datë 22.05.2017 i mbajtur nga Komisioni i Shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisi të tipit A dhe B.

Komisioni nr. 12, datë 22.05.2017, ka shqyrtuar aplikimin për leje mjedisore të disa subjekteve, përfshirë edhe subjektin “B. C.” sh.p.k., me këto të dhëna: Administrator: P. B., Vendndodhja: Mes, Postribë, Shkodër; Aktiviteti: Nxjerrja e mineraleve, rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret.

Përbërja e komisionit: L. T. (Drejtore i Drejtorisë së Vlerësimit në Mjedis), B. T. (Përgjegjëse e Sektorit të Lejeve Mjedisore), E. M. (Përgjegjëse e Sektorit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis), B. K. (Përgjegjëse e Sektorit të Përgjegjësisë Mjedisore - në mungesë specialist), E. M. (Juriste), O. N. (Specialiste e Sektorit të Lejeve Mjedisore - protokoll), K. S. (Specialist i Sektorit të Lejeve Mjedisore - prezantim).

Z. K. S. konfirmoi për Drejtorin e Përgjithshëm të AKM-së, z. J. B., se janë dorëzuar: Deklarata Mjedisore Nr. 3810 Prot., datë 09.05.2017, Nr. identifikimi 316, Vendim nr.19, për projektin “Shfrytëzim i gurit gëlqëror të mermerizuar” në sipërfaqe 0.785 km²; Pagesa prej 30,000 lekë, datë 09.05.2017; Raporti mbi sigurinë. Në përfundim nga z. J. B. shprehu: “Të miratohet dhe të vendosen normat e shkarkimeve”.

Nga auditimi i dokumentacionit përkatës për Aktin e Miratimit të Lejes mjedisore, të subjektit “B. C.” sh.p.k, rezultoi se:

- Nuk janë dokumentuar marrja e mendimit nga Inspektoriati Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave (ISHMPU), në kundërshtim me pikën 13, Kreu VI pika të Vendimit Nr. 419, datë 25.6.2014.

- Ndërsa ARM Shkodër me shkresë nr. 111 prot., datë 24.05.2017 jep mendim pozitiv për dokumentacionin, duke theksuar se është në përputhje me VKM nr. 419, datë 25.06.2014, por ngre disa çështje për t’u pasur parasysh:

- Mungesë e deklaramit të pronësisë së impiantit;
- Mungesë e detajeve për sasinë e ujit që do të merret nga përroi dhe ujësjellësi;
- Menaxhimi i mbetjeve inerte për shkak të terrenit të pjerrët;
- Reduktimi i ndotjes së ajrit;
- Mungesë e detajeve për trajtimin e ujërave të ndotur;
- Kontrolli i ndikimeve negative në tokat për mbjellje (bujqësi) bujqësore pranë tij;
- Rehabilitimi i zonës me fidanë dhe pemë të përshtatshme të zonës.

- Nuk është dokumentuar dhe paraqitur statusi juridik i pronësisë së subjektit “B. C” sh.p.k, i cili është i domosdoshëm për të garantuar ligjshmërinë e aktivitetit dhe shmangien e konflikteve të pronësisë.

- Nuk është dokumentuar procesi i informimit dhe pjesëmarrja e publikut për aplikimin për Leje Mjedisi Tipi B, në kundërshtim me pikën 13 të kreut VI të Vendimit nr.419 datë 25.06.2014.

- Nuk janë respektuar disa detyrime ligjore thelbësore, duke përfshirë publikimin e njoftimit për 20 ditë nga NJQV-ja, sigurimin e aksesit të lirë të publikut ndaj njoftimit, mundësinë për paraqitjen e komenteve brenda afatit, organizimin e dëgjësës publike brenda 25 ditëve, shpalljen në media dhe tabela zyrtare, përfshirjen e informacionit të detajuar në njoftim, si dhe përgatitjen dhe shpërndarjen e procesverbalit dhe dorëzimin e relacionit të dëgjësës në QKL nga kërkuksi. Këto veprime janë në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në Kreun VI, pikat 6-16 të VKM nr. 419, datë 25.06.2014, sipas të cilit “*Publiku ka të drejtë të konsultojë në mjediset e NJQV/AKM/ARM dhe të kërkojë një kopje të njoftimit...*”

- Mungon mendimi i Drejtorisë Teknike në Ministrinë e Mjedisit, në kundërshtim me Vendimin Nr. 419, datë 25.06.2014, Kreu VI, pika 2/a, e cila përcakton se “AKM-ja, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e marrjes së aplikimit për leje mjedisi të tipit B nga QKL-ja, dërgon një kopje të aplikimit në institucionet e mëposhtme, të cilët japin mendimin e tyre, me shkrim dhe në formë elektronike, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune: a) Drejtoritë teknike në Ministrinë e Mjedisit, sipas specifikave të instalimit..

Konkluzion: Procesi i pajisjes me Leje Mjedisit Tipi B për subjektin “B. C.” sh.p.k. është kryer me mangësi të rëndësishme procedurale, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në VKM nr. 419, datë 25.06.2014. Konkretisht, mungon dokumentacioni mbi statusin juridik të pronës ku do të zhvillohet aktiviteti, nuk janë përmbushur detyrimet ligjore për konsultimin dhe përfshirjen e publikut, si dhe nuk është siguruar mendimi i Drejtorisë Teknike pranë Ministrisë së Mjedisit dhe i Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave. Ndërkohë, mendimi i dhënë nga Agjencia Rajonale e Mjedisit Shkodër është pozitiv, por i kushtëzuar me rekomandime për të cilat nuk dokumentohet ndjekja apo zbatimi përkatës. Këto mangësi nuk garantojnë një proces të drejtë dhe transparent për miratimin e lejes mjedisore.

Mbi procedurat për pajisjen me Deklaratë Mjedisore dhe leje Mjedisit Tipi B të subjektit “NGA G” sh.p.k,

Nga auditimi i dokumentacionit përkatës për Aktin e Miratimit të Lejes mjedisore, të subjektit “NGA G” sh.p.k, rezultoi se:

Subjekti “NGA G” sh.p.k me Nipt LP, me “Akt-Miratimi leje Mjedisit Tipi B (LC-1746) me nr. 2949 prot., datë 18.03.2022, Nr. Identifikimi i lejes 3973, K.Nr.25, personi përgjegjës: A. Sh/, **ID 3.11**, në zonën minerare 2/6, me objekt: “Prodhim dhe fraksionimi i produkteve minerale jometalike”, Vendburimi: “Rasek”, Shkodër.

Grupi i auditimit kërkoi dokumentacionin për pajisjen me leje mjedisi, përfshirë procesverbalin e Komisionit nr.25 mbi miratimin e lejes, ku rezultoi se:

Procesverbal nr. 25 me nr. 2223/2 prot., datë 18.03.2022, është përgatitur nga Komisioni i shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisi Tipi A dhe B. Ky komision përbëhet nga B. T., përgjegjëse e Drejtorisë së Lejeve Mjedisore; E. M., përgjegjëse e Sektorit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis; L. Gj., përgjegjëse e Sektorit të Monitorimit; J. M., përgjegjëse e Sektorit Juridik dhe Marrëdhënieve Ligjore; dhe M. Gj., Specialist i Sektorit të Lejeve Mjedisore (protokoll).

Komisioni nr. 25, me Nr. 2223/1 prot., datë 18.03.2022, ka shqyrtuar aplikimet e disa subjekteve, përfshirë edhe “NGA G” sh.p.k. (LC-1746). Data e aplikimit ishte 07.03.2022, me afat për shqyrtim deri më 20.04.2022. Subjekti ka NIPT LP dhe administrator A. Sh.. Aktiviteti i tij është “Prodhim dhe fraksionimi i produkteve minerale jometalike”, me vendndodhje në Postrisë, Shkodër, në vendburimin “Rasek”.

✓ Sipas procesverbalit, znj. B. T. i konfirmon Drejtores së Përgjithshme të AKM-së, znj. A. D., se dokumentacioni i dorëzuar përfshin pagesën prej 30,000 lekë datë 25.02.2022, konsultimin me publikun më 22.02.2022, shkresën e fituesit në MIE, Përmbledhjen joteknike, planimetrinë dhe planvendosjen, dhe nuk rezultojnë mangësi në dokumentacion. Në përfundim, znj. A. D. jep rekomandimin për miratimin e lejes.

- Në Formularin Tip të Dëgjësës me publikun, datë 27.02.2022, mungojnë përfaqësues të OJF-ve, shoqërisë civile, bizneseve pranë zonës, si dhe përfaqësues të mediave lokale vizive dhe të shkruara.

- Në Formularin Tip të Dëgjësës së nënshkruar nga banorët nuk është specifikuar se nga cili fshat apo zonë janë pjesëmarrësit.

- Nuk disponohet procesverbal i plotë mbi zhvillimin e konsultimit me publikun që të pasqyrojë prezentimin e projektit, ndikimet mjedisore dhe shëndetësore, diskutimet, pretendimet dhe problematikat e ngritura nga pjesëmarrësit.

- Nuk është paraqitur asnjë dokumentacion shkresor ose elektronik që të vërtetojë organizimin dhe zhvillimin e dëgjësës, përfshirë njoftimet, shpalljet, publikimet dhe dokumentimin e

aktivitetit nga ana e zhvilluesit, AKM-së dhe ARM Shkodër, duke mos respektuar Vendimin Nr. 686, datë 30.04.2014, pika 7.5 dhe dispozitat për përgjegjësitë e AKM-së dhe ARM-së lidhur me mbajtjen e shënimeve, raportimin dhe bashkërendimin e dëgjësës publike, përkatësisht: pika 7.5 *“Përfaqësuesit e ARM-së mbajnë shënim në mënyrë të pavarur diskutimet e plota të seancës dëgjimore dhe i pasqyrojnë ato në një raport të posaçëm, që i dërgohet AKM-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e mbajtjes së seancës dëgjimore”*; Përgjegjësitë e AKM-së pika 4.2 c/dh *“I dërgon zyrtarisht një kopje të njoftimit strukturës përkatëse për komunikimin me publikun në ministri”*; Përgjegjësitë e ARM-së pika 4.3/ç dhe d *“Merr pjesë ditën e dëgjësës dhe mban shënim diskutimet e bëra nga të pranishmit”* dhe d) *“I dërgon AKM-së raportin për diskutimet e bëra gjatë dëgjësës publike brenda 15 ditëve nga dëgjesa publike”*; pika 5. Bashkërendimi paraprak për organizimin e dëgjësës publike; NJQV pika 6.6. *“Mendimet e dhëna nga publiku, vetëm pranë AKM-së, i dërgohen nga AKM-ja të plota zhvilluesit të projektit, jo më vonë se 4 (katër) ditë nga data e mbajtjes së dëgjësës me publikun”*.

- Mungon verifikimi në terren i saktësisë së informacionit të dhënë nga operatori në kërkesën për leje mjedisi, sipas të cilit AKM është përgjegjëse për verifikimin e saktësisë së informacionit dhe për verifikimin e plotësimit të kushteve të dhënies së lejes së mjedisit; dhënien e mendimit të argumentuar për ministrinë për dhënien ose refuzimin e lejes mjedisore; vendosjen e kushteve të detajuara në leje. Kjo përbën shkelje të ligjit nr. 10448 *“Për lejet e mjedisit”*, datë 14.7.2011, i përditësuar, neni 4 pika c) Agjencia Kombëtare e Mjedisit është autoriteti që verifikon saktësinë e informacionit të dhënë nga operatori në kërkesën e tij për leje mjedisi të tipit A dhe B dhe që i jep mendimin e argumentuar ministrit për dhënien ose jo të kësaj lejeje, me kushte të detajuara, të shkruara, të cilat lëshohen nga QKB-ja; pika d) Inspektorati Shtetëror Kompetent është autoriteti që verifikon plotësimin nga operatori të kushteve të kësaj lejeje, pas lëshimit të saj nga QKB-ja.

Konkluzion: Nga auditimi i procesit të dhënies së Lejes Mjedisore Tipi B për subjektin “NGA G” sh.p.k., janë evidentuar shkelje të konsiderueshme procedurale dhe ligjore. Dokumentacioni i dorëzuar nuk përmban informacion të plotë dhe të detajuar lidhur me dëgjësën publike, përfshirë mungesën e specifikimit të pjesëmarrësve sipas zonave, mungesën e procesverbalit dhe të njoftimeve publike, duke shkelur kështu kërkesat e përcaktuara në VKM nr. 686, datë 29.07.2015 dhe VKM nr. 419, datë 25.06.2014.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk ka kryer verifikimin në terren të informacionit të deklaruar nga operatori, në kundërshtim me nenin 4, pika 2/c të Ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 *“Për lejet e mjedisit”*, ku citohet: *“Autoritetet kompetente për lejet e mjedisit të tipave A, B dhe C janë si më poshtë: c) Agjencia Kombëtare e Mjedisit është autoriteti që verifikon saktësinë e informacionit të dhënë nga operatori në kërkesën e tij për leje mjedisi të tipit A dhe B dhe që i jep mendimin e argumentuar ministrit për dhënien ose jo të kësaj lejeje, me kushte të detajuara, të shkruara, të cilat lëshohen nga QKB-ja”*.

Verifikimi në terren i kryer nga grupi i auditimit i Kontrollit të Lartë të Shtetit më datë 01.04.2025, në prani të përfaqësuesve institucionalë (AKBN dhe NJA Postribë), **konfirmoi se impianti i deklaruar për thyerje dhe fraksionim nuk ishte i instaluar në vend.**

Këto mangësi thelbësore ndikojnë negativisht në transparencën e procesit, kufizojnë përfshirjen efektive të publikut dhe çenojnë ligjshmërinë e procedurave të miratimit të lejes mjedisore.

Mungesa e instalimit të impiantit tregon se subjekti nuk po ushtron aktivitetin sipas Lejes mjedisit dhe çënon vlefshmërinë e lejes.

Subjekti “NGA G” sh.p.k është përgjegjës për sigurimin e dokumentacionit të saktë dhe të plotë në kërkesën për leje mjedisore, organizimin e konsultimit me publikun sipas ligjit, respektimin e kushteve të miratuara nga institucionet përgjegjëse. Në këtë rast, mungesa e instalimit të impiantit të deklaruar për fraksionim sipas Aktit të Miratimit të Lejes Mjedisit dhënies së lejes dhe çdo mosrespektim tjetër i kushteve të lejes apo ligjit, sjell përgjegjësi ligjore për subjektin, përfshirë masa administrative, gjoha, apo ndërprerje të aktivitetit nga autoritetet përkatëse.

Për sa më sipër për veprimet dhe mosveprimet kanë përgjegjësi:

- 1) Z. J. B., në cilësinë e ish Drejtor i Përgjithshëm i AKM-së.
- 2) Z. E. K., në cilësinë e ish Drejtor i Përgjithshëm i AKM-së.
- 3) Znj. A. D., në cilësinë e Drejtor i Përgjithshëm i AKM-së.
- 4) Znj. L. T., në cilësinë e ish Drejtor i Drejtorisë së Lejeve Mjedisore.
- 5) Znj. B. T., në cilësinë ish Përgjegjës i Drejtor i Drejtorisë së Lejeve Mjedisore dhe në cilësinë anëtar i Komisionit të lejes (Nr.25 me Nr.2223/1 prot, datë 18.03.2022).
- 6) Z. F. K., në cilësinë ish Drejtor i Drejtorisë së Lejeve Mjedisore.
- 7) Komisioni i lejes Nr.25, datë 18.03.2022 (E. M., L. Gj., J. M, M. Gj.).
- 8) Komisioni i lejes Nr. 12, datë 22.05.2017 me përbërje: L. T. (Drejtor i Drejtorisë së Vlerësimit në Mjedis), B. T. (Përgjegjëse e Sektorit të Lejeve Mjedisore), E. M. (Përgjegjëse e Sektorit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis), B. K. (Përgjegjëse e Sektorit të Përgjegjësive Mjedisore - në mungesë specialist), E. M. (Juriste), O. N. (Specialiste e Sektorit të Lejeve Mjedisore - protokoll), K. S. (Specialist i Sektorit të Lejeve Mjedisore - prezantim).

2.3. Mbi auditimin e kryerjes së inspektimeve, monitorimeve për aktivitetin minerar të shfrytëzimit me vendndodhje Rasek, Shkodër.

Mbi veprimtarinë monitoruese të IKMT-së:

Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) ka kryer dy inspektime ndaj subjektit “B. C.” sh.p.k, në vitin 2022 dhe 2024. Në inspektimin e parë u konstatua shkelje e kushteve të lejes mjedisore dhe u vendos gjobë administrative prej 300,000 lekë, e ekzekutuar nga përmbaruesi. Ndërsa në inspektimin e vitit 2024 u konstatuan dyshime për shkelje të kushteve të lejes, çështja iu referua Inspektoratit Qendror dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për inspektime të mëtejshme.

Koordinatori Antikorrupsion pranë IKMT-së, i ka kërkuar Drejtorisë së Inspektimit të Mjedisit të IKMT⁵ verifikimin e ankesës për ndotjen e ujit në Postribë nga një gurore, ku janë konstatuar: 1. Sipas Procesverbalit Nr.3, datë 10.01.2022, me seri nr.0001143, ndaj subjektit “B. C.” sh.p.k, me Nipt JB, mbajtur në prani të përfaqësuesit të subjektit z. A. Sh., është konstatuar mosrespektim i kushteve të lejes mjedisit Tipi B, neni 20, 29 pika 1, gërma “b”, “ii” konkretisht: mos depozitim të sterileve në vendin e miratuar; subjekti ka refuzuar nënshkrimin. Vendim nr.03, datë 13.01.2022, nr. seri nr.0001143 i Kryeinspektorit ku është dhënë masë administrative gjobë në shumën prej 300,000 lekë për subjektin “B. C.” sh.p.k, i cili është ekzekutuar nga përmbaruesi për “B. C.” sh.p.k.

-Njoftim Vendimi nga IKMT me shkresë nr.229/4 prot., datë 01.02.2022, subjektit “NGA G” sh.p.k për dënimin me gjobë sipas procesverbalit nr.3, datë 13.01.2022.

-Me shkresë nr. 6122/1 prot., datë 24.01.2022, administratori i shoqërisë “B. C.” sh.p.k, z. N. B., kundërshtoi vendimin e IKMT-së, duke argumentuar se kontrolli ishte kryer në koordinatat e miratuara të nënkontraktorit dhe në prani të përfaqësuesit të nënkontraktorit.

2. Akt konstatim, datë 15.01.2024, sipas Urdhrit të punës nr.43, datë 15.01.2024 të IKMT Qendër për mbështetje të IKMT-së Shkodër e përcjellë nga Komisariati Shkodër për verifikimin e ankesës së banorëve Postribë, mbajtur në prani të administratorit të nënkontraktorit “NGA G” sh.p.k. Nga grupi i përbashkët i punës (A. A., I. A., I. N. (inspektorë IKMT Qendër); G. B., A. B. (inspektorë të IKMT Shkodër) u verifikuan koordinatat, dokumentacioni dhe një vëzhgim i territorit, ku u konstatua mundësia e shkeljeve të lejes mjedisore dhe në përfundim të inspektimit, bazuar në Urdhrin nr. 374 dhe 374/1 datë 30.08.2023 të Inspektoratit Qendror, pika 3, IKMT do të njoftojë IQ dhe AKM si i vetmi autoritet kompetent për këtë çështje, të cilat ia ka përcjellë të dy institucioneve me shkresë nr.368/2 prot., 12.02.2024, bazuar në ligjin nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, nenin 49 Shkelje të dispozitave të tjera ligjore jashtë kompetencës së inspektorit. Kur inspektori, gjatë kryerjes së një inspektimi, ka dyshime të arsyeshme për shkeljen e kërkesave ligjore, që janë në kompetencën e një inspektorati

⁵ Email datë 30.12.2021 informacion mbi trajtimin e ankesës mediatike për ndotjen e ujit në Postribë nga një gurore, përcjellë nga- IKMT- DR Shkodër

tjetër shtetëror apo vendor, ai njofton me shkrim dhe pa vonesë Inspektoratin Qendror. Inspektorati Qendror, me marrjen e njoftimit, ia përcjell atë, pa vonesë, inspektoratit kompetent. -Me shkresë nr. 180/3 prot., datë 22.02.2024, ARM Shkodër iu përgjigj IKMT-së dhe AKM-së, në përputhje me delegimin për inspektim nga AKM, me shkresë nr. 180 prot., datë 15.02.2024. Pas verifikimit në vend, nuk u konstatuan shkelje të kushteve të lejes mjedisore, në lidhje me pretendimet për moszbatim të kushteve të pikës 7.2 dhe nënplikave të saj. U konstatua se subjekti nuk ka shkarkime në kanalizime, përveç shkarkimeve sipërfaqësore të ujërave të shiut, sipas kushteve të pikës 7.3 të lejes mjedisore. Gjithashtu, problematika e ujit të pijshëm është para ndërtimit të gurores dhe është konfirmuar nga UK Shkodër me shkresën nr. 51/1 prot., datë 23.01.2020.

Konkluzion: Procesverbal nr. 3, datë 10.01.2022, është hartuar me pasaktësi në identifikimin e administratorit ligjor të subjektit “B. C.” sh.p.k., duke u referuar gabimisht nënkontraktorit A. Sh. (nënkontraktor) në vend të B. B. Në inspektimin e vitit 2024, IKMT ka ndjekur procedurën ligjore, duke referuar rastin tek AKM dhe Inspektorati Qendror, dhe pas verifikimit nga ARM Shkodër nuk u konstatuan shkelje të mëtejshme.

Për sa më sipër, për veprimet dhe mosveprimet kanë përgjegjësi: z. E. B. në cilësinë ish Drejtor Drejtorisë së Inspektimit të Mjedisit dhe Ujërave; z. K. C. në cilësinë Drejtor Drejtorisë së Inspektimit të Mjedisit dhe Ujërave.

Mbi veprimtarinë monitoruese të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit:

Drejtoria e Inspektimit Kontrollit kryen inspektime në instalimet e tipit B, në përputhje me dispozitat e ligjit nr.10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe ligjit nr.10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. Neni 7 “Një subjekt mund të inspektohet vetëm në zbatim të programit të inspektimit. Përgjatë, një subjekt mund të inspektohet jashtë programit në rastet e parashikuara shprehimisht në ligj. Neni 26 Kohëzgjatja vjetore e inspektimit në vendin e ushtrimit të veprimtarisë 1. Gjatë një viti kalendarik, një subjekt i caktuar inspektimi mund t'u nënshtrohet inspektimeve në vend, në fushën e veprimit të këtij ligji, për një periudhë kohore jo më të gjatë se periudha maksimale e lejuar e inspektimit vjetor.

Nga auditimi rezultoi se, Drejtoria e Inspektimit-Kontrollit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM) ka hartuar dhe dërguar rregullisht Programin Vjetor të Inspektimit për katër rajonet për periudhat përkatëse, i cili është miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, si më poshtë:

- Për periudhën Janar–Dhjetor 2021, me shkresë nr. 26 prot., datë 06.01.2021;
- Për periudhën Janar–Dhjetor 2022, me shkresë nr. 599/1 prot., datë 24.01.2022;
- Për periudhën Janar–Dhjetor 2023, me shkresë nr. 327/1 prot., datë 23.01.2023;
- Për periudhën Janar–Dhjetor 2024, me shkresë nr. 7285/2 prot., datë 20.12.2023.

Në secilin program është paraqitur përshkrimi i objektit të inspektimit, periudha e planifikuar si dhe strukturat përgjegjëse për ndjekjen e zbatimit (AKM/ARM), në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10431/2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe VKM-së nr. 547, datë 30.06.2011 “Për rregullat e funksionimit të inspektimeve në fushën e mjedisit”.

- Për periudhën 2018–2020, nuk u paraqitën programe vjetore të inspektimit të miratuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM), në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10431/2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, neni 73, dhe VKM-së nr. 547, datë 30.06.2011, i cili kërkon planifikim dhe miratim të inspektimeve vjetore nga autoritetet përgjegjëse.
- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të inspektimeve të zhvilluara për subjektin “B. C.” sh.p.k me NIPT JB, me Leje Mjedisore PN-5249-06-2017 dhe aktivitet “Nxjerrja e mineraleve, rërës dhe argjilës nga guroret me shfrytëzim në qiell të hapur”, me vendndodhje në Fshatin Mes, Postribë, Shkodër, rezultoi si më poshtë:

Inspektime e kryera për subjektin “B. C” sh.p.k, për periudhën 2017-2024.

Nipt	Subjekti	Numri i çështjes	Data e hapjes së çështjes	Data e mbylljes së çështjes	Krijuar nga	Inspektor1	Inspektor2	Statusi i çështjes	Mbyllur
J.....B	“B. C.” sh.p.k	AKM-LE- 2023-000041	30.06.2023	20/07/2023	B. F.	N. D.	J. Sh.	E mbyllur	Po

J.....B	"B. C." sh.p.k	AKM-LE-2022-000015	16.02.2022	22/02/2022	N. D.	N. D.	Sh. C.	E mbyllur	Po
J.....B	"B. C." sh.p.k	AKM-LE-2021-000119	26.07.2021	25/08/2021	B. F.	V. Gj.	K. U.	E mbyllur	Po

Burimi i të dhënave: DIK pranë AKM, punuar nga G.A. të KLSH-së.

- Janë realizuar 3 inspektime në total: përkatësisht në vitin 2021, 2022 dhe 2023.
- Nuk janë kryer inspektime gjatë periudhës 2017–2020, si dhe në vitin 2024.
- Nga inspektimet e kryera, nuk janë konstatuar shkelje të kushteve të lejes mjedisore nga subjekti.
- Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në dosjet fizike dhe në sistemin e-Inspektim, të inspektimeve të kryera sipas Autorizimeve Nr. AKM-LE-2021-000119-1, datë 04.08.2021 dhe Nr. AKM-LE-2022-000015-1, datë 16.02.2022, janë evidentuar mangësi në plotësimin e listave të verifikimit përkatëse, konkretisht:

* Në inspektimin e vitit 2021 nuk janë plotësuar 13 rubrika nga 32 gjithsej;

* Në inspektimin e vitit 2022 nuk janë plotësuar 5 rubrika nga 32 gjithsej.

Në këto raste, lista e verifikimit, si dokument bazë për marrjen e vendimit përfundimtar, nuk reflekton plotësisht gjendjen faktike në terren. Kjo çënon transparencën, integritetin profesional, si dhe besueshmërinë e procesit të inspektimit, duke krijuar mundësi për keqinterpretim apo mungesë përgjegjshmërie institucionale në rastet kur vlerësimi nuk është i mbështetur në të dhëna të plota dhe të verifikueshme.

*Nuk është inspektuar asnjëherë subjekti "NGA G" sh.p.k edhe pse ankesat në lidhje me aktivitetin e tij në zonën Rasek kanë qenë të vazhdueshme dhe përfaqësues të institucionit kanë qenë pjesë e grupeve të përbashkëta të verifikimit të këtij aktiviteti.

Mangësitë në dokumentimin e inspektimit tregojnë se verifikimi është kryer në mënyrë formale, pa garantuar një vlerësim real dhe objektiv të përputhshmërisë me kushtet e lejes mjedisore. Kjo çënon transparencën dhe besueshmërinë e procesit, duke krijuar hapësirë për keqinterpretim dhe mungesë përgjegjshmërie institucionale.

Mbi detyrimin e paraqitjes së raporteve të vetëmonitorimit dhe raporteve vjetore nga subjekti.

Bazuar në Ligjin nr. 10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", Kreu VI, neni 44, pika 3 dhe 4, për detyrimet e operatorëve mbi monitorimin e përputhshmërisë mjedisore;

Urdhrat e Drejtorit të Përgjithshëm të AKM-së: nr 152 datë 10.09.2018, nr. 3462 dhe nr. 7 datë 02.07.2020, nr.126, datë 10.06.2022 dhe nr.92, datë 02.05.2024, që përcaktojnë procedurën e dorëzimit dhe pranimit të raporteve të vetëmonitorimit dhe atyre vjetore pranë AKM-së;

Pika 2.9.2 e Lejes Mjedisore Tipi B, ku përcaktohet detyrimi për dorëzimin e raporteve të vetëmonitorimit çdo 6 muaj dhe të raportit vjetor çdo vit kalendarik, nga ku rezultoi se:

a) Subjekti "B. C." sh.p.k. me NIPT JB, me Leje Mjedisore Tipi B PN-5249-06-2017, nuk ka Raporte të Vetëmonitorimit për periudhat: Maj 2017 – Nëntor 2017; Maj 2018 – Nëntor 2018; Nëntor 2018 – Maj 2019; Maj 2019 – Nëntor 2019; Nëntor 2019 – Maj 2020 dhe Raporte vjetore për vitet: 2018, 2019, 2020. Këto veprime përbëjnë shkelje të detyrimeve ligjore për vetëmonitorim dhe transparencë mjedisore, si pjesë e sistemit të kontrollit institucional të ndikimit në mjedis.

Raportet e dorëzuara janë hartuar nga Qendra e Monitorimeve Mjedisore sh.p.k. me NIPT KA, e cila ka qenë e akredituar në përputhje me standardin S SH ISO/IEC 17025:2017, me: Certifikatë Akreditimi Nr. LT 042 (20.07.2015 – 19.07.2019); Certifikatë Nr. LT 096 (16.08.2019 – 15.08.2023); Certifikatë e vlefshme nga 26.07.2023 – 25.07.2027. Subjekti ka patur gjithashtu licencë profesionale nr. LN-2652-01-2011 dhe autorizime përkatëse nga subjekti zhvillues i lejes mjedisore për hartimin dhe dorëzimin e raporteve të vetëmonitorimit në datat 09.05.2017, 10.07.2022 dhe 30.01.2024.

b) Subjekti "NGA G" sh.p.k., i pajisur me Leje Mjedisi Tipi B (LC-1746), me PN-1089-03-2022, datë 23.03.2022, ka dorëzuar raporte të vetëmonitorimit për periudha që i paraprijnë datës së pajisjes me leje mjedisore, konkretisht:

- Raportet për periudhat Nëntor 2020 - Maj 2021, Maj 2021 - Nëntor 2021, dhe Maj 2022 - Nëntor 2022, si dhe një raport për Maj 2024 -Nëntor 2024, janë dorëzuar me numër identifikimi PN të subjektit “B. C.” sh.p.k., gjë që përbën paqartësi administrative dhe mungesë përputhshmërie ligjore, duke shkelur parimet e sakta të zbatimit të legjislacionit për raportimin e detyrueshëm mjedisor, pasi raportet e vetëmonitorimit janë detyrim i subjektit vetëm pas pajisjes me Leje Mjedisi dhe në përputhje me PN-në përkatëse.
- Raporti vjetor për periudhën Nëntor 2022 - Nëntor 2023 është dorëzuar me autorizim të subjektit, por pa datë.
- Nuk ka Raporte të Vetëmonitorimit për periudhën Mars 2022-Shtator 2022.

Raportet e Vetëmonitorimit janë hartuar nga "E.-S.-P" sh.p. k, me Nipt LQ, akredituar për kryerje analiza laboratorike në përputhje me S SH ISO/IEC: 17025:2017 nga Drejtoria Përgjithshme e Akreditimit me Certifikatë Akreditimi nr. L/T 070, datë e akreditimit 11.02.2022 e vlefshme deri 10.02.2026, Licensë Profesionale me nr. LN-2652-01-2011 dhe me Autorizim të subjektit, datë 10.07.2024, nr.345/10 prot., datë 01.04.2024; nr.310/10 datë 31.03.2023; nr.876/3 prot, datë 28.09.2024 e të tjera pa datë të subjektit autorizues.

✚ Për subjektin “NGA G” me PN-1089-03-2022 rezultoi se, prej fillimit të marrjes së lejes mjedisore e në vijim nuk është kryer asnjë inspektim, në kundërshtim me ligjin nr.10433, datë. 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, Neni 7, 26.

Konkluzion: 1. Subjekti “B. C.” sh.p. k, me NIPT JB dhe Leje Mjedisi Tipi B, nuk ka dorëzuar raportet e vetëmonitorimit për disa periudha 6-mujore gjatë viteve 2017–2020, si dhe raportet vjetore për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021. Këto mospërputhje përbëjnë shkelje të detyrimeve ligjore të përcaktuara në Ligjin nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” Kreu VI - Monitorimi i gjendjes së mjedisit, neni 44, pika 3, 4 dhe pengojnë kontrollin institucional për të vlerësuar ndikimin real të aktivitetit të subjektit në mjedis dhe të ndërmarjes së masave parandaluese apo korigjuese në kohë, duke ndikuar kështu në rritjen e rrezikut të ndotjes së mjedisit dhe të cënimit të shëndetit publik të banorëve të zonës.

2. Subjekti “NGA G” sh.p.k, me Leje Mjedisi Tipi B (PN-1089-03-2022), nuk ka përmbushur detyrimet e vetëmonitorimit të përcaktuara në Ligjin nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” Kreu VI-Monitorimi i gjendjes së mjedisit, neni 44, pika 3, 4 për dorëzimin e raporteve të vetëmonitorimit për periudhën Mars - Shtator 2022. Gjithashtu, nuk ka dorëzuar raportin e vetëmonitorimit për periudhën e parë pas marrjes së lejes dhe disa nga autorizimet e subjektit për studion mjedisore për dorëzimin e mëvonshëm të raporteve janë pa datë; ka dorëzuar raporte të hartuara para pajisjes me leje mjedisore dhe për një subjekt tjetër (“B. C.” sh.p. k), çka nuk justifikohet ligjërisht.

3. Drejtoria e Inspektimit dhe Monitorimit në AKM dhe ARM Shkodër nuk kanë realizuar dhe dokumentuar në mënyrë të rregullt veprimtarinë e monitorimit dhe inspektimit për të dy subjektet. Mungojnë programet vjetore të inspektimit për vitet 2018–2020, si dhe inspektimet në terren për subjektin “B. C.” gjatë 2017–2020 dhe vitit 2024. Për “NGA G” nuk është kryer asnjë inspektim pas pajisjes me leje mjedisore në vitin 2022, ndonëse ka pasur ankesa të përsëritura nga komuniteti. Dokumentimi i inspektimeve për vitet 2021 dhe 2022 për subjektin “B. C.” është i paplotë, me mangësi të ndjeshme në plotësimin e listave të verifikimit, duke cënuar besueshmërinë e procesit të vlerësimit. Gjithashtu, nuk është ndjekur dorëzimi dhe vlerësimi i raporteve të vetëmonitorimit, duke lejuar mospërmbushjen e detyrimeve ligjore nga subjektet dhe duke treguar dobësi në sistemin e mbikëqyrjes mjedisore dhe mungesë të mekanizmave efektive të kontrollit institucional.

Për sa më sipër, për veprimet dhe mosveprimet kanë përgjegjësi: z. D. S. në cilësinë Drejtor i Drejtorisë së Inspektimit dhe Monitorimit; z. B. F. në cilësinë Drejtor i ARM Lezhë, Shkodër, Kukës; z. K. K. në cilësinë ish Drejtor i ARM Shkodër.

Mbi veprimtarinë monitoruese të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore:

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), në cilësinë e institucionit përgjegjës për mbikëqyrjen dhe monitorimin e zbatimit të legjislacionit në fushën e shfrytëzimit të burimeve minerare, ushtron inspektime dhe monitorime periodike pranë subjekteve që ushtrojnë aktivitet në këtë sektor. Qëllimi i këtyre inspektimeve është vlerësimi i përputhshmërisë së veprimtarisë me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

Në këtë kuadër, mbajtja e akt konstatimeve të inspektimeve përbën një detyrim ligjor i cili duhet të përmbushet periodikisht, çdo 6 muaj. Këto akt-konstatime përfaqësojnë dokumentin zyrtar të evidentimit të gjendjes faktike në terren, identifikimit të mangësive apo shkeljeve të mundshme, si dhe ndjekjes së masave korigjuese nga subjektet përkatëse. Mosrespektimi i këtij detyrimi ndikon në procesin e monitorimit dhe mund të ndikojë në vlerësimin e përputhshmërisë së aktivitetit të subjektit me kërkesat ligjore.

Nga auditimi i ushtruar në lidhje me përmbushjen e këtyre detyrimeve rezultoi se, për subjektet "B. C." sh.p.k dhe NGA G" sh.p.k janë mbajtur akt konstatimet si më poshtë:

Datë 03.04.2018, grupi i punës: Sh. M., F. D., A. L. Subjekti "B. C." sh.p.k po punon për hapjen e rrugës. Nuk janë lënë detyra.

Datë 29.08.2018, grupi i punës: M. Rr., E. B., A. L., H. C.. Detyrë "B. C." sh.p.k: Subjekti "B. C." sh.p.k është udhëzuar që nënkontraktori të ndalojë punimet për hapjen e rrugës në pjesën juglindore të zonës së lejes minerare, si pasojë e ankesave nga banorët. Gjatë periudhës janar-gusht, subjekti ka prodhuar rreth 200 m³ gëlqeror të mermerizuar.

Datë 02.10.2019, grupi i punës: E. B., A. I., V. D.. Detyrë "B. C." sh.p.k: Të kontrollohet depozitimi i sterileve për të shmangur rrezikun pasi në pjesën lindore ndodhet burimi i ujit të pijshëm të Postribës. Për "NGA G" sh.p.k: Është raportuar zbatimi për ndërtimin e urës për mbrojtjen e tubacionit të ujit të pijshëm, detyrë e lënë nga ankesa e banorëve të zonës. Nuk janë lënë detyra të reja.

Datë 16.09.2020, grupi i punës: Sh. M., E. B., A. I.. Detyrë për "NGA G" sh.p.k: Ndalohet shfrytëzimi në pjesën J-L të lejes minerare, për të cilën ka ankesë nga banorët e zonës si dhe të mbahen nën kontroll kanali vaditës.

Datë 17.09.2020, grupi i punës: E. B., A. I., V. D.. Detyrë "B. C." sh.p.k: Të mbahet nën kontroll depozitimi dhe menaxhimi i sterileve për parandalimin e rreshqitjes së gurëve në pjesën lindore, për ruajtjen e burimit të ujit të pishëm Postribë dhe rrugës së fshatit.

Datë 28.01.2021 grupi i punës: G. T., Sh. M., H. C.. Detyrë: "B. C" sh.p.k: Të parashikohet rehabilitimi në zonën me pamje nga rruga kryesore. Detyrë "NGA G" sh.p.k: Të vazhdohet puna në pjesën jugore dhe të hapet shesh depozitimi në pjesën veriore të karrierës.

Datë 13.10.2021, grupi i punës: Sh. M., E. B., H. C.. Detyrë "B. C." sh.p.k: Të bëhet rehabilitim në pjesën jugore. Nuk shprehet vlerësimi për zbatimin e detyrave të mëparshme. Për "NGA G" sh.p.k: Nuk shprehet për zbatimin e detyrave të mëparshme dhe nuk lihen detyra të reja.

Datë 27.04.2022, grupi i punës: Sh. M., E. B., A. I.. Detyrë "B. C." sh.p.k: Të bëhet rehabilitimi i mjedisit në zonën e depozitimit. Detyrë "NGA G" sh.p.k: Rehabilitim në zonën e shfrytëzuar.

Datë 12.10.2022, grupi i punës: M. Rr., G. T., H. C.. Detyrë "B. C." sh.p.k: Të vazhdojë hapja e rrugës dhe sistemimi i sterileve. Nuk shprehet për zbatimin e detyrave të mëparshme. Për "NGA G" sh.p.k": U raportua ndërtimi i murit gabion dhe rehabilitimi i rrugës hyrëse. Nuk ka vlerësim të zbatimit të detyrave të mëparshme

Datë 24.05.2024, grupi i punës: G. T., Y. Sh., H. C.. Për "B. C." sh.p.k: Nuk ka vlerësim për zbatimin e detyrave të mëparshme dhe nuk janë lënë detyra të reja. Detyrë "NGA G" sh.p.k: Rehabilitim në zonën e shfrytëzuar. U raportua vendosja e tobinave në rrugën që kalon mbi lumë. Nuk janë lënë detyra të reja dhe mungon vlerësimi i zbatimit të detyrave të mëparshme. Për periudhën e auditimit, prej marrjes së lejes minerare (qershor 2017) e në vijim aktiviteti mineral i subjekteve "B C" sh.p.k dhe NGA G" sh.p.k nuk është monitoruar, konkretisht për periudhat:

- Aktiviteti mineral i këtyre subjekteve nuk është monitoruar për një periudhë 6-mujore të viteve 2019, 2020, 2024, ndërsa nuk është monitoruar për asnjë periudhë 6-mujore për vitin 2023, pavarësisht se ishte parashikuar në programin vjetor. Këto mangësi ndikojnë negativisht në efektivitetin e mbikëqyrjes dhe në zbatimin e kërkesave ligjore për monitorimin e veprimtarive minerare.

- Nga shqyrtimi i akteve të kontrollit rezulton se ndonëse janë identifikuar risqe konkrete që lidhen me burimin e ujit të pijshëm të Postribës - si depozitimi i sterileve apo punime ndërtimi për vendosje tobinash, mure gabion pranë tubacioneve të ujit të pijshëm - mungon një ndjekje e vazhdueshme dhe e dokumentuar për masat që duhej të ndërmerreshin nga subjektet.

-Në shumicën e rasteve nuk vlerësohet zbatimi i detyrave të mëparshme, detyrat e lëna janë të përgjithshme, pa afate, ose mungojnë plotësisht, pavarësisht risqeve të vazhdueshme.

Konkluzion: Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) nuk ka kryer monitorimin dhe nuk ka mbajtur akt konstatime për çdo periudhë 6-mujore, siç kërkohet nga legjislacioni në fuqi. Në inspektimet e kryera, shpesh mungon vlerësimi për zbatimin e detyrave të mëparshme, ndërsa detyrat e lëna janë të përgjithshme, pa afate dhe jo të matshme, ose mungojnë fare, pavarësisht pranisë së risqeve të vazhdueshme dhe detyrave të lëna nga verifikimet në vend të kryera nga grupe pune të përbashkëta institucionale çka tregon mungesë vazhdimësie dhe koordinimi të duhur në mbikëqyrjen institucionale të veprimtarive minerare, veçanërisht në rastet kur aktivitetet zhvillohen pranë burimeve të ujit të pijshëm dhe zonave të banuara.

Në zbatim të ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 25/ç dhe Urdhrit nr. 201, datë 20.06.2016 pika 3 “Për miratimin e formës së informacioneve tremujore, vjetore, përfundimtare dhe përmbajtjen e planit vjetor të punës nga ana e zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit për grupin e mineraleve ndërtimore”, zotëruesi i lejes minerare paraqet për shqyrtim pranë strukturës përgjegjëse në AKBN një plan vjetor pune të hartuar në përputhje me detyrimet e përcaktuara në lejen e tij, jo më vonë se 30 ditë kalendarike përpara përfundimit të vitit llogaritur nga data e hyrjes në fuqi të lejes., të cilat miratohen nga struktura përgjegjëse jo më vonë se 30 ditë nga data e paraqitjes së tyre.

Nga auditimi konstatohet se:

- Nga ana e subjektit “B. C.” sh.p.k dhe “NGA G” sh.p.k, për periudhën e auditimit, aplikimi për planin vjetor të vitit është bërë brenda afatit ligjor të parashikuar, ndërsa miratimi i tyre nga strukturat përgjegjëse të AKBN-së, është bërë jashtë afatit 30-ditor nga aplikimi, në 4 raste për subjektin “B. C.” sh.p.k dhe në 3 raste për subjektin “NGA G” sh.p.k, në kundërshtim me nenin 25 pika “ç” të Ligjit Nr. 10304 “Për sektorin mineral në RSH”, i ndryshuar dhe Urdhrit nr. 201, datë 20.06.2016 pika 3, ç’ka tregon se është kryer aktivitet pa miratim të planit të aktiviteteve, mungesë të respektimit të detyrimeve ligjore, mungesën e burimeve njerëzore të mjaftueshme.

Neni 25: *Zotëruesi i lejes së shfrytëzimit me karrierë të mineraleve dhe materialeve të ndërtimit, të grupit të mineraleve ndërtimore, ka këto detyrime: ç) të paraqesë për shqyrtim pranë strukturës përgjegjëse një plan pune vjetor, .. jo më vonë se 30 ditë kalendarike përpara përfundimit të vitit, llogaritur nga data e hyrjes në fuqi të lejes... të cilat miratohen nga strukturat përgjegjëse jo më vonë se 30 ditë nga data e paraqitjes së tyre. Në rast mosmiratimi, struktura përgjegjëse e njofton zotëruesin e lejes minerare për arsyet e këtij mosmiratimi. Pas tejkalimit të këtij afati, plani quhet i miratuar.*

- Referuar nenit 25 të ligjit nr.10304 “Për sektorin mineral në RSH”, i ndryshuar ku zotëruesit e këtyre lejeve gjatë ushtrimit të veprimtarisë minerare kanë detyrimin që, **b)** të paraqesë pranë strukturës përgjegjëse çdo 3 muaj⁶, jo më vonë se data 15 e muajit që vijon pas tremujorit përkatës, një informacion mbi realizimin e prodhimit, investimeve, vlerën e produkteve të shitura, punimeve minerare të realizuara dhe gjithë operacioneve të kryera për rehabilitimin e mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve minerare, në përputhje me detyrimet e tij të lejes minerare dhe planin vjetor; **c)** të paraqesë pranë strukturës përgjegjëse çdo vit⁷, jo më vonë se 30 ditë nga

⁶ Ndryshuar: Çdo 6 muaj kalendarik, ndryshuar me neni 16 i ligjin nr.65/2021

⁷ Ndryshuar: Çdo vit kalendarik, ndryshuar me neni 16 ligjit nr,65/2021

përfundimi i vitit përkatës, raportin financiar dhe teknik të të gjitha operacioneve të kryera, në përputhje me detyrimet e përcaktuara në lejen e tij minerare dhe planin vjetor të punës.

Referuar databazës së të dhënave mbi vetë-deklarimet për periudhën objekt auditimi rezulton se,

- Subjekti “B. C.” sh.p.k ka dorëzuar rregullisht informacionet për periudhën nga tremujori III 2017 deri në vitin 2024. Nga të dhënat rezulton se prodhimi ka nisur në tremujorin IV të vitit 2018. Në periudhën nga marrja e lejes minerare më 30.06.2017 deri në fund të tremujorit II-të të vitit 2018, subjekti ka kryer punime për hapjen e rrugës, rehabilitimin e trases dhe ndërtimin e sheshit, me një kohëzgjatje prej rreth 1 viti.

Subjekti “NGA G” sh.p.k ka dorëzuar rregullisht vetë-deklarimet për periudhën nga tremujori II-të viti 2019 deri në përfundim të vitit 2023. Grupi i auditimi kërkoi raportet 6-mujore dhe raportin vjetor të vitit 2024, por deri në përfundim të fazës së terrenit nuk na u paraqitën. Mosdërgimi në afat i tij, sipas nenit 45 pika 1 gërma “ç” e ligjit nr.10304 “Për sektorin minerar në RSH”, datë 15.07.2010, i ndryshuar, dënohet me masë administrative gjobë 100,000 lekë dhe neni 25 pika 1 gërma “c”, dënohet me masë administrative gjobë 150,000 lekë.

Raportet e monitorimit të hartuara nga struktura përgjegjëse në AKBN.

Nga ana e AKBN janë përgatitur dhe dorëzuar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë raporte 6-mujore dhe vjetore të mbikëqyrjes së çdo aktiviteti minerar në përputhje me nenin 43 pika 3 e ligjit nr.10304 “Për sektorin minerar në RSH”, i ndryshuar “*Struktura përgjegjëse harton dhe i paraqet ministrit çdo 6 muaj një raport për çdo veprimtari minerare, dhe pikën nr. 2, gërma “i”, të VKM nr. 232, datë 23.03.2011 “Për miratimin e funksioneve të strukturës përgjegjëse në sektorin minerar të RSH”, ku përcaktohet detyrimi i AKBN mbi hartimin dhe paraqitjen në Ministri, çdo 6 muaj të një raporti për çdo veprimtari minerare, i cili përmban të dhëna mbi:*

- a. respektimin e realizimit të projektit minerar;
- b. realizimin e operacioneve e të punimeve minerare dhe depozitimin e mbetjeve minerare;
- c. lëvizjen e rezervave minerare;
- ç. kryerjen e operacioneve minerare, në përputhje me normat e ruajtjes së mjedisit minerar, duke u këshilluar me njësitë qeverisjes vendore të zonës minerare;
- d. respektimin e standardeve të sigurisë në punë e të mbrojtjes së shëndetit të punonjësve, duke dhënë edhe rekomandimet përkatëse.

- Nga krahasimi i treguesve të paraqitur ndërmjet raporteve të mbikëqyrjes, sistemit RevZonë dhe planit vjetor të punës janë konstatuar mospërputhje në: numrin e punonjësve në listëpagesë (E-SIG), numrin e punonjësve me sigurim jete, prodhimin e raportuar dhe tregues të tjerë. Raportet e mbikëqyrjes paraqesin gjithashtu mangësi në të dhënat mbi: vlerën e operacioneve të rehabilitimit të mjedisit dhe menaxhimit të mbetjeve, realizimin e investimeve dhe lëvizjen e rezervave minerare. Raportimi i numrit të punonjësve është i ndryshëm në listëpagesat E-sig 025, në raportet e vetëdeklarimeve.

- Nga verifikimi i dosjeve të shqyrtimit të planeve vjetore të punës u konstatua se, lista e sigurimit të punonjësve E-Sig-25 është dorëzuar për të gjithë punonjësit e regjistruar në aktivitetin minerar të subjektit, por kjo listë nuk pasqyrore ndarjen specifike të punonjësve sipas aktiviteteve minerare (sipërfaqësore ose nëntokësore), siç kërkohet nga rregulloret përkatëse. Për më tepër, në dosjet fizike mungonin raportimet mbi numrin e punonjësve aktivë në aktivitetin minerar dhe ndryshimet që ndodhnin gjatë vitit, duke shkelur detyrimet e përcaktuara në rregullore. Gjatë inspektimeve, nuk është kryer verifikim individual i punonjësve të deklaruar në listëpagesën E-Sig-25 me kontratat e sigurimit nga aksidentet në punë, duke kufizuar kontrollin mbi përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në nenin 36, pika 5 të Ligjit nr. 10304/2010.

- Gjithashtu, është vërejtur se punonjësit janë siguruar me një prim sigurimi prej 3,000 lekë, në kundërshtim me kërkesat e VKM-së nr. 1109, datë 30.07.2008, “Për sigurimin e punonjësve të punësuar në veprimtarinë minerare, nga aksidentet në punë”, pika 3 ku citohet: “*Shuma për çdo punonjës të siguruar, e përcaktuar në formularin e kontratës së sigurimit, nuk mund të jetë më e*

ulët se 6,000,000 lekë. Pika 4 Tarifa e primit të sigurimit nuk mund të jetë më e ulët se 0.5% e shumës së siguruar të shënuar në formularin e kontratës së sigurimit”.

- Ka raporte monitorimi, por nuk ka akt konstatime të rregullta 6-mujore për mbikëqyrjen e monitorimin e kryer nga grupi i specialistëve të Sektorit të Monitorimit për subjektin “B. C.” sh.p.k dhe “NGA G” sh.p.k për një periudhë 6-mujore të viteve 2019, 2020, 2024, ndërsa nuk është monitoruar për asnjë periudhë 6-mujore për vitin 2023, në kundërshtim me kërkesat e nenit 43 të ligjit 10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në RSH”, i ndryshuar pika 3 “Struktura përgjegjëse harton dhe i paraqet ministri çdo 6 muaj një raport për çdo veprimtari minerare...”. Përmbledhje e të dhënave të deklaruara, Raporte të Vetëdeklarimit krahasuar me Raporte të Mbikëqyrjes, mbi fuqinë punëtore, me sigurim jete për periudhën 2017-2024:

Për subjektin: “B. C” sh.p. k:

Viti	Vetëdeklarim	Sigurim Jete	Raporti Mbikëqyrjes	Sigurim Jete	Shënime/Komente
2017	1 punonjës	Pa sigurim	? punonjës	?	Mungesë përputhjeje, mungon informacion për raportin
2018	5 punonjës	5	5 punonjës	3	Në fazë punimesh
2019	7 punonjës	5	3 punonjës	3	Mospërputhje
2020	7 punonjës	7	9 punonjës	9	Mospërputhje në sasi prodhimi (530.54 m ³ vs 2000 m ³)
2021	7 punonjës	7	7 punonjës	7	Përputhje
2022	20 punonjës	20	20 punonjës	20	Përputhje
2023	5 punonjës	5	12 punonjës	8	Mospërputhje
2024	?	?	10 punonjës	10	Mungon informacion pr vetëdekl., për info jo e plotë

Burimi: AKBN, punuar nga G.A të KLSH-së.

Për subjektin “NGA G” sh.p.k

Viti	Vetëdeklarim	Sigurim Jete	Raporti Mbikëqyrjes	Sigurim Jete	Shënime/Komente
2018	S'ka vetëdeklarim	-	Nuk përfshihet	-	Në fazë përgatitore; ka marrëveshje me zot. lej.
2019	7 punonjës	3	Nuk përfshihet	-	Mungesë raportin
2020	10 punonjës	3	10 punonjës	3	Mospërputhje në sasi prodhimi (226 m ³ vs 300 m ³)
2021	10 punonjës	5	10 punonjës	5	Përputhje
2022	14 punonjës	10	14 punonjës	10	Përputhje
2023	12 punonjës	8	12 punonjës	8	Përputhje
2024	11 punonjës	5	11 punonjës	5	Përputhje

Burimi: AKBN punuar nga G.A të KLSH-së.

Detyrimi për sigurimin e jetës së punonjësve nga aksidentete në punë, janë përcaktuar sipas ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, i ndryshuar “Për sektorin minerar në RSH” neni 36 pika 5 Detyrimet gjatë ushtrimit të veprimtarisë minerare; “Të bëjë sigurimin e punonjësve të punësuar në veprimtarinë minerare nga aksidentet në punë, sipas rregullave të sigurimit, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave”, si dhe:

-Rregullore nr. 2690/1 prot., datë 27.7.2022, miratuar me Urdhër nr.153, datë 27.07.2022 të Drejtorit Ekzekutiv “Për funksionimin e komisionit për shqyrtimin e dokumentacionit dhe miratimit të planeve vjetore të punës, të zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit dhe përpunimit, ku kërkohet: “Deklaratë e subjektit minerar me emrat e punonjësve që punojnë në sipërfaqe dhe në nëntokë”;

-Rregullore nr. 490/6 prot., datë 08.06.2023, miratuar me Urdhër nr.122, datë 18.06.2023 ku përcaktohet: “Dokumentacioni nga Shoqëria e Sigurimit për sigurimin e jetës punonjësve shoqëruar me formularët Esig-25”;

-Rregullore nr. 2994 prot., datë 18.06.2024, miratuar nga Drejtori Ekzekutiv për funksionimin e komisionit për shqyrtimin e dokumentacionit dhe miratimit të planeve vjetore të punës, të zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit dhe përpunimit, “Policat e sigurimit për secilin punonjës të punësuar në veprimtarinë minerare... të përmbajnë të dhënat e lejes minerare; numri i punonjësve të siguruar, për secilin subjekt, do të përcaktohet duke u mbështetur në listën e punonjësve që ushtrojnë aktivitetet minerar në E sig-25; Subjekti minerar ka detyrimin të mbulojë punonjësit me policë siguri konform kërkesave të VKM-së nr.1109, datë 30.07.2008 “Për sigurimin e punonjësve të punësuar në veprimtarinë minerare, nga aksidentet në punë”; Subjekti

ka detyrimin të raportojë (dhe dorëzojë) pranë strukturës përgjegjëse në lidhje me çdo punonjës që del, futet në skemën e sig. shoq. pas miratimit të planit vjetor të punës dhe gjatë vitit efektiv; policat e origjinale për secilin punonjës ... duhet të fillojnë dhe të mbarojnë me datën e lejes minerare ..”.

Nga krahasimi i raporteve të mbikëqyrjes dhe monitorimet me treguesit e raportuar ne RevZonë rezulton se vlerat e paraqitura nuk janë të njëjta në lidhje me deklarimin e punonjësve dhe me sigurim jete, sidomos për vitin 2020, dhe për sasitë e prodhimit të deklaruar (sidomos viti 2020 për “B. C.” sh.p.k), gjë e cila cënon saktësinë e informacionit mbi aktivitetin minerar, vështirëson ndjekjen e detyrimit të sigurimit të jetës së punonjësve.

Për periudhën 2021–2022 vetëdeklarimet dhe raportet përputhen, për të dy subjektet.

- Subjekti nuk ka përmbushur plotësisht detyrimin për sigurimin e punonjësve sipas kërkesave ligjore dhe rregullatore, duke krijuar mangësi në mbrojtjen ligjore të stafit dhe transparencën institucionale.

Mbi verifikimin në terren të kryer pranë aktivitetit minerar:

Aktiviteti minerar që ushtrohet në vendburimin “Rasek”, i ndodhur në Njësinë Administrative Postribë, Bashkia Shkodër, është bërë objekt verifikimi pas ankesës së banorëve të zonës. Ky verifikim është kryer në bazë të Autorizimit Nr. 193 prot., datë 30.01.2025, lëshuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit drejtuar institucioneve përkatëse si: Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM), Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT), Bashkisë Shkodër. Bazuar në këtë autorizim, në datë 01.04.2025, u krye një verifikim në terren nga grupi i punës i KLSH-së, i përbërë nga z. P. I. dhe znj. Xh. K., në prani të përfaqësuesve të: AKBN-së, z. G. T. dhe NJVA-së z. A. C..

Gjatë këtij verifikimi u evidentuan një sërë konstatimesh në lidhje me mënyrën e ushtrimit të aktivitetit minerar në zonë, si më poshtë:

1. U konstatua se vendburimi i ujit të pijshëm ndodhet në afërsi të përroit, me ekspozim të lartë ndaj përmbytjeve dhe prurjeve të aluvioneve. Disa prej pusetave shkarkuese ndodhen në shtratin e përroit Rasek, çka rrit ndjeshëm riskun për ndotje të ujit, sidomos në raste reshjesh të shumta dhe aktiviteteve të tjera.

2. Subjekti “NGA G” sh.p.k është konstatuar se ka depozituar mbetje sterile të ngurta afër sipërfaqes së lejes minerare, jashtë saj, në një sipërfaqe të marrë në kujdestari nga Bashkia Shkodër, me nr.33 prot., datë 10.02.2022.

3. Brenda zonës minerare, ku ushtron aktivitetin e shfrytëzimit nënkontraktori “NGA G” sh.p.k, u konstatuan hedhje të materialeve inerte në shtratin e përroit Rasek, si rezultat i punimeve përgatitore dhe ato të aktivitetit minerar.

4. Infrastruktura rrugore ku kryhet aktiviteti minerar nga “NGA G” sh.p.k është i ndryshëm nga ai i miratuar në projektin fillestar. Kjo rrugë kalon përmes përroit Rasek mbi të cilin është ndërtuar një urë provizore e cila stimulon ndotje gjatë kalimit të mjeteve të tonazhit të lartë të përduruar nga ky subjekt.


5. Sasia e marrjes së ujit për përdorim teknologjik gjatë kryerjes së aktiviteti minerar merret nga trupi ujqor i përroit, nëpërmjet pompimit.

6. Si nga ana e subjektit “B. C.” sh.p.k dhe nga “NGA G” sh.p.k , sasia e marrjes së ujit për përdorim teknologjik gjatë kryerjes së aktiviteti minerar merret nga trupi ujqor i përroit, nëpërmjet pompimit.

7. Nga ana e subjektit “B. C.” sh.p.k është konstatuar se ka depozituar mbetje sterile të ngurta afër sipërfaqes së lejes minerare, anash rrugës që te con ne kantier.

8. Subjekti “B. C.” sh.p.k dhe nga “NGA G” sh.p.k edhe pse kane ushtruar aktivitet , gërryerje, gërmimi hapje rrugësh etj, nuk kane filluar një proces rehabilitimi te sipërfaqes se shfrytëzuar (dëmtuar).

Foto të bëra nga grupi i auditimit, gjatë verifikimit në zonën minerare, Rasek.



Puseta ujit që ndodhen në shtratin e lumit.





Sterile depozituara në sipërfaqen marrë në “kujdestari” nga Bashkia Shkodër.



Sterile hedhura në shtratin e lumit



Vepra marrjes së ujit dhe vendburimi ujit të pijshëm.

	
<p>Rruga për kantier (i ndryshuar nga projekti i miratuar)</p>	<p>Puseta e ujit, buzë lumit</p>

Në datë 16.01.2020, një grup ndërinstucional (Bashkëqeverisja, MIE, AKBN, MTM, AKM DRM Shkodër, konsulentë dhe përfaqësues të shoqatës “Zyra Qendrore e Mbrojtjes së Mjedisit”) bëri verifikimin në terren pas ankesave të banorëve për aktivitetin minerar të subjekteve “B. C.” sh.p.k dhe “NGA G” sh.p.k. U konstatua se sterile dhe materiale të tjera minerare ishin hedhur në mënyrë të papërshtatshme në shpatet e malit, në shtratin e kanalit vaditës dhe në aksin e përroit Rasek, dhe u caktuan detyra me afate për korrigjimin e situatës.

Shkresa nr. 318/1 prot., datë 05.02.2021 nga AKBN-ja i përgjigjet MIE-së lidhur me shkresën e Avokatit të Popullit (nr. K3 K15-3, datë 20.11.2020), duke njoftuar se të dy subjektet kanë përmbushur detyrat e vendosura pas inspektimit në terren nga specialistët e Drejtorisë Minerare të AKBN-së dhe përfaqësuesit e MIE.

Nga akti i verifikimit i mbajtur në terren nga grupi i auditimit konstatohen të njëjta problematika, kryesisht në zonën ku kryen punime shfrytëzimi nga subjekti “NGA G” sh.p.k.

Grupi i auditimit kërkoi dokumentin e miratimit të ndryshimit të projektit teknik nga komisioni përkatës në AKBN për ndryshimin e rrugës “NGA G” sh.p.k, por nuk u paraqit deri në përfundim të auditimit, ashtu si edhe konfirmohet dhe shpjegohet në shkresën nr.9714/3 prot., datë 10.10.2018 e Drejtorisë së Programeve dhe Zhvillimit në Fushën Minerare dhe Industrisë, në MIE, drejtuar Zyrës Qytetare të Mbrojtjes së Mjedisit.

Për sa më sipër për veprimet dhe mosveprimet kanë përgjegjësi, nga ana e AKBN-së: Prej periudhës 30.6.2017 e në vazhdim: ish Drejtor Ekzekutiv z. E. S., ish Drejtor Ekzekutiv z. A. B., z. E. S. në cilësinë Drejtor Ekzekutiv, z. A. A. ish Drejtor i Drejtorisë Minerare, z. M. Rr. ish Drejtor i Drejtorisë Minerare, z. E. B. ish Drejtor i Drejtorisë Minerare, z. Gj. L. ish Drejtor i Drejtorisë Minerare, z. E. M. Drejtor i Monitorimit, z. G. T. shef i Sektorit të Monitorimit.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se procedura e shpalljes së lejes minerare nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është zhvilluar pa këshillim me institucionet përkatëse, Këshillin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore qeverisjen vendore dhe pa Vlerësim Strategjik

Mjedisor të plotë, në kundërshtim me Ligjin nr.10304/2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin nr.27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” dhe Ligjin nr.91/2013 “Për vlerësimin strategjik mjedisor”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, në faqet nr.9 deri në faqen nr.14 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse për mjedisin, trashëgiminë kulturore dhe qeverisjen vendore, të garantojë që shpallja dhe miratimi i zonave minerare të zhvillohet në përputhje të plotë me legjislacionin përkatës. Ky proces duhet të përfshijë: këshillimin ndërinstytucional, kryerjen e Vlerësimit Strategjik Mjedisor të plotë.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se gjatë vlerësimit të dokumentacionit aplikues për leje minerare ka mungesë të standardizimit në kriteret tekniko-profesionale, ku nuk përcaktohen numër minimalë për fuqinë punëtore apo specifikime për mjetet e nevojshme, e cila ka sjellë paqartësi dhe trajtim të pabarabartë ndërmjet konkurrentëve. Kjo situatë nuk është në përputhje me kërkesat e pikës 7.9 të VKM nr.320, datë 21.04.2011, të ndryshuar me VKM nr. 301, datë 20.04.2016 “Për miratimin e procedurave konkurruese, kriterëve dhe afateve për marrjen e lejeve minerare në zonat konkurruese të Republikës së Shqipërisë”, e cila kërkon që dokumentet e konkurrimit të përmbajnë kriteret e qarta, objektive dhe të njëjta për të gjithë pjesëmarrësit, në funksion të një procesi transparent dhe konkurrues. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, në faqen nr. 12 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Autoriteti kontraktues, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, për të garantuar transparencë, barazi dhe objektivitet në procedurat konkurruese në vijim, për lejet minerare, të standardizojnë kriteret tekniko-profesionale në dokumentet e garës. Kjo mund të realizohet përmes hartimit të një udhëzuesi teknik që parashikon kufij minimalë të pranueshëm për fuqinë punëtore, tipologjinë dhe disponimin e mjeteve, të përshtatur sipas llojit të aktivitetit minerar. Përfshirja e këtyre kriterëve si pjesë të pandarë e dokumentacionit konkurrues do të minimizonte paqartësitë e procesit garues dhe do të siguronte trajtim të barabartë ndërmjet pjesëmarrësve.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi u konstatua se referuar Akt-Miratimit nr. 1835, datë 30.06.2017, koordinatat e miratuara për shfrytëzimin minerar nga subjekti “B. C.” sh.p.k, në zonën 2/6 (Rasek, Shkodër), nuk përputhen me vendndodhjen faktike të veprimtarisë në terren. Nga auditimi i dokumentacionit dhe verifikimi në terren, i kryer më datë 01.04.2025 në prani të përfaqësuesve të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore dhe Bashkisë Shkodër, u evidentua se subjekti “NGA G” sh.p.k po ushtron aktivitet minerar në një sipërfaqe prej 1.8 ha jashtë kufijve të Lejes Minerare, në një zonë me status fond pyjor/kullor, si dhe në një distancë tepër të afërt me zonën e banuar, me ndërhyrje të dukshme në shtratin e lumit; si dhe hedhjen e materialeve inerte shumë pranë vendburimit të ujit të pijshëm. Nga ana e Bashkisë Shkodër konstatohet se nuk janë marrë masat për këtë problematikë, referuar Ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Aktiviteti ndodhet 200 metra në vijë ajrore nga banesat më të afërta, duke shkelur dispozitat e Ligjit nr.10304/2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; me Ligjin nr. 65/2021, lidhur me distancën mbrojtëse, konsultimin me komunitetet dhe kërkesat mjedisore. Kjo situatë rrezikon ndjeshëm shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e banorëve dhe përbën mangësi në vlerësimin dhe mbrojtjen e komuniteteve përreth. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe nr. 13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore dhe me asistencën teknike të Autoritetit Shtetëror të Informacionit Gjeohapësinor, të kryejë konfigurimin e saktë të koordinatave dhe verifikimin e përputhshmërisë gjeohapësinore të lejes minerare të subjektit “B. C.” sh.p.k.

Duke qenë se pozicionimi aktual përbën rrezik të drejtpërdrejtë për shëndetin, sigurinë dhe mirëqënien e banorëve, si dhe cënon interesin publik, të merren masat përkatëse administrative përfshirë pezullimin deri në revokimin e lejes minerare, në funksion të mbrojtjes së interesave të komunitetit dhe garantimin e zbatimit të ligjit.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së shpalljes së zonës minerare është evidentuar mungesë rregullash të qarta dhe standardesh teknike mbi distancat mbrojtëse ndërmjet aktiviteteve minerare dhe zonave të banuara, si pasojë e paqartësive normative në zbatimin e Ligjit nr. 10304/2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me Ligjin nr. 65/2021. Kjo situatë krijon terren për interpretim të ndryshëm nga institucionet zbatuese, cënim të sigurisë publike dhe konflikt potencial me komunitetet lokale. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe nr.12 deri faqe nr.13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1 Rekomandimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në bashkëpunim me institucionet mjedisore, urbanistike dhe njësitë vendore, duhet të ndërmarrin masa për përcaktimin e kriterëve teknike mbi distancat mbrojtëse sipas tipologjisë së aktivitetit minerar, të integrojë këto kriterë në proceset e miratimit dhe vlerësimit të ndikimit në mjedis, si dhe të garantojë funksionimin e mekanizmave të kontrollit dhe penalizimit në rast shkeljesh. Këto veprime do të mundësojnë një praktikë të njëtrajshme dhe të parashikueshme në mbrojtje të komuniteteve lokale dhe mjedisit.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit dhe procedurës për heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqes së dhënë me Lejen Minerare nr. 1835, datë 30.06.2017, për subjektin “B. C.” sh.p.k, u konstatua sa vijon:

- Subjekti ka paraqitur që në vitin 2017 kërkesën në MIE për heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqes prej 78.5 ha të miratuar për aktivitet minerar, por kësaj kërkesë nuk i është bashkëlidhur dokumentacioni i nevojshëm ligjor për vijimin e procedurës.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Pyjeve edhe pse janë vënë në dijeni nga ana e Bashkisë Shkodër, për ushtrimin e aktivitetit të paligjshëm në fondin pyjor/kullor, nuk kanë ushtruar kompetencat e tyre ligjore si institucione më të larta të fushës së përgjegjësisë për menaxhimin, mbrojtjen dhe administrimin e fondit pyjor kombëtar, në kundërshtim kjo me ligjin nr.57/ 2020 “Për pyjet” Kreu IV neni 14, 15.

Bashkia Shkodër nuk ka mbajtur asnjë dokumentacion ligjor tekniko-vlerësues (akte, vendime, inspektime të kryera), që kanë të bëjnë me ndërhyrjen e paligjshme në fondin pyjor/kullor dhe impakte të tjera në ekosistem dhe në basenin ujëmbledhës të përroit Rasek, që të dëshmojë veprime konkrete për zbatimin e legjislacionit në fuqi për pyjet dhe mjedisin, pavarësisht VKM-së nr. 547, datë 29.07.2020, e cila ngarkon bashkitë për të raportuar dëmin dhe marrjen e masave administrative të nevojshme për fondin pyjor, si dhe bazuar në ligjin nr. 9385, datë 4.5.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” i ndryshuar, Ligjin nr.57/ 2020 “Për pyjet” VKM nr. 391, datë 21.6.2006, i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” dhe VKM, nr. 559, datë 29.7.2022” për tarifën në pyje dhe fondin pyjor”.

Si rrjedhojë, aktiviteti minerar është zhvilluar në një sipërfaqe që vazhdon të jetë si pjesë e fondit pyjor, pa miratimin e nevojshëm sipas legjislacionit në fuqi për periudhën 2017-2025 duke përbërë një shkelje të rregullave të administrimit të fondit pyjor, në kundërshtim me ligjin nr.57/2020 “Për Pyjet”, ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007, “Për fondin kullor”, Ligjin nr. 10304/2010 “Për sektorin minerar”, i ndryshuar; VKM nr.1353, datë 10.12.2008 “Për miratimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor kombëtar”; VKM nr.888, datë 07.12.2022 “Për procedurat e ndryshimit të destinacionit të tokës”.

Gjithashtu, verifikimi në terren pranë zonës minerare “Rasek” konstatoi se subjekti ka ushtruar aktivitetin minerar jashtë kushteve të lejes dhe në kundërshtim me projektin e miratuar, duke kryer ndërhyrje të paligjshme në shtratin e lumit (gërryerje, hedhje materialeve inerte, vendosje

tombinash ,ndërtim ure provizore hapje rrugës), duke shkaktuar dëmtime në mjedis dhe duke devijuar nga proceset teknologjike të shfrytëzimit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqen 14 deri në faqen 17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1. Rekomandimi: Ministria e Mjedisit në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Pyjeve, të mbështesin veprimet ligjore dhe procedurale të Bashkisë Shkodër, për bllokimin e menjëhershëm të punimeve në fondin pyjor dhe kullor në pronësi dhe administrim të saj, dhe sipas rastit të bëhet sekuestrimi, konfiskimi i mjeteve të përdoruara, për zënien gërryerjen, gërmimin dhe tjetërsimin e fondit pyjor/kullor.

Menjëherë

5.2. Rekomandimi: Bashkia Shkodër të dokumentojë parregullsitë e konstatuara në veprimtarinë e ushtruar në fondin pyjor/kullor nga subjektet “B. C.” sh.p.k dhe “NGA G” sh.p.k, duke vlerësuar sipas kërkesave ligjore dëmin ekonomik, financiar dhe mjedisor të shkaktuar, si dhe në përfundim të referojë çështjen pranë organeve kompetente.

Menjëherë

5.3. Rekomandimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, duke vlerësuar veprimtarinë e deritanishme të subjekteve në fondin pyjor/kullor pa dokumentacion të plotë, pa miratimet përkatëse dhe në kundërshtim me legjislacionin përkatës, si dhe mos zbatimin e kushteve të lejes mjedisore dhe mos respektimit të detyrimeve për mbrojtjen mjedisore, të iniciojë procedurat për revokimin e lejes minerare për subjektin “B. C.” sh.p.k dhe subjektin “NGA G” sh.p.k.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit dhe verifikimi në terren, i kryer më datë 01.04.2025 në prani të përfaqësuesve të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore dhe Bashkisë Shkodër, u evidentua se subjekti “NGA G” sh.p.k po ushtron aktivitet minerar në një sipërfaqe prej 1.8 ha jashtë kufijve të Lejes minerare, në një zonë me status fond pyjor/kullor. Bashkia Shkodër ka vendosur në dispozicion sipërfaqen për zhvillimin e aktivitetit minerar nëpërmjet “Procesverbalit nr. 33, datë 10.02.2022”, pa ndjekur procedurat ligjore të kërkuara, në kundërshtim me nenin 36, pika 18 të Ligjit nr. 10304/2010 “Për sektorin minerar”, i ndryshuar. Ky veprim ka krijuar pasiguri ligjore mbi përdorimin e pronës publike, ka rritur rrezikun për dëmtime mjedisore dhe dëmtuar integritetin e procesit të dhënies së lejes minerare.

- Gjithashtu, për sipërfaqen 78.5 ha të dhënë për Lejen Minerare nr.1835 subjektit “B. C.” sh.p.k, nuk janë ndjekur procedurat për ndryshimin e kategorisë së përdorimit të tokës, nga fond pyjor në pasuri minerare, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Sipas verifikimeve në vend, dhe dokumentacionit dëmtimet në fondin pyjor/ kullor janë kryer në format e gërmimeve ose punimeve të tjera në nxjerrjen e gurëve, rërës, zhavorrit, dheut etj. Veprim ky në kundërshtim me nenin 25, pika 4 dhe nenin 27, pika 5, të ligjit nr. 57/2020 “Për pyjet” dhe përlllogaritja e dëmit duhet të bëhet sipas VKM-së nr. 559, datë 29.7.2022 “Për tarifatat në pyje dhe fondin pyjor”, Shtojca 2, pika 15.

Edhe pse shqetësimi për ushtrimin e aktivitetit jashtë kushteve ligjore është evidentuar nga komuniteti lokal dhe është kërkuar ndërprerja e aktivitetit, nuk ka tregues që Bashkia Shkodër të ketë ndërmarrë hapa konkretë, përfshirë hartimin e dokumentacionit përkatës dhe dërgimin e tij në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit. Në komunikimin e fundit të siguruar gjatë auditimit (Maj 2024), rezulton se aktiviteti minerar vazhdon pa ndërprerje, pavarësisht mungesës së akteve ligjore dhe administrative që justifikojnë përdorimin e sipërfaqes. *(Më hollësisht kjo çështje trajtohet në pikën 1, faqet 19 deri në faqen 20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

6.1 Rekomandimi: Bashkia Shkodër, të anulojë Procesverbalin nr. 33, datë 10.02.2022, për dhënien në përdorim të sipërfaqes pyjore 1.8 ha subjektit “NGA G” sh.p.k, për shkak të paligjshmërisë. Gjithashtu, të vlerësojë dëmin e shkaktuar dhe të marrë masat ligjore ndaj përgjegjësve, duke ndaluar çdo përdorim të mëtejshëm të paligjshëm, të kërkojë pranë organeve

ligjzbatuese ndëshkimitin e shkaktarëve, dhe subjektit “NGA G” sh.p.k ti kërkojë rikuperimin e sipërfaqes së dëmtuar, të pronës publike, fond pyjor/kullosor.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit që lidhet me pajisjen me leje mjedisi të shoqërisë “B. C.” sh.p.k., u evidentuan mangësi në zbatimin e kërkesave ligjore dhe procedurale, të cilat kanë ndikuar negativisht në transparencën, përfshirjen e plotë të palëve të interesuara dhe pasqyrimin e drejtë të procesit të miratimit, duke bërë që ai të mos jetë plotësisht në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi.

1. Konkretisht, nga auditimi i VNM-së së Thelluar:

- Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk ka zhvilluar konsultimet e detyrueshme me institucionet përgjegjëse - Këshillin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM), si organi kompetent për vlerësimin e ndikimeve në trashëgiminë kulturore, siç parashikohet në nenin 134, pika 1, 2 të Ligjit nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, në kundërshtim me VKM nr.686, datë 29.07.2015, të përditësuar, Kreu II, Zhvillimi i procedurës së thelluar të VNM-së, pika 4/b.

- Nuk ka asnjë gjurmë dokumentimi lidhur me mënyrën se si është realizuar procesi i informimit dhe konsultimit me publikun gjatë hartimit të raportit të thelluar të VNM-së. Megjithëse në formular rezulton se kanë marrë pjesë 12 persona, mungon çdo provë se ky proces është kryer sipas procedurave ligjore, përfshirë njoftimet zyrtare, publikimet, dokumentimin e thirrjes së publikut dhe përfaqësuesve të interesit, si dhe mënyrën e organizimit të takimit.

- Nuk është dokumentuar kryerja e konsultimeve me publikun dhe mospërfshirjen e palëve të interesuara në seanca dëgjimore (si përfaqësues të OJF-ve, të shoqërisë civile, bizneseve përreth zonës, përfaqësues të mediave vizive dhe të shkruara lokale apo përfaqësues të grupeve të interesit informale etj). Mungesa e këtij procesi përbën shkelje të kërkesave për transparencë dhe përfshirje publike.

- Raporti i Thelluar i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) është paraqitur pa praninë apo pjesëmarrjen e ekspertëve hartues në procesin konsultativ; pa dokumentim të komunikimeve ndërinstitucionale; i nënshkruar vetëm nga një ekspert, pa përfshirjen dhe nënshkrimin e administratorit dhe specialistëve të tjerë, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr.10440, datë 07.07.2014 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, neni 17, pika 5, dhe VKM nr.247, datë 30.04.2014, Kapitulli II.

Mosrespektimi i këtij procesi përbën shkelje të procedurës ligjore: *Kreu II, neni 7, Procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis, pika 3 e Ligjit nr.10440, datë 7.7.2014, ndryshuar* dhe dëmtojnë besueshmërinë e procesit dhe rrisin rrezikun e konflikteve sociale dhe ligjore në fazat e zbatimit të projektit.

2. Nga auditimi i Deklaratës Mjedisore nr.3810, datë 29.05.2017, miratuar me Vendim nr. 19 nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për subjektin “B. C.” sh.p.k, rezultoi se kjo është lëshuar në kundërshtim me kërkesat ligjore dhe procedurale të parashikuara në VKM nr. 686, datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullores për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, e ndryshuar, konkretisht:

- Mungon Raporti Teknik, dokument i detyrueshëm për vlerësimin e ndikimit në mjedis, sipas pikës 10/ç të Kreut II të VKM nr. 686/2015.

- Mungon Përmbledhja e Konsultimeve me Publikun dhe palët e interesuara, e kërkuar në pikën 10/ç të të njëjtit vendim, si pjesë integrale e Raportit të Thelluar të VNM-së.

- Mungon përmbledhja e konsultimeve me publikun dhe palët e tjera të interesuara, ashtu si kërkohet gjatë hartimit të Raportit të Thelluar të VNM-së, i cili është një nga kushtet për të marrë Deklaratën Mjedisore, sipas pikës 10/ç Kreu II të VKM nr. 686, datë 29.07.2015. sipas pikës 10/ç të të njëjtit vendim. Edhe pse është deklaruar se është zhvilluar një takim me pjesëmarrjen e komunitetit dhe përfaqësuesve vendorë, nuk është dokumentuar procesi në formën dhe përmbajtjen e kërkuar ligjërisht.

3. Nga auditimi i procesit të pajisjes me Leje Mjedis Tipi B:

- Nuk është dokumentuar marrja e mendimit të institucioneve të detyrueshme si, Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave (ISHMPU) dhe Drejtoria Teknike në Ministrinë e Mjedisit, në kundërshtim me Kreun VI, pika 2/a të VKM nr. 419/2014.
- Mendimi i ARM-së Shkodër, ndonëse formalisht pozitiv, është dhënë me kushte dhe vërejtje, duke theksuar një sërë çështjesh të adresuara subjektit, si: mungesa e deklaramentit të pronësisë së impiantit, mungesa e të dhënave për sasinë e ujit të përdorur, menaxhimi i mbetjeve, ndikimet në ajër, ujë dhe tokë bujqësore, si dhe masa për mbrojtjen e biodiversitetit.
- Nuk është paraqitur dokument zyrtar që vërteton statusin juridik të pronësisë, por në Bashkinë Shkodër rezulton fond pyjor kullor shtetëror, në administrim të saj, e faktuar kjo edhe me shkresën nr. 179 prot., datë 07.01.2019 të Bashkisë Shkodër drejtuar AKBN-së dhe MTM-së, ku kërkohet heqja e sipërfaqes fond pyjor/kullor në pronësi të saj.
- Nuk është dokumentuar asnjë nga hapat dhe detyrimet e parashikuara në Kreun VI, pikat 6–16 të VKM nr.419, datë 25.06.2014, përfshirë: njoftimin publik 20-ditor, shpalljen në media, organizimin dhe dokumentimin e dëgjësës publike, si dhe dorëzimin e relacionit përfundimtar në QKL, duke cënuar transparencën dhe pjesëmarrjen e publikut në proces.

4. Komisioni Nr. 12 miratoi lejen mjedisore për “B. C.” sh.p.k pa verifikuar plotësisht dokumentacionin ligjor dhe procedural, duke lejuar mungesa që cënojnë transparencën dhe garancinë ligjore të procesit.

5. Verifikimi në terren pranë zonës minerare “Rasek”, konstatoi shkelje të rënda të kushteve të lejes mjedisore dhe veprimtari të tjera të paligjshme, përfshirë depozitimin e materialeve sterile dhe inerteve në shtratin e lumit, ndryshimin e trasesë së rrugës së kantierit në kundërshtim me projektin e mratur; ndërtimin e veprave teknike jo të parashikuara (tombinat, urë provizore); gërryerje dhe ndërhyrje të pakontrolluara në terren shkarkim të punimeve përgatitore mbi përrua, si dhe rrezikim të infrastrukturës së ujit të pijshëm, praktika këto që bien ndesh me Ligjin nr. 10 440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” Neni 24; Ligji nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” Neni 60, Ligji nr.57/2020 “Për pyjet” neni 36, pika 2, germa e); Ligj Nr_9693 date 19_03_2007 “Per fondin kullor” i ndryshuar neni 34, pika 16. Ligji nr. 10304 “Për sektorin minerar në RSH”, i përditësuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe nr.23 deri në faqen 30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Mjedisit në cilësinë e organit kompetent për dhënien dhe menaxhimin e Lejeve Mjedisore të Tipi B, të shqyrtojë parregullsitë e konstatuara gjatë dhënies së lejes, duke vlerësuar ndikimin e tyre në zbatimin e lejes mjedisore, si dhe të kryejë revokimin e Lejes Mjedisore me nr. PN-5249-06-2017 lëshuar subjektit “B. C.” sh.p.k, për shkak të mangësive të konstatuara, të mospërfshirjes së komunitetit në procesin e vendimmarrjes (përmes dëgjësave publike), problematikat në Raportin e Thelluar të VNM-së, si dhe shkelje të tjera të identifikuar në terren.

Në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit dhe procesit të miratimit të Lejes Mjedisore Tipi B për subjektin “NGA G” sh.p.k rezultoi se, megjithë dorëzimin e dokumentacionit dhe miratimin formal të lejes, procesi i konsultimit me publikun ka pasur mangësi serioze, përfshirë mungesën e përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe medias, mungesën e dokumentacionit të plotë të dëgjësës publike, dhe mosrespektimin e procedurave të bashkëpunimit dhe raportimit mes institucioneve përkatëse, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 686/2015 dhe VKM nr. 419/2014. AKM nuk ka kryer verifikimin në terren të informacionit të dhënë nga operatori, siç kërkohet nga Ligji nr. 10448/2011.

Komisioni nr.25, përgjegjës për shqyrtimin e kërkesave për Leje Mjedisore Tipi B, nuk ka kryer vlerësimin e plotë dhe të saktë të dokumentacionit të “NGA G” sh.p.k. Dokumentacioni ka mungesë të informacionit të detajuar mbi dëgjësën publike, përfshirë pjesëmarrësit sipas zonave, procesverbalin dhe njoftimet publike, duke shkelur VKM nr. 686/2015 dhe VKM nr. 419/2014. Dokumentacioni i dorëzuar nuk përmban informacion të plotë dhe të detajuar lidhur me dëgjësën

publike, përfshirë mungesën e specifikimit të pjesëmarrësve sipas zonave, mungesën e procesverbalit dhe të njoftimeve publike, duke shkelur kështu kërkesat e përcaktuara në VKM nr.686, datë 29.07.2015 dhe VKM nr.419, datë 25.06.2014.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk ka kryer verifikimin në terren të informacionit të deklaruar nga operatori, në kundërshtim me nenin 4, pika 2/c të Ligjit nr.10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”.

Verifikimi në terren i kryer më 01.04.2025 nga grupi i auditimit i KLSH-së, në prani të përfaqësuesve institucionalë, vërtetoi gjithashtu se impianti i deklaruar për fraksionim nuk ishte i instaluar në vend. Këto mangësi ndikojnë në ligjshmërinë e procesit të miratimit të lejes mjedisore. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe nr. 31 deri në faqen nr.32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Mjedisit, si organi kompetent për dhënien dhe menaxhimin e Lejeve Mjedisore Tipi B, të ushtrojë menjëherë të drejtën për revokimin e Lejes Mjedisore me PN-1089-03.2022, datë 23.03.2022 të subjektit “NGA G” sh.p.k., për shkak të mosrespektimit të kushteve të përcaktuara në leje dhe mungesës së impiantit të fraksionimit në vend, duke zbatuar dispozitat ligjore që parashikojnë shfuqizimin e lejes në rast mosplotësimi të kushteve të saj.

Menjëherë

8.2 Rekomandimi: Ministria e Mjedisit të shqyrtojë me kujdes veprimet e ndërmarra nga strukturat përkatëse të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe në bazë të rezultateve të këtij shqyrtimi, të marrë masat administrative dhe disiplinore të nevojshme ndaj personave përgjegjës për shkeljet e konstatuara gjatë procesit të menaxhimit të lejes mjedisore.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: 1. Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Inspektim-Kontrollit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit ka hartuar dhe dërguar programe vjetore inspektimi për vitet 2021–2024, të cilat janë miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. Megjithatë, për periudhën 2018–2020 mungojnë programe të miratuara, në kundërshtim me nenin 73 të Ligjit nr. 10431/2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe VKM nr.547, datë 30.06.2011, që parashikojnë detyrimin për hartimin dhe miratimin e programeve të inspektimit në mënyrë të vazhdueshme dhe të planifikuar.

2. Nga auditimi u konstatua se subjekti “B. C.” sh.p.k., me PN-5249-06-2017 nuk ka dorëzuar raportet e vetëmonitorimit për periudhat maj-nëntor 2017, maj-nëntor 2018, nëntor 2018-maj 2019, maj-nëntor 2019, nëntor 2019-maj 2020, si dhe raportet vjetore për vitet 2018, 2019 dhe 2020, duke shkelur detyrimet ligjore për monitorimin dhe transparencën mjedisore të përcaktuara në Ligjin nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, Kreu VI, neni 44, pika 3 dhe 4; Pika 2.9.2 e Lejes Mjedisore Tipi B, gjë e cila tregon mungesë të kontrollit institucional.

3. Nga auditimi u konstatua se gjatë periudhës 2017–2020 dhe në vitin 2024, subjekti “B. C.” sh.p.k nuk është inspektuar nga autoritetet përgjegjëse, ndërsa janë kryer vetëm tre inspektime përgjatë viteve 2021, 2022 dhe 2023.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të inspektimeve të kryera për autorizimet Nr. AKM-LE-2021-000119-1 dhe Nr. AKM-LE-2022-000015-1, u evidentuan mangësi në plotësimin e listave të verifikimit: konkretisht, në vitin 2021 mungonin 13 nga 32 rubrika, ndërsa në vitin 2022 mungonin 5 nga 32 rubrika. Këto pasaktësi tregojnë për dokumentim jo të plotë dhe çenojnë integritetin e procesit të inspektimit. Gjithashtu, mungesa e inspektimeve të rregullta dhe e mbikëqyrjes së vazhdueshme përbën shkelje të kërkesave të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, nenet 7 dhe 26, të cilat përcaktojnë detyrimin për kontroll periodik të subjekteve me ndikim në mjedis.

4. Për subjektin “NGA G” sh.p.k me PN-1089-03-2022 rezultoi se, prej fillimit të marrjes së lejes mjedisore (Mars 2022) e në vijim nuk është kryer asnjë inspektim, në kundërshtim me ligjin nr.10433, datë. 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” neni 7, 26.

5. Nga auditimi u konstatua se subjekti “NGA G” sh.p.k, i pajisur me Leje Mjedisore të Tipit B (PN-1089-03-2022), nuk ka përmbushur detyrimet ligjore të përcaktuara në Ligjin nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, Kreu VI, neni 44, pikat 3 dhe 4, lidhur me dorëzimin e raporteve të vetëmonitorimit për periudhën Mars–Shtator 2022.

Gjithashtu, nuk ka dorëzuar raportin e vetëmonitorimit për periudhën e parë pas marrjes së lejes dhe ka dorëzuar raporte të periudhave para pajisjes me leje mjedisore (Nëntor 2020 - Maj 2021, Maj 2021 - Nëntor 2021, dhe Maj 2022 - Nëntor 2022) për një subjekt tjetër (“B. C.” sh.p.k), çka nuk përmbush detyrimin ligjor të vetëmonitorimit. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, Kreu VI, neni 44, pikat 3 dhe 4, si dhe me kërkesat e Udhëzimit nr. 1, datë 20.01.2021 të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit “Për formatin dhe mënyrën e dorëzimit të raporteve të vetëmonitorimit nga subjektet me leje mjedisore”, ku përcaktohet qartë se raportet duhet të jenë specifike për subjektin dhe për periudhën pas marrjes së lejes." (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe nr. 34 deri në faqen 36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1 Rekomandimi: Drejtoria e Inspektimit dhe Kontrollit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit të planifikojë dhe miratojë në kohë programet vjetore të inspektimit, për të rritur frekuencën e kontroleve në terren për subjektet që ushtrojnë aktivitetet minerar në zonën minerare 2/6, vendburimi “Rasek”.

Menjëherë dhe në vijimësi

9.2. Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Mjedisit në bashkëpunim me Agjencinë Rajonale të Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës të ngrejë një grup pune të përbashkët për kryerjen e një inspektimi të plotë ndaj subjekteve “B. C” sh.p.k dhe “NGA G” sh.p.k, për verifikimin e përmbushjes së kushteve të lejeve mjedisore dhe zbatimit të masave për menaxhimin e ndotjes. Në përfundim të inspektimit, të ndërmerren masa për përcaktimin e përgjegjësive ligjore dhe të informohet Ministria e Mjedisit.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i dokumentacionit dhe analizimi i programeve të monitorimit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, rezultoi se:

- Gjatë viteve 2019, 2020, 2023 dhe 2024, aktiviteti minerar i subjekteve “B. C.” sh.p.k dhe “NGA G” sh.p.k nuk është monitoruar në përputhje me programet vjetore të miratuara nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore. Konkretisht, për vitet 2019, 2020 dhe 2024 mungon monitorimi për nga një periudhë 6-mujore, ndërsa në vitin 2023 nuk është realizuar asnjë monitorim, pavarësisht përfshirjes në planifikim. Këto mangësi përbëjnë devijime nga kërkesat ligjore dhe cënojnë efektivitetin e mbikëqyrjes institucionale dhe zbatimin e kushteve të lejeve minerare, duke pasur parasysh risqet konkrete të konstatuara në terren, si depozitimi i sterileve dhe ndërtimi i tombinave/mureve gabion pranë burimit të ujit të pijshëm të Postribës, veprime në kundërshtim me nenin 43, pika 3 të Ligjit nr. 10304/2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, i konsoliduar, si dhe me nenin 16, pikat 6–9 të Statut-Rregullores së AKBN-së." -Subjekti “NGA G” sh.p.k nuk ka dorëzuar raportet 6-mujore të vetëmonitorimit dhe raportin vjetor për vitin 2024, në kundërshtim me nenin 25/1 “c” dhe nenin 45, pika 1, gërma “ç” të Ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, i konsoliduar, i cili e përcakton këtë si një detyrim të detajuar ligjor, që parashikon masa ndëshkuese me karakter financiar, duke ndikuar kështu negativisht në transparencën, kontrollin efektiv dhe besueshmërinë e veprimtarisë minerare. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe nr.36 deri 43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore të përgatisin dhe zbatojnë programe të rregullta kontrolli për subjektet minerare që ushtrojnë aktivitetet në zonën minerare 2/6, vendburimi “Rasek” për subjektet “B. C.” sh.p.k dhe “NGA G” sh.p.k. Këto programe duhet të përfshijnë inspektime periodike, çdo 6 muaj dhe vjetore, për të garantuar që problemet e konstatuara të ndiqen dhe zgjidhen në kohë.

10.2 Rekomandimi: Drejtoria e Monitorimit në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore të verifikojë dorëzimin e raporteve 6-mujore të vetëmonitorimit dhe raportin vjetor për vitin 2024 nga subjekti “NGA G” sh.p.k dhe të aplikojë masat administrative përkatëse në rast të shkeljeve, sipas nenit 45, pika 1, gërma “ç” dhe nenit 25, pika 1, gërma “c” të Ligjit nr. 10304/2010, për të siguruar transparencë dhe përgjegjshmëri institucionale.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatuan mospërputhje ndërmjet raporteve të mbikëqyrjes, sistemit RevZonë dhe planit vjetor të punës, veçanërisht në: numrin e punonjësve në listëpagesë numrin e të siguruarve me sigurim jete, prodhimin e raportuar dhe tregues të tjerë operacionalë, në kundërshtim me kërkesat e raportimit sipas Ligjit nr. 10304/2010.

- Raportet e mbikëqyrjes paraqesin mangësi për të dhënat mbi: realizimin e investimeve, operacionet e rehabilitimit të mjedisit, menaxhimin e mbetjeve dhe lëvizjen e rezervave minerare, në kundërshtim e me kërkesat e pikës nr. 2, gërma “i”, të VKM nr. 232, datë 23.03.2011 “Për miratimin e funksioneve të strukturës përgjegjëse në sektorin minerar të RSH”.
- Lista E-SIG-25 është dorëzuar, por nuk paraqet ndarjen e punonjësve sipas llojit të aktivitetit minerar (sipërfaqësor/nëntokësor), dhe në dosje mungon raportimi i ndryshimeve të punonjësve gjatë vitit, dhe se;
- Punonjësit janë siguruar me prim sigurimi 3,000 lekë, në kundërshtim me rregulloren kërkesat e VKM-së nr. 1109/2008, që parashikon shumën minimale të sigurimit prej 6,000,000 lekë dhe prim minimal 0.5% të kësaj shume, dhe siç kërkohet nga rregulloret përkatëse të organizimit dhe funksionimit të komisionit të shqyrtimit të dokumentacionit dhe të miratimit të planeve vjetore të punës të zotëruesve të lejeve minerare, të miratuara nga Drejtori Ekzekutiv.

11.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore të mare masat për forcimin e kontrollit dhe kryerjen e verifikimeve periodike duke siguruar harmonizimin e të dhënave ndërmjet raporteve RevZonë, raporteve të mbikëqyrjes dhe planeve vjetore, si dhe duke kryer verifikimin e listëpagesave me kontratat e sigurimit të jetës së punonjësve dhe të gjithë dokumentacionit teknik e financiar, në përputhje me kërkesat e rregulloreve minerare përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 15, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shkronja “e” dhe “ç” të nenit 11, kreun IV, dhe nenin 21, pika 3, gërma “h” si dhe neni 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 59 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, i rekomandojmë Ministrin të Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrin të Mjedisit, Drejtorin Ekzekutiv të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, Drejtorin të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Drejtorin të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, Kryetarin të Bashkisë Shkodër, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

